



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Qiriazi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr.Gloria Tyxhari

Dr.Senada Bushati

Nëntor/2024

**Tabela Përmbledhëse për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në
“Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”**

Kolegji Universitar “Qiriazhi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Qiriazhi”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhim Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UAMS Nr. 263, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	NA
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	NA
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	NA
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023-2024 15 PAE/7 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2021-2022 8 studentë V.a 2022-2023 8 studentë V.a 2023-2024 10 studentë
19	Komente / të tjera:	-

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Menaxhim Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë, Kolegji Universitar “Qiriazi”.

Hapja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” është miratuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 263, datë 19.07.2021, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e integruar ndërmjet Informatikës dhe Biznesit.

Ky program realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” në Fakultetin Ekonomik, të Kolegjit Universitar Qiriazi, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2021 – 2022, ku janë regjistruar 8 studentë. Në vitin akademik 2022 – 2023, janë regjistruar 8 studentë, në vitin akademik 2023 – 2024 10 studentë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga dy anëtarë: Dr. Gloria Tyxhari dhe Dr. Senada BUSHATI, me mbështetjen e koordinatorës teknike të ASCAL, Znj. Alma Arapi.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin shkurt 2024 me kërkesën nga ana e Kolegjit Universitar “Qiriazi”, duke vijuar me dorëzimin e dokumentacionit në Qershor 2024. Ekspertët u njohën me DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një agjende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me KUQ, në datat 15 dhe 16 Shkrt 2024, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh e intervistash me Dekanin e Fakultetit Ekonomik, Përgjegjësën e Departamentit të Menaxhimit, me Grupin e vetëvlerësimit të programit, me Koordinatorin e programit të studimit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, me studentët e programit të studimit dhe me përfaqësues të Projekteve. Gjithashtu GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Bibliotekë si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.

Kolegji Uiversitar "Qiriazhi", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 76 / 27 Prot, datë 02.10.2024. Kolegji Universitar "Qiriazhi", njofton në ASCAL më datë 09.10.2024, me anë të shkresës me Nr.03 Prot, datë 09.10.2024 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 03 Prot, Datë 09.10.2024.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi I.1, Kriteri 5 (Përmbushet Kryesisht):**

GVJ: GVJ arrin në konkluzionin se Programi i studimit "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi" është në përputhje me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me to. Ky program është në përputhje me misionin dhe vizionin e Kolegjit Universitar "Qiriazhi" dhe strategjinë e zhvillimit të tij, siç konfirmohet nga dokumentet e dorëzuara. Gjithashtu programi i studimit është hartuar dhe ofruar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit, statutin dhe rregulloret e tij, duke ndërthurur drejtimet e Informatikës dhe Ekonomisë/Biznesit.

Përsa i përket kapaciteteve dhe burimeve akademike, institucioni ka përvojën dhe burimet e duhura për ofrimin e programit në fushën ekonomike, por ka mungesa në kapacitetet dhe burimet akademike për profilin e IT-së. Infrastrukturat teknologjike aktuale janë të papërshtatshme. Gjithashtu konkludohet nga GVB se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të institucionit. Megjithatë, dokumentacioni mbështetës është i paplotë dhe ka referenca të gabuara.

GVB: Për sa u përket burimeve akademike, duke qënë se programi është i sapohapur dhe tregu akademik në IT (specialistë me tituj dhe grada në këtë fushë) ka mungesa, deri më tani lëndë specifike të formimit janë mbuluar me staf të jashtëm. Kjo mangësi po plotësohet në vitin në vazhdim. Mendojme se duhej specifikuar ne cilat raste dokumentacioni mbështetës është i paplotë dhe referenca të gabuara, në mënyrë që të bëhet e mundur saktësimi apo plotësimi i tyre.

Theksojmë, se dicka e tillë, në fakt nuk është kërkuar deri më tani.

GVJ: Në bazë të analizës së paraqitur nga GVJ, konkluzionet e arritura në lidhje me programin e studimit "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi" në Kolegjin Universitar "Qiriazhi" janë të mbështetura nga dokumentacioni i dorëzuar si dhe konstatimet e bëra gjatë takimeve pranë kësaj IAL. GVB shprehet se mungesat janë rezultat i vështirësive të tregut akademik në IT dhe se po punohet për të adresuar këto çështje. Ky arsyetim nuk është mbështetur nga një analizë konkrete ose dokumentacioni i detajuar që të vertetojë këtë gjendje ose planet për përmirësime. Kjo mund të interpretohet si një mungesë e plotësisë dhe transparencës në prezantimin e situatës reale dhe në adresimin e problemeve të identifikuara.

Për këtë arsye, është e rëndësishme për institucionin të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të specifikuar qartë, si dhe të ndërmarrë hapa konkretë për të adresuar mungesat në fushën

akademike dhe infrastrukturën teknologjike, në mënyrë që të plotësojë standardet dhe të ofrojë një arsimim cilësor për studentët e tij. Përshkallëzimi i transparencës dhe përmirësimi i komunikimit rreth këtyre çështjeve do të ishin hapa pozitivë drejt përmirësimit të kushteve dhe përmbushjes së pritjeve akademike dhe profesionale.

Ndërkohë Standarti I.1, Kriteri 5, liston dokumentat e referuara gabim dhe ato të paplota të cilat lidhen me këtë kriter dhe standard.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

2. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi I.2, Kriteri 4 (Përmbushet Pjesërisht):**


GVJ: IAL siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani dhe aktorë të biznesit vendas dhe të huaj dhe përdor një sistem të brendshëm për ndarjen e detyrave dhe analizën e vazhdueshme të punës së stafit akademik dhe njërive. Megjithatë, dokumentacioni i dorëzuar është më shumë raportim sesa analizë e mirëfilltë. KUQ ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit dhe me biznese private, por mungojnë marrëveshjet me kompani në fushën e programimit. Institucioni ka marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteteve të tjera, por programi i ri ende nuk ka diplomuar studentët e parë për të dokumentuar realizimin e praktikave. Raportet analitike të përfitimeve nga marrëveshjet janë të pamjaftueshme ose në mungesë dhe kryesisht me natyrë përshkruese, ndaj GVJ kërkon përmirësim në dokumentimin e analizave vjetore nga Departamenti i Menaxhim-Biznesit.

GVB: Marrëveshje në fushën e programimit kemi me shoqërinë "Communication Progress" SHPK. Në lidhje me raportin e përfitimeve nga marrëveshjet, duke qënë se studentët nuk kishin mbyllur ciklin e plotë të studimeve, pasi nuk ishin nënshtruar praktikës profesionale, gjë që do ti shtonte kësaj liste edhe biznese të tjera në këtë fushë, analiza do të jetë më gjithpërfshirëse dhe specifike për vitin në vazhdim. Ndërkohë në asnjë kriter të këtij standarti nuk ka vëretje. Mendojmë se vlerësimi i këtij Standarti të rishikohet.

GVJ: GVB thekson se ka një marrëveshje me "Communication Progress" SHPK, por kjo është e pamjaftueshme për të krijuar një rrjet të qëndrueshëm bashkëpunimi në fushën e programimit, i cili është thelbësor për të mbështetur zhvillimin praktik të studentëve. Mungesa e marrëveshjeve të tjera të ngjashme kufizon ndjeshëm mundësitë për studentët që të përfshihen në projekte reale dhe të përfitojnë praktikë cilësore. Bazuar edhe në analizën RVJ, raportet e dorëzuara nga institucioni janë kryesisht përshkruese dhe nuk përmblajnë analizë të thelluar mbi përfitimet e bashkëpunimeve, ndërsa pretendimi se raportet do të përmirësohen në të ardhmen, për shkak të mosdiplomimit të studentëve, tregon një mungesë të analizës së mjaftueshme dhe strukturimit të duhur. Gjithashtu, mungesa e dokumentacionit për mobilitetet dhe përfshirjen e studentëve në projekte tregon se aktualisht këto bashkëpunime nuk janë përmbushur në nivelin e duhur. Ndërkohë, justifikimi për vonesat për shkak të ciklit ende të papërfunduar të studimeve nuk përjashton detyrimin për të ndërtuar marrëveshje të qëndrueshme që paraprakisht do të kishin krijuar mundësi për studentët që në auditor. E gjithë kjo tregon mungesë planifikimi.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

GVJ: Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE – Përmbushet Pjesërisht



GVB: Nisur nga fakti se vlerësimet për të dy standartet peshën kryesore e zë Standarti 1.1 (5 kritere, ndaj 4 kritereve), si dhe nga komentet tona për Standartin I.2, mendojmë se duhet të bëhet rivlerësim për këtë fushë. Mendojmë se vlerësimi i kësaj fushe të rishikohet.

Vlerësimi i Standartit I nuk ndryshon.

3. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.1, Kriteri 8 (Përmbushet Kryesisht):

GVJ: Programi i studimit BA IE&B është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore kombëtare në fuqi. Programi është i strukturuar në lëndë dhe module, duke respektuar Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi synon të zhvillojë aftësi të avancuara për studentët në fusha të ndryshme, por mungon thellimi në mendimin kritik dhe kërkimin shkencor. Veprimtaritë formuese janë të ndara sipas kategorive përkatëse dhe ngarkesa në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmblyëse është e përcaktuar qartë. KUQ nuk ka studentë me status të veçantë dhe nuk ofron programe të përbashkëta me institucione të tjera. Dokumentacioni mbështetës për kodifikimin e programeve të studimit nuk është i plotë.

GVB: Dëshirojmë t'ju sjellim në vëmendje se programi i studimit në fjalë është një program i Ciklit të Parë, i cili nuk ofron aftësi të avancuara dhe kërkim shkencor të mirfilltë. Këto objektiva janë për një program të Ciklit të Dytë. Në lidhje me dokumentacionin mbështetës për kodifikimin e programeve të studimit sqaroj se ai është i plotë dhe i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit edhe për institucionin tonë. Mendojmë se vlerësimi i kësaj fushe të rishikohet.

GVJ: GVJ e mbështet plotësisht mendimin se thellimi i kërkimit shkencor është objektiv i programeve të Ciklit të Dytë, por programet e Ciklit të Parë duhet të ofrojnë përgatitje bazë në mendimin kritik, shkrimin akademik dhe metodologjitë e kërkimit (konstatuar edhe në Standarti II.1, Kriteri 2). Këto elemente janë thelbësore për zhvillimin e aftësive të pavarura të të mënduarit dhe për përgatitjen e studentëve për sfida të paparashikueshme në tregun e punës dhe studimet e mëtejshme. Mungesa e këtyre përbërësve tregon një mangësi në strukturën e programit.

Sa i përket dokumentacionit të kodifikimit të programeve, GVJ është shprehur (Standarti II.1, Kriteri 7), GVJ konstaton që nuk ka asnjë dokument me këtë emertim [EV. 2_10_Te dhena për kodifikimin e programeve të studimit në FE.]. Kodi i cituar nga GVB shikohet i aplikuar në lëndët e programit BA IE&B [Ev. 3_9_1_Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit]. Pretendimi i GVJ se dokumentet janë të plota dhe të miratuara nga Ministria nuk përjashton detyrimin që ato të ishin të disponueshme dhe transparente gjatë vlerësimit. Mungesa e dokumentit të kërkuar gjatë procesit të akreditimit vështirëson verifikimin e përputhshmërisë me standartet ligjore. Kjo mangësi nënvizon edhe njëherë nevojën për dokumentacion më të plotë dhe të qasshëm.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

4. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.2, Kriteri 3 (Përmbushet Kryesisht):

GVJ: Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Menaxhim Biznesit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për organizimin dhe strukturën akademike, duke bashkërenduar mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Megjithatë, ka mospërputhje në emërtimet dhe numrin e personelit akademik të deklaruar. Gjithashtu nuk ka personel ndihmës

akademik/administrativ të mirëfilltë të angazhuar në programin e studimit. Koordinatori për programin e studimit BA IE&B është caktuar dhe ka detyrat e përcaktuara qartë.

GVB: Në këtë standart bëhet vetëm një konstatim se nuk ka personel ndihmës akademik/administrativ të mirëfilltë të angazhuar në programin e studimit, i cili për arsye të numrit të studentëve, nuk përbën kusht për një vlerësim të tillë. Mendojmë se vlerësimi i kësaj fushe të rishikohet.

GVJ: GVJ thekson se mungesa e personelit ndihmës akademik/administrativ është një nga kriteret për vlerësim. Standardit II.2, Kriteri 2 kërkon që njësia bazë të sigurojë personel ndihmës për të mbështetur praktikat mësimore, laboratorike ose aktivitete të tjera. Ky staf ndihmës është thelbësor për të garantuar realizimin efektiv të procesit mësimor dhe për të mbështetur zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. Mungesa e tij përbën një mangësi që duhet të adresohet.

Gjithashtu konstatimet e tjera për këtë kriter janë: Standardit II.2, Kriteri 2, numri i personelit akademik i angazhuar pranë Fakultetit të Ekonomisë gjatë vitit akademik 2023-2024 nuk është i qartë pasi nuk ofrohet një dokument i tillë. GVJ rekomandon rakordimin e shifrave dhe dorëzimin e dokumentave që mungojnë.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

5. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi II.3, Kriteri 5 (Përbushet Kryesisht):

GVJ: Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi" është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Dokumentacioni mbështetës, si statuti, rregulloret, plani mësimor dhe syllabuset e disa lëndëve, janë dorëzuar dhe disponohen për organizimin dhe strukturën e programit. Megjithatë, syllabuset e dorëzuara janë të paplota dhe literatura e përdorur është e vjetëruar.

GVB: Syllabuset janë hartuar sipas udhëzimeve të MAS dhe disponohen të gjitha nga ana e departamentit përkatës. Mbase ka ndodhur ndonjë gabim në uploadimin e tyre në sistem, por kjo gjë nuk është bërë e ditur deri më tani. Kopje fizike e tyre (hard copy) gjendet në dosjen e dorëzuar nga GVB në ASCAL. Mendojmë se vlerësimi i kësaj fushe të rishikohet.

GVJ: GVB thekson se syllabus-et janë dorëzuar edhe fizikisht dhe se mund të ketë ndodhur një gabim gjatë ngarkimit në sistem të kopjeve elektronike. Sipas praktikës standarde dhe detyrave të ekspertëve, kontrolli i dokumentacionit kryhet përmes versioneve të ngarkuara elektronikisht në sistemin përkatës, pasi ky është kanali zyrtar dhe i standardizuar për verifikimin e përbushjes së kriterëve. Mosngarkimi i saktë i dokumenteve në platformën elektronike tregon mungesë kontrolli dhe organizimi nga ana e institucionit dhe nuk përjashton përgjegjësinë e tij për të siguruar që dokumentacioni të jetë i plotë gjatë procesit të vlerësimit. Gjithashtu, në analizën bërë nga GVJ është evidentuar gjithashtu se literatura e përfshirë është e vjetëruar ose me informacion të paplotë (pa vitin e botimit ose të dhëna të munguara për leksionet). [Ev_3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III]. Kjo konfirmon që përbushja e kërkesave për dokumentacionin e syllabus-eve dhe përditësimin e literaturës nuk është realizuar plotësisht, duke ndikuar në cilësinë e programit dhe në transparencën e tij për studentët dhe palët e tjera të interesuara.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

6. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi II.4, Kriteri 7 (Përmbushet Pjesërisht)**:

GVJ: Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit BA IE&B janë në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultatet e të nxëniet dhe kërkesat e tregut të punës. GVJ sugjeron rishikimin e mundësive për shtim të tematikave si Machine Learning, Inteligjencë Artificiale, Siguri Informacioni dhe shkrirjen e lëndëve të financës për të përmirësuar strukturën dhe përmbajtjen e programit. Lëndët dhe modulet mbulojnë pjesërisht fushat e studimeve të informatikës dhe biznesit, dhe kurrikula rishikohet çdo vit për t'iu përshtatur tregut të punës. Programi është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit, por kërkohet theks më i madh në aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore në lëndët me profil IT. Dokumentacioni i programit ruan raportet midis formimit teorik dhe praktik, por nevojitet një rishikim i plotë i syllabusit dhe literaturës për të përfshirë materiale më të reja. Programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, por kërkohet një orientim më i madh drejt zbatueshmërisë në biznes. Programi mundëson vijimin e studimeve dhe punësimin e studentëve, dhe bashkëpunimet me bizneset ndihmojnë në realizimin e praktikave mësimore dhe gjetjen e mundësive të punësimit.

GVB: Në shtatë kriteret e këtij standarti ka vlerësime për programin e studimit. Rekomandimi për shtim të temave është i drejtë dhe do jetë pjesë e procesit për vitin pasardhës, ashtu si edhe literatura.

Përfundimi se lëndët dhe modulet mbulojnë pjesërisht fushat e studimeve të informatikës dhe biznesit, nuk qëndron pasi lëndët e këtij programi i shërbejnë formimit në informatikë ekonomike ndërthurur me menaxhimin e biznesit, jo thjesht informatikë në tërësi. Për më tepër, plani mësimor, sic është shprehur edhe nga RVB, është krahasuar edhe me ato IAL, brenda dhe jashtë vendit që ofrojnë të njëjtin program studimi. Mendojmë se vlerësimi i kësaj fushe të rishikohet.

GVJ: GVB komenton se përditësimet në tema dhe literaturë do të bëhen në vitin e ardhshëm, kjo nuk përjashton përgjegjësinë për sigurimin e syllabus-eve dhe literaturës së plotë dhe të përditësuar gjatë këtij cikli vlerësimi, pasi mungesa e tyre prek cilësinë e programit dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Gjithashtu referuar RVB, **Standardi II.4, Kriteri 3** thekson se programi “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” është bazuar në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, ndërkohë nuk vihet në dispozicion asnjë dokument apo listë e IAL-ve, brenda apo jashtë vendit, programet e të cilave janë marë si model, gjë që do përforconte pretendimin se struktura aktuale është optimale për zhvillimet e fundit në fushën e IT dhe biznesit.

Pretendimi i institucionit se lëndët aktuale janë të përshtatshme për të formuar studentët në fushën e informatikës ekonomike dhe menaxhimit të biznesit, duke mos përfshirë tërësisht shkencat kompjuterike, nuk përjashton nevojën për përmirësime, pasi përfshirja e tematikave moderne si Machine Learning, Inteligjenca Artificiale dhe Siguria e Informacionit është jetike për një program që pretendon të përgatisë studentë për tregun e IT dhe Biznesit. Për më tepër, programi ndërdisiplinor duhet të ruajë një balancë të mirë mes teorisë dhe praktikës, që në këtë rast kërkon përmirësime të mëtejshme. Gjithashtu, ekspozimi ndaj mendimit kritik dhe metodologjive të kërkimit, që përfshin ngritjen e hipotezave, analizat dhe prezantimin e

rezultateve, është thelbësor edhe në nivelin bachelor për zhvillimin e aftësive të studentëve për punë dhe studime të mëtejshme.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

7. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardi II.5, Kriteri 3 (Përmbushet Pjesërisht)**:

GVJ: KUQ nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit për të përmbushur objektivat dhe kërkesat e tregut të punës. GVJ vlerëson se njësitë përgjegjëse marrin në konsideratë sugjerimet nga institucionet partnere dhe aktorët e tregut të punës, nga studentët, por rekomandon dokumentimin e këtyre konsultave e propozimeve. Institucioni mbledh mendime nga studentët dhe stafi akademik për përmirësimin e programit dhe realizon takime me studentët e diplomuar të KUQ, megjithëse nuk ka ende të diplomuar në programin e studimit BA IE&B. Rekomandohet fuqizimi i rrjeteve ALUMNI dhe përfshirja e tyre në strukturat konsultuese dhe drejtuese të universitetit. Programi përmirësohet dhe përditësohet bazuar në sugjerimet e rrjeteve të profesionistëve dhe shoqatave, duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës për profilet e IT.

GVB: Në këtë standart nuk ka vërejtje për kriteret por ka rekomandim për dokumentimin e konsultave, si dhe për fuqizimin e rrjeteve ALUMNI dhe përfshirja e tyre në strukturat konsultuese dhe drejtuese të universitetit të cilat do të merren në konsideratë e diskutohen në departament në vitin e ri akademik. Për më tepër rrjeti ALUMNI fillon të funksionojë vetëm pasi studentët mbyllin Ciklin e plotë të studimeve të tyre, gjë që nuk është prezente në këtë rast. Mendojmë se vlerësimi i kësaj fushe të rishikohet.

GVJ: Bazuar në argumentimin e GVB, GVJ e mer në konsideratë mungesën e studenteve ALUMNI. Gjithsesi vlen të theksohet se mungesa e studentëve të diplomuar nuk përjashton detyrimin e institucionit për të ndërtuar paraprakisht një strategji të qartë dhe të dokumentuar për krijimin dhe fuqizimin e rrjetit ALUMNI. Institucioni duhet të tregojë përgatitje paraprake për të aktivizuar rrjetin ALUMNI sapo të diplomohen studentët e parë. Institucioni duhet të ketë gati një strategji para diplomimit të brezit të parë e cila duhet të analizojë në përmbajtjen e saj: strukturimin e rrjetit, aktivizimin e rrjetit, fuqizimin dhe zhvillimi i rrjetit si dhe vlerësimin e kontributit të tij. Një strategji e tillë synon të sigurojë që rrjeti alumni të krijohet dhe fuqizohet me sukses edhe përpara diplomimit të brezit të parë të studentëve.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

GVJ: Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II – ORGANIZIMI; DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR - Përmbushet Kryesisht

GVB: Së pari mendojmë se në vlerësimin e kësaj fushe ka një pasaktësi nga GVJ sepse nga 5 standarte, tre me 16 kriterë shënohet “Përmbushet kryesisht”, (ky vlerësim zë peshën kryesore), në dy standarte me 10 kriterë shënohet “Përmbushet Pjesërisht”, Ndërsa në vlerësimin e fushës shënohet “Përmbushet pjesërisht”. Gjithashtu nisur nga përvoja disa vjecare e drejtimit e administrimit të disa programeve BSC nga Institucioni dhe vlerësimet e marra nga akreditimet e ASCAL, si dhe nga sqarimet që dhamë më poshtë rreth standarteve duhet të rishikohet vlerësimi i kësaj fushe. Mendojmë se vlerësimi i kësaj Fushe rishikohet.

GVJ: Vlen të ritheksohet se vlerësimi nga ana e GVJ është “Përmbushet kryesisht” dhe jo “Përmbushet pjesërisht” sic pretendohet nga GVB.

Vlerësimi i Standartit II nuk ndryshon.

8. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi III.1 (Përmbushet Pjesërisht):

GVJ: IAL garanton procesin e të nxënies dhe aftësimin profesional me metoda dhe praktika të përqendruara te studenti, duke përfshirë leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi, projekte dhe praktika profesionale. Megjithatë, detyrat e kursit kanë një peshë të ulët në vlerësimin përfundimtar. Institucioni respekton diversitetin dhe nevojat e studentëve duke ofruar forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përfshirë përdorimin e platformave e-learning dhe aplikacioneve kompjuterike. Personeli akademik mbështetet për përmirësimin e kompetencave didaktike përmes trajnimeve dhe vlerësimeve periodike, dokumentat e të cilave duhet të vihen në dispozicion të GVJ. Infrastruktura teknologjike është e pamjaftueshme dhe pajisjet janë të vjetra. KUQ promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes vlerësimit të performancës dhe përfshirjes së studentëve në procesin e reflektimit të mendimeve të tyre. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave të reja dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik.

Kriteri 3: Ndërkohë institucioni KUQ operon nëpërmjet paketës së “Instrumentave për Matjen e Cilësisë” ku janë rreth 11 pyetesore dhe formularë të ndryshëm që plotësohen nga studentët dhe stafi [Ev. 1_5_1 Politikat e NJSBC], por GVJ nuk i disponon këto dokumenta.

Kriteri 5: GVB i referohet dokumentit [Ev. 3_18_Pyetesoret e Standarteve], por ky dokument nuk gjendet në listën e dokumentave të dorëzuara nga institucioni.

GVB: Për sa u detyrave të kursit, në syllabuset e lëndëve specifikohet se ato zënë 10-20% të vlerësimit të lëndës, gjë që është miratuar nga ana e strukturave drejtuese të KUQ. Dokumentacioni i kërkuar, vec atyre standarte për RVB janë vënë në dispozicion të GVJ. Mendojme se duhet shënuar se çfarë mungon në Infrastrukturën teknologjike që është e pamjaftueshme dhe se cila pajisjet janë të vjetra. Të gjitha auditoret janë të pajisura me kompjutera e projektor, me dy laboratorë informatike (njëri vetëm për Fakultetin e Ekonomisë) me sistem operative a programe aplikative bashkohore, të lidhur në rrjet lan, me internet në të gjitha ambientet. Mendojmë se vlerësimi i këtij Standarti të rishikohet.

Kriteri 3: JU lutem të na sqaroni se cilët dokumente specifike mungojnë, me qëllim që tua vëmë në dispozicion, pasi nuk janë kërkuar më parë apo nuk kemi dijeni për mungesë të tyre.

Kriteri 5: Mbase, ka ndodhur ndonjë gabim në upload-imin e tyre në sistem, por kjo gjë nuk është bërë e ditur deri më tani. Kopje fizike e tyre (hard copy) gjendet në dosjen e dorëzuar nga GVB në ASCAL.

GVJ: GVJ rithekson se bazuar në evidencën [Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III], nga 7 syllabuse të dorëzuara, në 6 prej tyre detyra e kursit është e vlerësuar me 10%, ndërsa në 1 vlerësohet me 15%. Një total prej 80% zë vlerësimi nëpërmjet provimit. Kjo tregon një peshë të ulët të detyrave të kursit. Ky nivel zvogëlon rëndësinë e komponentëve praktike dhe nuk reflekton angazhimin e duhur për të nxitur mendimin kritik dhe aftësitë praktike të studentëve. Marja në konsideratë e rritjes së peshës së këtyre detyrave

është e rëndësishme për të përmirësuar përgatitjen praktike të studentëve dhe përputhjen me nevojat e tregut të punës.

GVJ vë theksin tek infrastruktura teknologjike e pamjaftueshme. GVB shpjegon se auditorët dhe laboratorët janë të pajisur me pajisje të përshtatshme dhe bashkëkohore. Megjithatë, **gjatë vizitës në IAL**, u konstatua se kompjuterat vonojnë në ndezje dhe në kryerjen e detyrave, gjë që tregon se pajisjet janë të vjetëruara dhe jo funksionale për një mësimdhënie efektive. Ky fakt dëmton cilësinë e procesit mësimor, veçanërisht për një program që përfshin lëndë IT dhe kërkon teknologji moderne dhe të shpejtë për të realizuar projekte të suksesshme. Edhe pse GVB thekson që laboratorët kanë pajisje të lidhura në rrjet LAN dhe me internet, ky fakt nuk mjafton për të garantuar mësimdhënie efektive. Problemet me kohën e ndezjes dhe funksionimin e kompjuterëve janë tregues të qartë që infrastruktura nuk përmbush standardet për një program me fokus në IT. Prania e projektorëve dhe lidhjes në rrjet është pozitive, por nuk zëvendëson nevojën për kompjuterë të fuqishëm dhe funksionalë në kohë reale.

Në Standartin III.1, Kriteri 3, theksohet se GVJ nuk disponon paketën e “Instrumentave për Matjen e Cilësisë” me 11 pyetësorë dhe formularë të ndryshëm që plotësohen nga studentët dhe stafi.

Ashtu sic u theksua edhe më sipër, sipas praktikës standarde dhe detyrave të ekspertëve, kontrolli i dokumentacionit kryhet përmes versioneve të ngarkuara elektronikisht në sistemin përkatës, pasi ky është kanali zyrtar dhe i standardizuar për verifikimin e përmbushjes së kriterëve. Mosngarkimi i saktë i dokumenteve në platformën elektronike tregon mungesë kontrolli dhe organizimi nga ana e institucionit dhe nuk përjashton përgjegjësinë e tij për të siguruar që dokumentacioni të jetë i plotë gjatë procesit të vlerësimit. Theksojmë se GVJ gjatë vizitës në IAL ka kërkuar rishikimin e dokumenta edhe njëherë dhe ngarkimin në sistem të atyre që mungojnë.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

9. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi III.2, Kriteri 5 (Përmbushet Kryesisht)**:

GVJ: *Bazuar në analizën e Standardit III.2, është evidentuar se institucioni ka hartuar dhe bërë publike rregulloret dhe procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në përputhje me kërkesat e dokumentacionit akademik të caktuar. Rregulloret përfshijnë informacion mbi kriteret dhe mënyrat e vlerësimit, përqindjen e pjesëmarrjes së nevojshme në leksione dhe seminare, si dhe format e provimeve. Përkundër këtyre masave, sugjerohet që informacioni rreth proceseve të vlerësimit të bëhet më i qartë dhe më i arritshëm për të gjithë studentët. Gjithashtu rekomandohet një përditësim i rregulloreve për të reflektuar ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në mënyrën se si vlerësohen njohuritë dhe aftësitë e studentëve, duke siguruar që të gjitha format e vlerësimit janë të drejta dhe objektive.*

GVB: Rregulloret rishikohen e diskutohen sistematikisht në përfundim të çdo viti akademik. Mendojmë informacioni rreth proceseve të vlerësimit të studentëve është bërë i qartë përmes pedagogut të lëndës, koordinаторit, drejtuesve të njësisë bazë dhe kryesore. Mendojmë se vlerësimi i këtij standarti të rishikohet.

GVJ: GVB komenton se informacioni mbi vlerësimin e njohurive komunikohen nëpërmjet pedagogëve dhe koordinatorëve, drejtuesve të njësive bazë dhe kryesore, por kjo nuk mjafton për të përmbushur kërkesat e Standardit III.2, i cili kërkon që ky informacion të jetë i qartë, i arritshëm dhe i formalizuar. Mbështetja vetëm në komunikime verbale ose ndërmjetësimin e pedagogëve rrezikon të krijojë keqkuptime dhe mungesë konsistence. Dokumentacioni i qartë dhe i aksesueshëm, si syllabuset dhe rregulloret, është thelbësor për të garantuar transparencë dhe qasje të barabartë për të gjithë studentët, në përputhje me parimet e ligjeve për arsimin e lartë. Gjatë analizës së bërë është evidentuar mangësi në përfshirjen dhe përditësimin e dokumentacionit, duke vënë në dukje mungesën e disa syllabuseve dhe mungesën e standardizimit në ndarjen e pikëve për lëndë të ndryshme. Këto mangësi tregojnë nevojën për një përmirësim të qartë dhe publik të procedurave.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

10. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi III.3, Kriteri 8 (Përmbushet Pjesërisht):

GVJ: *Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent duke përfshirë një proces të ankimit, me rregullore dhe procedura të posaçme për testimin dhe vlerësimin e njohurive gjatë gjithë vitit akademik, të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Vlerësimi përbëhet nga elemente të ndryshme si pjesëmarrja, detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare, të cilat janë të shpërndara gjatë semestrit. Institucioni inkurajon edhe përdorimin e platformës Google Classroom për kontrollin e dijes, por nuk ka sisteme elektronike specifike për testimet përfundimtare. Transparenca rritet duke sekretuar provimet gjatë korrigjimit. Vlerësimi përfundimtar është në përputhje me syllabuset dhe bazën ligjore në fuqi, dhe përfshin komente dhe feedback për studentët. Institucioni ka politika të rregulluara për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin, duke përjashtuar studentët që kapen duke kopjuar. Rezultatet bazohen në meritë dhe jepen në kohë, dhe studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin dhe të kërkojnë rishikim. Çdo ankimim shqyrtohet nga një komision i posaçëm, dhe procedura është transparente dhe e dokumentuar.*

Kriteri 5: GVJ konstaton se nuk është e saktësuar në dokumenta se çfarë ndodh nëse studentit i rezulton e kopjuar detyra e kursit ose diploma, pas verifikimeve të pedagogëve. Gjithashtu mungon shpjegimi nga ana e IAL se si mundet që pedagogët udhëheqës të zbulojnë plagjiaturën dhe çfarë mjetesh ata përdorin. Një rikujtesë mbi plagjiaturën dhe kopjimin bëhet edhe në syllabuset e çdo lëndë të programit Informatike Ekonomike dhe Biznes ku shpjegohet se shkelja penalizohet sipas përcaktimit në Kodin e Etikës së KUQ.

GVB: Mendojmë se konkluzionet për këtë standart të GVJ, ku nuk ka vërtetë nuk përputhet me vlerësimin që është bërë.

Kriteri 5: Në rregulloret e të njësive bazë dhe kryesore është saktësuar se studenti, i cili rezulton se ka kopjuar ne provime, detyra e kursit ose diploma, humb të drejtën e diplomimit për atë sezon. Ndërkohe nga ana e institucionit, po mendohet për të siguruar ndonjë nga programet specifike që ndihmojnë në evidentimin e rasteve të tilla.

Mendojmë së vlerësimi i këtij Standarti të rishikohet

GVJ: GVJ rithekson se vlerësimi i Standartit III.3 është “Përmbushet Kryesisht” dhe jo “Përmbushet Pjesërisht” sic pretendohet nga GVB.

Kriteri 5: Bazuar në [Ev. 2_6_1 Rregullore e DMB], Neni 67, Masat disiplinore ndaj studentit, pika 1 dhe pika 2, saktësojnë se çfarë ndodh nëse studentit i rezulton e kopjuar detyra e kursit ose diploma, pas verifikimeve të pedagogëve. Ky konstatim nuk e ndryshon në tërësinë e vet vlerësimin për Standartin III.3.

Vlerësimi është “Përmbushet Kryesisht”

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

11. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi III.4, Kriteri 6 (Përmbushet Pjesërisht):

GVJ: *IAL ka struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit, duke garantuar zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve. Programi i studimit BA IE&B ka një përqindje të konsiderueshme të lëndëve të profilit të teknologjisë së informacionit, dhe ai siguron zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e IT-së dhe fushave të tjera relevante. Megjithatë, GVJ sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, përditësimin e literaturës dhe shtimin e lëndëve specifike që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive kërkimore dhe praktike. Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie duke përdorur metoda të ndryshme interaktive dhe duke integruar të rejat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë. Gjithashtu, GVJ rekomandon rritjen e frekuencës së eventeve akademike dhe përfshirjen e ekspertëve të njohur për të ndarë përvojat e tyre me studentët.*

Kriteri 1: GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, por GVJ sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhurnimin e literaturave, si dhe shtimin/ modifikimin e lëndëve të caktuara, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.

GVB: Kriteri 6: Mendojmë se konkluzionet për këtë standart të GVJ, ku ofrohen rekomandime për përmirësim, ndërkohë që programi është në proces akreditimi për herë të parë, gjykojmë se nuk perputhet me vlerësimin që i bëhet këtij standarti. Mendojmë se vlerësimi i këtij Standarti të rishikohet.

Kriteri 1: Sugjerimet do të bëhen objekt diskutimesh në departament dhe me pedagogët që janë angazhuar në këtë program studimi.

GVJ: Rekomandimet e bëra nga GVJ, të pasqyruara në raport, janë pjesë thelbësore e procesit të akreditimit, ku qëllimi i këtij procesi nuk është vetëm miratimi i programit, por edhe identifikimi i fushave për përmirësim të vazhdueshëm. Përditësimi i literaturës, rritja e frekuencës së aktiviteteve akademike dhe përfshirja e lëndëve që nxisin kërkimin dhe aftësitë praktike janë masa të nevojshme për të përmbushur standardet dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Sugjerimet janë të domosdoshme për zhvillimin e programit, duke garantuar që ai të jetë në përputhje me praktikat më të mira akademike dhe objektivat e ciklit të parë të studimeve. Refuzimi i rekomandimeve nga ana e GVB për shkak se programi është në

akreditim për herë të parë është i pabazuar, pasi akreditimi synon jo vetëm vlerësimin aktual, por edhe nxitjen e përmirësimit të cilësisë në vazhdimësi.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

12. Lidhur me komentin e institucionit për Standardi III. 5 Kriteri 8 (Përmbushet Pjesërisht):

GVJ: *IAL garanton një procedurë të qartë për detyrimet përmbyllëse të studentit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Studentët me mesatare mbi 8 përgatisin punimin e diplomës, ndërsa të tjerët i nënshtrohen provimit përfundimtar, por mungon informacioni publik për këtë proces. Rregullorja ofron udhëzime të detajuara për strukturën e diplomës, por nuk ka lëndë specifike për shkrimin akademik. Provimi përfundimtar përfshin tematika kryesore, por jo të gjitha lëndët janë të përfaqësuara. Personeli akademik asiston në përgatitjen e diplomës dhe institucioni ofron kapacitete logjistike. Vlerësimi realizohet nga komisioni dhe notat janë të standardizuara. Studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga ministria përkatëse. Institucioni ruan dokumentacionin e studentëve dhe paraqet informacionin kur kërkohet, megjithatë mungon një dokument specifik për ruajtjen dhe kohëzgjatjen e arkivimit.*

GVB: Nga GVJ ky standard është vlerësuar dhe nuk ka vëretje. Institucioni ka një rregullore të veçantë për arkivimin e dukumentave, ku afatet janë sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë problem. Për më tepër, lidhur me provimin përfundimtar ku specifikohen se por jo të gjitha lëndët janë të përfaqësuara, nuk qëndron pasi studenti vlerësohet për njohuritë e fituara në fushat më kryesore, në funksion të këtij programi dhe jo për të gjitha lëndët. Theksojmë, për më tepër që lëndët e përfshira në provimin përfundimtar janë gjykuar dhe vendosur nga ana e stafit të departamentit. Mendojmë se vlerësimi i këtij Standarti të rishikohet.

GVJ: GVB komenton se provimi përfundimtar përfshin vetëm njohuritë kryesore të programit dhe jo të gjitha lëndët e përfshira, por nuk ka një dokument që të përcaktojë se cilat janë lëndët "kryesore" ose ndonjë listë kriteresh për përzgjedhjen e tyre nga departamenti. Kjo mungesë dokumentacioni dhe transparence bie ndesh me standardet e cilësisë dhe praktikën e përcaktuar në akreditim, të cilat kërkojnë qartësi dhe uniformitet në procesin e vlerësimit. Referuar [Ev. 3_23_1_Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)] ndonëse disa lëndë janë përfshirë në pyetjet e provimit përfundimtar, përfaqësimi i lëndëve nuk është i plotë, dhe ky fakt cenon gjithëpërfshirjen e procesit vlerësues, i cili duhet të mbulojë në mënyrë të balancuar të gjitha aspektet e programit. Përzgjedhja e lëndëve për provimin përfundimtar pa një bazë të qartë dhe transparente mund të krijojë pabarazi në vlerësim dhe të ndikojë në cilësinë e diplomimit.

Gjithashtu, ndërsa institucioni pretendon se provimi përfundimtar synon testimin e njohurive më të rëndësishme, mungesa e një liste të miratuar formalisht për këto lëndë tregon se procesi është subjektiv dhe jo i standardizuar. Praktika të tilla bien ndesh me parimin e qartësisë dhe drejtësisë që kërkohet nga proceset akademike, dhe vlerësimi nuk mund të bazohet vetëm në praktikën e vendosura nga departamenti pa dokumentacion mbështetës.

Në lidhje me rregulloren për arkivimin e dokumenteve, GVB thekson se institucioni ka një rregullore e veçantë për arkivimin e dukumentave. GVJ konstaton se ky dokument mungon në

listën e dokumentave të vënë në dispozicion. Mungesa e këtij dokumenti në dosjen e vlerësimit vështirëson kontrollin nga ana e GVJ.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

GVJ: Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III – III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT - Përmbushet Pjesërisht

GVB: Nisur nga fakti se pjesa më e madhe e stafit akademik që jep mësim në këtë program studimi, janë me emër në shkallë kombëtare, si dhe nga mendimet që shprehëm për standartet e kësaj fushe duhet të rishikohet vlerësimi që është bërë për të. Mendojmë se vlerësimi i kësaj Fushe të rishikohet.

GVJ: Për të gjitha sa u diskutuan më sipër GVJ nuk e sheh të justifikueshme ndryshimin e vlerësimit.

Vlerësimi i Standartit III nuk ndryshon.

13. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardi IV.1 (Përmbushet Pjesërisht):**

GVJ: *GVJ konstaton se në KUQ/FE programi i studimit bachelor "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi", personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit, nuk përmbush standartet në përputhje me fushën e programit të studimit. KUQ ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi në rang universiteti. Janë marrëveshje me universitete kombëtare/ndërkombëtare, institucione ose kompani. GVJ rekomandon: Që KUQ duhet të krijojë strategji në mbështetje të stafit dhe zgjerimit të tij në fushën e Informatikës dhe Shkencave Kompjuterike. Hartimin e një udhëzimi për procedurën e organizimit dhe vlerësimit të praktikës profesionale.*

GVB: Rekomandimet do të analizohen në departament dhe do të merren masa për plotësimin e tyre.

GVJ: Sa i përket këtij kriteri, citohet fakti që stafi i angazhuar me kohë të plotë nuk është në profilin e fushës informatike dhe shkencave kompjuterike. Kjo vërehet tek evidencat e ofruara nga IAL-ja, siç janë CV të stafit të angazhuar në programin e studimit [Ev. 3 11 Stafit akademik që jep mësim në programin e studimit. -.pdf].

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

14. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardi IV.2, Kriteri 4 (Përmbushet Kryesisht):**

GVJ: *GVJ konstatoi se KUQ ka mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies. Në dispozicion të studentëve janë auditorë dhe laboratorë në përmbushje të kërkesave të programit të studimit. GVJ rekomandon: Azhurnimin e parametrevave teknologjike sa i përket PC, SW etj, në funksion të programit të studimit.*

GVB: Nuk del qarte se cilët parametra duhen plotësuar.

GVJ:Në KUQ, auditorët janë të përshtatshme për zhvillimin e mësimit teorik, kurse laboratorët janë të pajisura në nivel bazik me mjete teknologjike. Sa i përket programit të studimit bachelor 'Informatikë Ekonomike dhe Biznesi', në dispozicion ka 2 laboratorë të pajisur me PC dhe projektor. Infrastruktura fizike rezulton në kushte jo-optimalë, kompjutera që nuk ndizen, apo që nuk i përgjigjen komandave të dhëna.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

15. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardi IV.3, Kriteri 8 (Permbushet Pjesërisht):**

GVJ:*GVJ konstatoi se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura e cila ofrohet në format elektronik ose të printuar, mund të përdoret nga studentët për të marrë njohuritë në kurset e programit që ato ndjekin. Materialet në formë elektronike gjenden në klasat virtuale të krijuara në platformën google classroom nga vetë lektorët. KUQ disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar fizikisht. GVJ rekomandon:*

- ✓ *Azhornimin e literaturës së sugjeruar, pasi për kurse specifike, i përket viteve 2006-2010.*
- ✓ *KUQ duhet ti ofrojë studentëve mundësinë e aksesit të bibliotekës online të materialeve në ndihmë të programit të studimit..*

GVB:Pasurimi i syllabuseve me literaturë sa më bashkohore do jetë objekt diskutimi e realizimi me fillimin e vitit të ri akademik. Po punohet edhe për sigurimin e bibliotekës online nga institucioni. Rekomandimet do të diskutohen dhe përcaktohen rrugët për plotësimin e tyre.

GVJ:konstaton se literatura bazë e përdorur në kurrikulën e programit të studimit bachelor "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi", duhet azhormuar vazhdimisht që të jetë në përputhje me zhvillimet fushës së studimit, gjithashtu studentëve duhet ti ofrohen mundësi për aksesimin e materialeve fizikisht dhe online, pikë kjo që ndikon në rritjen e cilësisë, performancës dhe ndërveprimet.Referuar evidencave [Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III.pdf] të paraqitura nga IAL-ja dhe GVB-ja, rezulton se ka mangësi në numrin e syllabuseve të paraqitura, në referencë me kurrikulën e programit të studimit, edhe pse gjatë vizitës në institucion është vënë në dijeni GVB-ja dhe koordinatori i programit.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

16. Lidhur me komentën e institucionit për **Standardi IV.4, Kriteri 6 (Nuk Permbushet) :**

GVJ: *KUQ nuk disponon një sistem të menaxhimit të të dhënave, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me stafin dhe studentët. E gjithë procedura akademike realizohet përmes metodave alternative. Sistemi i menaxhimit siguron akses për të gjithë personelin PAE/PAK dhe studentët e programit të studimit kështuqë është një domosdoshmëri*

për institucionin. **GVJ rekomandon:** Të krijohet dhe futet në përdorim një sistem i unifikuar për menaxhimin e të dhënave.

GVB: Po punohet për sistem të tillë menaxhimi të sistemit të informacionit.

GVJ: Ky standard i referohet “Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.”, dhe ka të bëjë pikërisht me përdorimin e një sistemi menaxhimi të të dhënave. Kështu që mqs ky sistem nuk ekziston atëherë standarti nuk plotësohet.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

GVJ: Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV - BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT Përmbushet Pjesërisht

GVB: Institucioni ka stafin akademik, infrastrukturën dhe mundësitë financiare për të realizuar rekomandimet e GVJ. Nisur nga komentet sipas standardeve mendojmë se duhet të rishikohet vlerësimi i kësaj fushe.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

17. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi VI.1 (Përmbushet Pjesërisht):**

GVJ:GVJ konstatoi se KUQ ofron mjete për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes nje pyetësori. NJSBC bashkëpunon me senatin, rektorin, GVB, departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetesoret paraqiten në raportin vjetor që kjo njësi përpunon. GVJ rekomandon përcaktimin e një standardi të unifikuar vlerësimi, ku çdo formë vlerësimi të ketë peshë të përcaktuar dhe çfarë masash merren për të përmirësuar performancën.

GVB: Rekomandimet në këtë standart do të diskutohen në NJSBC dhe strukturat drejtuese të KUQ për plotësimin e tyre.

GVJ: NJSBC afishon rezultatet në raportin vjetor, por nuk ka një procedurë të qartë për mënyrën e vlerësimit të stafit sipas një peshe të përcaktuar për secilin zë dhe promovimin e praktikave të mira.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.


18. Lidhur me komentin e institucionit për **Standardi VI.2, Kriteri 4 (Përmbushet Kryesisht):**

GVJ: GVJ konstatoi se KUQ përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për mbledhjen e të dhënave në lidhje me vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. NJSBC dhe ZMJKK, bashkëpunojnë me departamentet dhe fakultetet, në procesin e vlerësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. IAL-ja nuk ofron një procedurë të qartë në lidhje me promovimet nxitëse ndaj stafit me arritje të larta. GVJ

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



rekomandon: KUQ, duhet të përcaktojë qartazi vlerësimin e përkthyer në pikë, për ti ardhur në ndihmë renditjes së performancës dhe cilësisë së stafit. Kështu do jetë edhe më i qartë promovimi i stafit.

GVB: *Po kështu rekomandimet në këtë standard do të diskutohen në NJSBC dhe strukturat drejtuese të KUQ për plotësimin e tyre.*

GVJ: IAL-ja duhet të jetë aktive në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike, ku detyart kryesore janë: Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies; Rishikimin e syllabuseve dhe kurrikulave; Gjurmimin e studentëve pasi diplomohen; Vlerësimi institucional, etj. Nga dokumentacioni i ofruar dhe vizita ne IAL rezulton që ky proces zhvillohet por kërkon përmirësim dhe efikasitet.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

GVJ: Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI - SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR *Përmbushet Kryesisht*

GVB: Komentet tona i kemi bërë në çdo standart. Rekomandimet si për këtë fushë edhe fushat e tjera do ketë program pune për realizimin e tyre. Mendojmë se duhet të rishikohet vlerësimi i kësaj fushe.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>GVJ arrin në përfundimin se Programi i studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, ofruar nga Kolegji Universitar “Qiriazi”, është në përputhje dhe në harmoni me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me to. Informatika apo degë të ngjashme, janë sugjeruar si ndër profesionet më të kërkuara nga organizma të ndryshëm. GVJ përcjell dhe faktin që informatika e aplikuar në fusha të ndryshme konsiderohet si ndër aspektet zhvillimore më të rëndësishme apo subjekt i projekteve të ndryshme europiane.</p> <p>Programi Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” ndjek vizionin e shprehur në strategjinë e Kolegji Universitar “Qiriazi” [Ev. 1_1_Statuti KUQ], sipas të cilit IAL synon të zhvillojë dijet, përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor në të mirë të përgatitjes me nivel bashkëkohor të studentëve, si dhe të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. Ky vizion ruan e konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare. Kjo gjithashtu shprehet qartësisht në rregulloren e programit të studimit BA Informatikë Ekonomike dhe Biznesi, Kreu 1, Neni 1 [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf] dhe mbështetet po nga dokumenti i analizës vjetore të departamentit [Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023]</p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Bazuar në Statutin e KUQ [Ev. 1_1_Statuti KUQ], në planin strategjik të zhvillimit të programit të studimit IE&B [Ev. 3_3_Plani strategjik i Programit të studimit], në rregulloren e programit të studimit BA Informatikë Ekonomike dhe Biznesi, Kreu 1, Neni 1 [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf], analiza vjetore e departamentit [Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023] si dhe në RVB [Ev. 3_0_RVB] konfirmohet që programet e studimit të ciklit të parë, ndër të cilët dhe “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e KUQ si dhe Fakulteteve dhe Departamenteve brenda tij, në përputhje me strategjinë për zhvillim të KUQ.</p>

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.

IAL në rregulloren e kolegjit [Ev.1.4 Rregullore e Kolegjit, Kreu IV, Neni 21, pika a] shpreh qartë se programet e studimit ofrohen në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë e KUQ, si dhe të Fakulteteve dhe Departamenteve brenda tyre. Kjo gjë mbështetet edhe nga objektivat strategjike të Planit strategjik të zhvillimit institucional të KUQ 2021-2026 si dhe Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit bachelor në IE&B [Ev.1.3 Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit] dhe [Ev.3.3 Plani strategjik i Programit të studimit.pdf], ku shprehet se institucioni ofron programin e studimit në përputhje me strategjinë për zhvillim të KUQ. GVJ e konstaton këtë dhe në bazë të përmbajtjes së programit të studimit, sipas të cilit një i diplomuar në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” ndërthur drejtimin e Informatikës me atë të Ekonomisë/Biznesit.

Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.


Sipas RVB institucioni ka një përvojë rreth 17 vjet në fushën ekonomike dhe se disponon mjete të nevojshme mjedisore dhe financiare për ta realizuar këtë program studimi. Referuar dokumentave të dorëzuara mbi stafin akademik [Ev.3.10 Staf akademik i Departamentit] Departamenti i Menaxhim Biznesit ka në përbërje të tij

Tituj/grada	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-	1	-
Prof.As.Dr	1	1	1	1
Dr/PhD	1	-	1	-
Msc	2	-	2	-
Në total	5	1	5	1

Referuar [Ev.3.11 Staf akademik që jep mësim në programin e studimit] tregohet se IAL dhe Fakulteti i Ekonomisë vë në shërbim të këtij programi gjithsej 22 pedagogë, nga të cilët:

- 16 me kohë të plotë (PAE), përkatësisht me tituj (3 me titull Prof. Dr., 2 Prof. Asoc, 5 Dr., 1 Dr në proces, 5 Msc.)
- 6 me kontratë (PAK), perkatesisht me tituj (1 Prof. Asoc, 4 Dr., 1 Msc.)

	<p>Ndërkohë referuar po dokumentit [Ev. 3_11_] vihet re që lëndët me profil ekonomik mbulohen nga staf PAE ndërsa pjesa më e madhe e lëndëve me profil IT mbulohet nga staf PAK. Gjithashtu 8 lëndë me profile të ndryshme mbulohen nga i njëjti pedagog psh: Matematikë e Zbatuar, Informatikë, Statistikë e Aplikuar, Sistemet e Shfrytëzimit dhe Rrjetat Kompjuterike, Arkitekturë Kompjuteri, Sistemet e Informacionit, Vizualizim të Dhënash, Multimedia.</p> <p>Duke analizuar këtë situatë GVJ del në konkluzion se IAL është në mungesë të kapaciteteve dhe burimeve akademike profili IT, për ofrimin e programit Bachelor në 'Informatikë Ekonomike dhe Biznesi'. Kjo konfirmohet edhe nga takimi që GVJ bëri me stafin akademik të KUQ.</p> <p>Nga vizita u panë mjediset e zhvillimit të mësimin, të zyrave, të stafit, apo ambjentet e tjera, ku GVJ konstatoi se laboratorët, ku studentët e këtij programi bëjnë mësim, janë me kompjutera të vjetër të cilët kërkojnë një kohë të konsiderueshme të hapen si dhe kanë mungesë të softuerëve që duhen për zhvillimin e lëndëve të ndryshme në profil IT, këtë e vërteton edhe dokumenti [Ev. 3_30_Lista e software-ve në Laboratorin e Ekonomisë së Aplikuar].</p> <p>GVJ gjithashtu konstaton se [EV_2_14_Stafi akademik sipas departamenteve] tek i cili RVB referohet për mbështetjen e këtij kriteri.</p> <p>Në këtë pikë GVJ rekomandon, krijimin e një strategjie për rritje të kapaciteteve akademike me profil IT. Institucioni duhet të fokusohet në rekrutimin e pedagogëve me kohë të plotë dhe me kualifikime në fushën e IT-së. Kjo mund të përfshijë kërkimin aktiv për kandidatë me tituj akademikë të avancuar si Prof. Dr. dhe Dr.</p> <p>Gjithashtu GVJ rekomandon, përmirësim të infrastrukturës teknologjike. Ku duhet menduar për investim në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pajisje të reja kompjuterike, që përmbushin kërkesat e programeve mësimore në IT. • softuer të përditësuar, ku duhen siguruar licenca për softuerë të rinj dhe të përditësuar që janë të nevojshëm për lëndët e ndryshme në profilin IT.
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit,</p>	<p>Grupi i punës GVB, referuar RVB shpreh për këtë kriter se plotësohet plotësisht. Ndërkohë duke shqyrtuar dokumentacionin e vendosur në dispozicion dhe duke parë dokumentat e vëna si referenca GVB konstaton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. evidenca <u>2_3_Regullore e Fakultetit të Ekonomisë</u>, është referuar gabim. Në vend të kësaj evidence tek numri <u>2_3</u> është vendosur evidenca Model Procesverbal mbledhjeje të GVB. Figuron që dokumenti Regullore e FE nuk është midis dokumentave të dorëzuara.

sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>2. Evidenca 2_16_Nivelet e kornizes se kualifikimeve te programeve te studimit, nuk është midis dokumentave të dorëzuara</p> <p>3. Evidenca 3_4_Rrgullore e Departamentit, sic është theksuar edhe më sipër, është dorëzuar vetëm cover page.</p> <p>4. Evidenca 3_6_Rrgullore e Programit te studimit, është referuar gabim. Duhet [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB].</p> <p>Duke ju referuar rregullores së programit të studimit BA Informatikë Ekonomike dhe Biznesi, Kreu 1, Neni 3 [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB], shpreh se prgrami i studimit BA IE&B është mbështetur në modelin e programeve të Kartës së Bolonjës ... dhe se programi përmban jo më pak se 180 kredite evropiane (ECTS).</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ arrin në konkluzionin se Programi i studimit "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi" është në përputhje me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me to. Ky program është në përputhje me misionin dhe vizionin e Kolegjit Universitar "Qiriaz" dhe strategjinë e zhvillimit të tij, siç konfirmohet nga dokumentet e dorëzuara. Gjithashtu programi i studimit është hartuar dhe ofruar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit, statutin dhe rregulloret e tij, duke ndërthurur drejtimet e Informatikës dhe Ekonomisë/Biznesit.</i></p> <p><i>Përsa i përket kapaciteteve dhe burimeve akademike, institucioni ka përvojën dhe burimet e duhura për ofrimin e programit në fushën ekonomike, por ka mungesa në kapacitetet dhe burimet akademike për profilin e IT-së. Infrastrukturat teknologjike aktuale janë të papërshtatshme. Gjithashtu konkludohet nga GVB se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të institucionit. Megjithatë, dokumentacioni mbështetës është i paplotë dhe ka referenca të gabuara.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e	Në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL [Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023], GVJ konstaton që IAL e ka në vëmendje analizën e vazhdueshme të punës së tyre. Kështu, shohim së në këtë dokument vëmendja bie mbi: veprimtarinë


<p>programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>mësimore të departamentit; veprimtarinë mësimore kërkimore-shkencore dhe kualifikuese; studentët dhe veprimtaria e tyre; Programet e studimit; Procesi mësimor; Stafit akademik; etj. Ky dokument ofrohet më tepër në kuadrin e një raportimi sesa një analizë e thelluar e mirëfilltë duke ofruar statistika apo të synojë të përshkruajë dhe evidentojë arritjet dhe problematikat me synim rishikimin e objektivave për përmirësimin e vazhdueshëm të ecurisë së rogramit të Studimit dhe procesit mësimor në tërësi.</p> <p>Gjithashtu, Bazuar në RVB, bashkëpunimet brenda KUQ janë mjaft pozitive si ndërmjet njësive kryesore ashtu edhe njësive bazë. Këto bashkëpunime vihen re në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Angazhimin e stafit akademik në mësimdhënie për lëndë të ndryshme në njësitë kryesore të KUQ [Ev. 3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit] [Ev. 2_34_Numri i personelit akademik] • Realizimin e veprimtarive të përbashkëta: konferenca shkencore, leksione të hapura, veprimtari kualifikuese [Ev. 1_33_Të dhëna të aktiviteteve për kërkimin shkencor] <p>Ndërkohë referuar RVB, bashkëpunimi dhe analiza shprehet edhe tek referenca [2_9_Analiza vjetore e Fakultetit te Ekonomise] e cila është referuar gabim dhe ky dokument nuk është vënë në dispozicion të GVJ. Evidenca 2_9 është dokument mbi Rregulloren e KPL</p>								
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, si dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuar GVJ konstaton që KUQ ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh dhe homologësh ndërkombëtarë dhe vendas në funksion të ofrimit të mundësisë të shkëmbimit të dijeve, si dhe ka marrëveshje me kompani private. Referuar dokumentit [Ev. 3_27_Lista e marrëveshjeve në funksion të programit], në tabelën më poshtë përmblihen marrëveshjet e bashkëpunimit ne funksion te ketij programi:</p> <table border="1" data-bbox="533 1514 1374 1630"> <tr> <td>IAL dhe institucione brenda dhe jashtë vëndit</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Biznese dhe shoqeri private</td> <td>15</td> </tr> </table> <p>Duke ju referuar dokumentit të dorëzuar [EV_3_27] vihet re se nuk ka akoma marrëveshje me kompani private në fushën e programimit, gjë e cila do ndihmonte shumë programin e studimit.</p> <p>Ndërkohë referuar [Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit pj 1] tabela e bashkëpunimeve në rang institucional është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="533 1868 1374 1977"> <tr> <td>IAL dhe institucione brenda dhe jashtë vëndit</td> <td>33</td> </tr> <tr> <td>Biznese dhe shoqëri private</td> <td>61</td> </tr> </table>	IAL dhe institucione brenda dhe jashtë vëndit	20	Biznese dhe shoqeri private	15	IAL dhe institucione brenda dhe jashtë vëndit	33	Biznese dhe shoqëri private	61
IAL dhe institucione brenda dhe jashtë vëndit	20								
Biznese dhe shoqeri private	15								
IAL dhe institucione brenda dhe jashtë vëndit	33								
Biznese dhe shoqëri private	61								




	<p>Gjithashtu KUQ ka qënë pjesë e programit të shkëmbimit në kuadër të programeve ERASMUS+, përkatësisht Universiteti Jaen, Spanjë ku pjesë e ‘Staff mobility Training’ kanë qënë 3 staf akademik, 4 staf administrativ dhe 1 student [Ev. 3_26_Mobilitete me Universitetet në kuadër të projekteve Erasmus+]. Dhe projekti i dytë ku ky institucion përfshihet është Bologna Hub Peer Support – BHPS Project. Ku pjesmarrja ishte në formën e një konference/workshop online. [Ev. 3_25_Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja]</p> <p>Fakulteti vihet re që mban evidenca nga marrvëshjet e bashkëpunimit, në terma të numrit të mobiliteteve të realizuara [Ev. 3_26] dhe [Ev. 3_25]</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ evidentoi se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione, organizata profesionale dhe biznese të ndryshme [Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit pj 1]. Qëllimi dhe objektivat e këtyre marrëveshjeve kanë në fokus realizimin e objektivave të programve të studimeve ku janë kryer edhe një sërë aktiviteteve të pasqyruara në dokumentin [Ev. 1_33_Të dhëna të aktiviteteve për kërkimin shkencor]. Në këtë dokument vihet re që aktivitetet në lidhje me fushën e IT janë shumë të pakta si dhe përfshirja e këtyre studentëve në projekte është pothuajse inekzistente. Në lidhje me praktikën profesionale vlen të theksohet se ky program është i ri dhe akoma nuk janë diplomuar studentët e parë për të evidentuar dhe dokumentuar realizimin e praktikave.</p> <p>Sipas RVB [Ev. 3_0_RVB_Informatike Ekonomike & Biznesi] dhe vizitës në IAL, kompanitë të cilat bashkëpunojnë me departamente të ndryshme në KUQ, janë shprehur të hapura në bashkëpunim për intershipet, leksionet e hapura, vizitat në kompani, praktika etj. Gjithashtu gjatë takimeve me përfaqësues të ndryshëm të KUQ shprehen se universiteti do të vijojë orientimin në bazë të kërkesave të tregut dhe në përputhje me strategjitë për zhvillimin kombëtar, duke mos e përjashtuar mundësinë e përditësimit të kurrikulave. GVJ e vlerëson si pozitive këtë praktikë.</p> <p>GVJ vlerëson se institucioni bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucionesh. Siç e përmendëm dhe më parë, janë nënshkruar marrëveshje me aktorë të rëndësishëm të botës së biznesit, si dhe institucione publike.</p> <p>Bazuar në RVB, në listën e dokumentave të dorëzuara, por edhe nga saktësimet e konstatuara gjatë vizitës në institucion, marrëveshjet kanë ndihmuar edhe në realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të stafit por më pak atë të studentëve. Në dokumenta</p>




	<p>pasqyrohet qartë mobiliteti për stafin akademik. Ndërkohë është vënë re që nuk ka studentë të programit BA “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” të cilët të kenë qënë pjesë e mobiliteteve, për këtë nuk ka dokumenta të vërtetohet ndryshe.</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Duke u bazuar tek: dokumentat e vëna në dispozicion, RVB dhe vizita në IAL, GVJ mendon se njësia përgjegjëse për programin e studimit BA, “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” realizon kryesisht raporte përshkruese të cilat në emërtim të tyre përmbajnë fjalën analizë. Këto raporte këshillohet që të rishikohen e më pas të përpunohen dhe të pasqyrohen në një raportim vjetor të IAL. GVJ vë re që një raport i tillë mungon.</p> <p>Ndërkohë sipas RVB, Departamenti i Menaxhim Biznesit bën një analizë vjetore për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programeve të studimit. [Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023]. GVJ rekomandon që dokumentimi i analizës vjetore të DMB të bëhet me një analizë të thelluar dhe me natyrë analitike, ku duhet të pasqyrojë vlerësimet nga bashkëpunimet akademike dhe ato me industrinë, vlerësimin e burimeve financiare dhe infrastrukturore, realizimet dhe rezultatet që vijnë prej tyre në ndikim të cilësisë së mësimdhënies, pritshmëritë, konkluzione dhe rekomandime për rritjen e mundësive për studentët. Si dhe hartimin e raportit të detajuar dhe analitik të përfitimeve që vijnë nga lista e gjatë e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>Gjithashtu referuar në RVB, departamenti ka hartuar një raport mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të këtij programi [Ev. 3_34_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit]. GVJ konstaton se një dokument me emërtim të njëjtë është evidencia [Ev. 3_28_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit], por ky dokument në brendësi të vet ka në përmbajtje numrin e studenteve për programin BA IE&B për tre vitet e fundit. Pra dokumenti tek i cili referohet RVB nuk është vënë në dispozicion të GVJ.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani dhe aktorë të biznesit vendas dhe të huaj dhe përdor një sistem të brendshëm për ndarjen e detyrave dhe analizën e vazhdueshme të punës së stafit akademik dhe njësisive. Megjithatë, dokumentacioni i dorëzuar është më shumë raportim sesa analizë e mirëfilltë. KUQ ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit dhe me biznese private, por mungojnë marrëveshjet me kompani në fushën e programimit. Institucioni ka marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteteve të tjera, por</i></p>

	<i>programi i ri ende nuk ka diplomuar studentët e parë për të dokumentuar realizimin e praktikave. Raportet analitike të përfitimeve nga marrëveshjet janë të pamjaftueshme ose në mungesë dhe kryesisht me natyrë përshkruese, ndaj GVJ kërkon përmirësim në dokumentimin e analizave vjetore nga Departamenti i Menaxhim-Biznesit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Në të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, konstatohet që programi i studimit “Informatike Ekonomike dhe Biznesi” është organizuar në lëndë, të cilat vlerësohen me kredite në bazë të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese. Programi i studimit “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” përmban 180 ECTS dhe është i organizuar në tre vite akademike (6 semestra), ku cdo vit ka 60 ECTS, [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB], [Ev. 2_6_1 Rregullore e DMB.pdf], [Ev. 3_9_ Plani mësimor], [Ev. 3_9_2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit BA në IEB]
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri	GVJ vlerëson programin e studimit “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” si një profil mjaft të domosdoshëm në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit. Struktura mësimore e programit përmban lëndë të cilat lejojnë që në fund të programit të studimit, të diplomuarit të mund të orientohen/punësohen në një

të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

larmi profesionesh brenda IT, në nivel fillestar e jo të thelluar [Ev. 3_9_Plani mësimor].

Gjatë vizitës në IAL, në bazë të RVB, si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konstaton që programi Bsc në "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi" pasqyron në planin mësimor disiplina mësimore bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës [Ev. 3_7_ Studimi i tregut te punes per Programin e studimit].

Në vitin e parë të studimeve studenti përvetëson 11 lëndë me jo vetëm njohuri të përgjithshme dhe formuese (si Matematikë e Zbatuar, Anglisht 1, Anglisht 2, Statistikë e Aplikuar), lëndë bazike informatike (Informatikë), lëndë në disiplinën e ekonomisë (Mikroekonomi, Makroekonomi, Hyrje në Financë, Bazat e Marketingut, Bazat e Kontabilitetit) si dhe lëndë të disiplinës së informatikës (Bazat e Programimit dhe Algoritmikë). Në fund të vitit të parë një student i programit "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi" ka marrë njohuri të fushave të ndryshme kryesisht në fushën e ekonomisë dhe biznesit.


Në vitin e dytë të studimeve vihet re që nga 9 lëndë, kemi këtë kategorizim: 6 lëndë informatike dhe 3 me profil ekonomik. Në fund të këtij viti studenti ka thelluar njohuritë e tij sidomos në disa prej shtyllave kryesore të Informatikës si Programimi, Dizenjimi dhe Rrjetat.

Viti i tretë i studimeve përmban 7 lëndë, 4 me profil informatike, 3 me profil ekonomik ose të përgjithshëm, si dhe praktikën profesionale dhe punimin/provimin bachelor. Në përfundim të vitit të tretë studenti duhet të ketë përvetësuar dhe çështje më komplekse teknike, si Sistemet e Shfrytëzimit, Arkitektura e kompjuterit, Multimedia, etj. [Ev. 3_9_Plani mësimor].


Renditja e lëndëve të tre viteve duket se nuk thellon formimin e studentëve, por nga ana tjetër e zgjeron atë në disa drejtime informatike, duke krijuar kështu profesionistë të mesëm.

Konstatohet që nuk ka një lëndë që zhvillon mendimin kritik, shkrimin akademik, apo metodat e kërkimit. Pjesa e kërkimit shkencor shihet gjithashtu shumë pak e reflektuar në programet e veçanta lëndore të programit të studimit.

GVJ rekomandon që për të zhvilluar aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme, studenti duhet të trajnohet në kryerjen e kërkimit shkencor. Por vlen të theksojmë që këto aftësi në të vërtetë është e vështirë të plotësohet nga programe studimi bachelor. Nga ana tjetër



	vlerësojmë nxitjen e IAL për pjesëmarrje të studentëve në konferenca.		
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Sipas Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019, Shtojcë nr. 1, elementët e programeve të studimit përcaktohen si më poshtë,		
	Kat.	Komponenti mësimor	
		Bachelor (ECTS)	
	A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15-20 %
	B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	50-55 %
	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12-15 %
D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.	10-15 %	
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5 %	

	<p>Duke iu referuar dokumentacionit mbështetës të dorëzuar nga IAL, konstatohet që programi i studimit në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” i ndan veprimtaritë formuese, lëndët, në disiplina të ndryshme [Ev. 3_9_2 Kredite sipas veprimtarive formuese të programit të studimit BA në IE&B]. Gjithsej janë 28 lëndë dhe shpërndarja e tyre në kategori është si më poshtë:</p> <p>Kategoria A: 34 ECTS > 18.8 %</p> <p>Kategoria B: 97 ECTS > 53.9 %</p> <p>Kategoria C: 23 ECTS > 12.8 %</p> <p>Kategoria D: 19 ECTS > 10.6 %</p> <p>Kategoria E: 7 ECTS > 3. %</p> <p>Kjo tregon se elementët e programeve të studimit plotësohen nga IAL.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB si dhe takimeve në IAL evidentohet se programi i studimit BA në IE&B e ka të përcaktuar qartësisht ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale si dhe atë të detyrimeve përmbyllëse si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Praktika (Tipologji D – Lëndë Plotësuese: gjuhë të huaja, njohuri informatikë, praktika profesionale), kryhet në simestrin e dytë në përfundim të lëndëve të tjera dhe përpara provimit të formimit. Ngarkesa në kredite është 8 (ECTS). Puna e praktikës konvertohet në 50 janë orë në auditor dhe 150 orë punë e pavarur. [Ev. 3_9_ Plani mësimor], [Ev. 3_9_1 Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit] 2- Provim i Përgjithshëm Përfundimtar/Punim Diplome Teza (Tipologji E - Detyrime Përmbyllëse), në këtë program studimi është planifikuar që ngarkesa në kredite është 10 (ECTS). Puna e detyrimit përmbyllës konvertohet në 175 orë gjithsej ku 60 janë orë në auditor konsultime të vazhdueshme me pedagogun udhëheqës dhe 175 janë orë pune e pavarur. [Ev. 3_9_ Plani mësimor], [Ev. 3_9_1 Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit]
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje</p>	<p>Bazuar në RVB, KUQ nuk ka studentë me status të veçantë. Në rast se do të ketë forma e organizimit të studimeve, pranimi dhe financimi në institucion do të realizohet në përputhje me udhezimet MAS.</p>




<p>me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Bazuar në RVB, në KUQ nuk ofrohen programe studimi në të njëjtën fushë për Ciklin e Parë të studimeve.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Për të mbështetur shpjegimin e kësaj pike GVB referon dokumentin [EV. 2_10_Te dhena per kodifikimin e programeve te studimit ne FE.]. GVJ konstaton që nuk ka asnjë dokument me këtë emertim.</p> <p>Bazuar në RVB, grupi i punës shprehet se “Plani mësimor i programit të studimit të Ciklit të Parë, BA IE&B, në përputhje me përcaktimin nga V.K.M. nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Udhëzimin e MAS. Nr. 3, datë 15.11.2023, përmban kodin e tij përkatës, 63BA0619S, miratuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, i cili është propozuar nga MAS. “</p> <p>Kodi i cituar nga GVB shikohet i aplikuar në lëndët e programit BA IE&B [Ev. 3_9_1_Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit]</p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Bazuar në RVB, programi i studimit BA IE&B ofrohet nga Kolegji Universitar “Qiriazi”, Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Menaxhim Biznesit dhe jo në bashkëpunim me IAL të tjera vendase apo të huaja.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit BA IE&B është organizuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore kombëtare në fuqi. Programi është i strukturuar në lëndë dhe module, duke respektuar Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi synon të zhvillojë aftësi të avancuara për studentët në fusha të ndryshme, por mungon thellimi në mendimin kritik dhe kërkimin shkencor. Veprimtaritë formuese janë të ndara sipas kategorive përkatëse dhe ngarkesa në kredite për praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse është e përcaktuar qartë.</i></p>




	<i>KUQ nuk ka studentë me status të veçantë dhe nuk ofron programe të përbashkëta me institucione të tjera. Dokumentacioni mbështetës për kodifikimin e programeve të studimit nuk është i plotë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																					
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Ekonomisë (referuar ligjit të arsimit të lartë 80/2015, Neni 23) si njësi akademike kryesore bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, miraton kriteret e pranimit të studentëve mbi bazë të propozimeve të kryera nga njësia bazë. FE ka në përbërje të tij 2 (dy) departamente: Departamenti i Menaxhim Biznesit dhe departamenti i Financës si dhe 1 (një) qendër kërkimore: Qendra Kërkimore-Shkencore. [Faqe web: https://qiriaz.edu.al/fakulteti-fakulteti-i-ekonomise/], [Ev_1_4_Rregullore e Kolegjit], Neni 12. Kjo strukturë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.</p> <p>GVB vë re se në evidencen [Ev_1_4_] departamentet e FE emertohen Departamenti i Administrim Biznesit dhe Departamenti i Financës. Ndërkohë që në dokumenta të tjera si RVB, faqe web etj departamentet emertohen Departamenti i Menaxhim Biznesit dhe Departamenti i Financës. GVJ sugjeron rishikimin e dokumentacionit nga ana e institucionit dhe korigjimin e emërimit të departamentit i cili zhvillon programin e studimit BA ne IE&B.</p> <p>Departamenti i Menaxhim Biznesit ka në përbërje të tij;</p> <table border="1" data-bbox="464 1507 1316 1953"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2022-2023</th> <th colspan="2">2023-2024</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>5</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>				Tituj/grada	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	-	1	-	Prof.As.Dr	1	1	1	1	Dr/PhD	1	-	1	-	Msc	2	-	2	-	Në total	5	1	5	1
Tituj/grada	2022-2023		2023-2024																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK																																		
Prof.Dr	1	-	1	-																																		
Prof.As.Dr	1	1	1	1																																		
Dr/PhD	1	-	1	-																																		
Msc	2	-	2	-																																		
Në total	5	1	5	1																																		

	<p>Gjithashtu, referuar dokumentacionit dhe RVB, GVJ konstaton që departamenti i Departamenti i Menaxhim Biznesit njesi baze e Fakultetit të Ekonomisë, zhvillon të gjitha veprimtaritë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. [Ev. 2_6_1_Rregullore e DMB]</p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, Personeli Akademik pranë Departamentit të Menaxhim Biznesit përbëhet nga 6 anëtarë: 5-PAE (përkatësisht me tituj, 1 me titull Prof. Dr., 1 Prof. Asoc, 1 Dr., 1 Dr në proces, 1 Msc.) dhe 1-PAK (përkatësisht me titull Prof. Asoc.)</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit BA IE&B përbëhet gjithsej nga 22 pedagogë: 16 me kohë të plotë (PAE), përkatësisht me tituj (3 me titull Prof. Dr., 2 Prof. Asoc, 5 Dr., 1 Dr në proces, 5 Msc.) dhe 6 me kontratë (PAK), perkatesisht me tituj (1 Prof. Asoc, 4 Dr., 1 Msc.) [Ev. 3_10_Stafi akademik i Departamentit], [Ev. 3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit]. Sic edhe vihet re ne evidencën [Ev. 3_10_] deklarohet vetem 1 staf PAK, ndërkohë qe ne evidencen [Ev. 3_11_] deklarohen 5 staf PAK (të kontraktuar kryesisht për lëndët me profil IT).</p> <p>Numri i personelit akademik i angazhuar pranë Fakultetit të Ekonomise gjatë vitit akademik 2023-2024 nuk është i qartë pasi nuk ofrohet një dokument i tillë.</p> <p>GVJ rekomandon rakordimin e shifrave dhe dorëzimin e dokumentave që mungojnë.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe të shprehur në RVB, konstatohet se nuk ka Personel Ndhmës Akademik/Administrativ të mirëfilltë në këtë program studimi. Referuar [Ev. 3_10_Stafi akademik i Departamentit], [Ev. 3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit]. Stafi i angazhuar në këtë program studimi përbëhet vetëm nga PAE dhe PAK.</p> <p>Gjithashtu referuar në RVB thuhet se “Personeli PNA/PA është në shërbim të vazhdueshëm për të krijuar kushte Optimale për realizimin e programit mesimor ... në mënyrë që të përmbushen sa më mirë objektivat e programit.” Referencat për këtë janë [Ev. 3_10_] dhe [Ev. 3_11_], ku siç u theksua më sipër në këto dokumenta vërtetohet që nuk ka staf PAE dhe PA.</p> <p>GVJ rekomandon rakordimin e informacionit për këtë kriter.</p>


<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>IAL, me miratimin e Dekanit të FE ka përcaktuar koordinatorin për programin BA IE&B, që më datë 13.10.2023, Vendim Nr. 7. [Ev. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të studimit dhe detyrat e tij].</p> <p>Bazuar në dokumentacionin mbi Programin e studimit BA IE&B, vihet re përcaktimi i rolit, detyrave dhe përgjegjësive që ka koordinatori i programit të studimit. [Ev. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të studimit dhe detyrat e tij] dhe [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB]. Koordinatorin duhet të kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarive të gjithanshme të programit të studimit, të ndihmojë titullarin në lidhje me proceset apo problematikat e punës, etj. Kjo pohohet dhe në RVB.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Menaxhim Biznesit përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për organizimin dhe strukturën akademike, duke bashkërenduar mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Megjithatë, ka mospërputhje në emërimet dhe numrin e personelit akademik të deklaruar. Gjithashtu nuk ka personel ndihmës akademik/administrativ të mirëfilltë të angazhuar në programin e studimit. Koordinatorin për programin e studimit BA IE&B është caktuar dhe ka detyrat e përcaktuara qartë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstaton se njësiti përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, disponojnë një sërë dokumentash dhe informacionesh të nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Këto gjenden në dokumentat e referuara më poshtë.</p> <p>Ev. 1_1_Statuti KUQ Ev. 3_5_3 Rregullore IEB Ev. 2_6_1 Rregullore e DMB</p>




<p>dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Ev. 3_9_Plani mësimor Ev. 3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III</p> <p>Një pjesë e konsiderueshme e këtij informacioni gjendet dhe në faqen zyrtare online të IAL [https://qiriaz.edu.al/]</p> <p>Gjithashtu GVJ konstaton që dokumenti mbi Syllabuset e lëndëve nuk është i plotë, aty përmbledhen vetëm një numër i vogël syllabusesh (vetëm 7 lëndë).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Referuar dokumentit “Plani Mësimor i Zgjeruar” për programin BA IE&B paraqitet ngarkesa mësimore gjithsej, ndarja e lëndëve sipas viteve dhe semestrave, Kodi i Lëndës, Kategoria, Ngarkesa në ECTS për çdo lëndë, Orët në javë, orët mësimore të ndara në: Leksione, Seminare, Laboratore dhe Praktikë, si dhe detyrimet e studentit jashtë auditorit në formën e Punëve të Pavarura. [Ev. 3_9_1_Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit]. Rregulla të tjera më të detajuara si ai i frekuentimit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara dhe syllabuset e veçanta të dorëzuara për çdo lëndë. [Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III].</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në RVB, GVJ konstaton se informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, janë të paraqitura në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • rregulloren e programit të studimit [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB, Neni 6, Neni 7, Neni 8, Neni 22] ku jepet informacion mbi kriteret e pranimit, dokumentacioni i regjistrimit, regjistrimi dhe matrikulimi si dhe transferimet. • rregulloren e departamentit DMB [Ev. 2_6_1 Rregullore e DMB, Kreu VIII, Neni 58, Neni 59, Neni 60, Neni 61, Neni 62], ku janë saktësuar Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve, transferimet, procedura e transferimeve për në fakultete të tjera, Procedura e transferimeve për pranim në FE si dhe kalimi nga një program studimi në një tjetër. Sipas këtij dokumenti KUQ pranon dhe lejon transferimin e studentëve drejt dhe nga ky institucion. • Për të qartësuar më tej procesin e pranimit, IAL ka vënë në dispozicion dokumentin [Ev. 1_28_Kriteret e pranimit]. Referuar këtij dokumenti, IAL liston të

	<p>detajua kriteret e pranimit të studentëve të miratuara me Vendim Nr. 01, Datë 27.01.2023 të Senatit Akademik.</p> <ul style="list-style-type: none"> Informacioni mbi kriteret e pranimit dhe transferimet publikohet edhe në faqen zyrtare të KUQ [https://qiriaz.edu.al/kriteret-e-pranimit-2/]
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Bazuar në RVB si dhe në dokumentacionin e dorëzuar, konfirmohet që për programin e studimit BA IE&B janë hartuar një sërë dokumentash si: syllabuset për secilën lëndë të miratuara nga drejtuesi i departamentit [Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III], planin mësimor [Ev. 3_9_Plani mësimor], ngarkesën e plotë të stafit akademik [Ev. 3_13_Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim në programin e studimit], etj.</p> <p>Sipas RVB Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me formatet e miratuara dhe në përmbushje të VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 dhe Nr. 879, datë 18.12.2019.</p> <p>Nga rishikimi i dokumentit [Ev. 3_14_] mbi syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton që janë dorëzuar syllabuset e vetëm 7 lëndëve (Multimedia, Programim në Windows, Menaxhim Turizmi, Menaxhim i burimeve Njerëzore, Financa Publike, E Drejtë Biznesi dhe ASP.Net dhe C#). Syllabuset e dorëzuara ofrojnë informacion të detajuar mbi: të dhënat të përgjithshme të lëndës, qëllimi dhe objektivat, kalendari i temave, forma e vlerësimit, literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar . Gjithashtu GVJ vë re se literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar është shumë e vjetër (2004-20014). Nderkohë në literaturën bazë janë vendosur libra dhe materiale pa theksuar vitin e tyre të botimit, si dhe janë vendosur leksione të shkruara pa dhënë më shumë detaje mbi këto materiale.</p> <p>Duke parë këtë situatë GVJ rekomandon: plotësimin e të gjitha lëndëve me syllabuse, përditësimin e literaturës me botime të reja (brenda 5 viteve të fundit), përfshirjen e vitit të botimit tek të gjitha materialet e përmendura në syllabus qoftë ai material i detyrueshëm apo i rekomandueshëm, detajimi i informacionit mbi leksionet e shkruara nga pedagogë, si dhe rishikimin periodik të syllabuseve për të siguruar që të jenë në përputhje me standardet më të fundit akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu GVJ këshillon që në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve të shtohet informacioni mbi frekuentimin. GVJ ve re se syllabuset janë të dorëzuara vetëm në gjuhën shqipe dhe rekomandon të dokumentohet edhe varianti i tyre në gjuhën angleze</p>





<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita në institucion gjatë takimeve me anëtarë drejtues të njësisë bazë dhe kryesore se programet mësimore dhe përmbajtjet e tyre lëndore janë në përmirësim të vazhdueshëm. Kjo konsiderohet si një aspekt pozitiv dhe shpesh i domosdoshëm për profile si ai i BA IE&B.</p> <p>Sipas RVB dhe vizitës në IAL, programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe syllabuset, që ofrohen në këtë program rishikohen dhe analizohen nga departamenti përgjegjës për programin e studimit, në mënyrë periodike përpara fillimit të procesit mësimor. Programet lëndore përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi" është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Dokumentacioni mbështetës, si statuti, rregulloret, plani mësimor dhe syllabuset e disa lëndëve, janë dorëzuar dhe disponohen për organizimin dhe strukturën e programit. Megjithatë, syllabuset e dorëzuara janë të paplota dhe literatura e përdorur është e vjetëruar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të</p>	<p>GVJ, pas një shqyrtimit të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve, të shpërndarjes së lëndëve [Ev. 3_9_ Plani mësimor], [Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III], dhe duke marrë parasysh që nuk ofrohen të gjitha syllabuset e lëndëve për të parë në thelb përmbajtjen e tyre, por vetëm të lëndëve (Multimedia, Programim në Windows, Menaxhim Turizmi, Menaxhim i burimeve Njerëzore, Financa Publike, E Drejtë Biznesi dhe ASP.Net dhe C#). sugjeron që:</p> <ul style="list-style-type: none"> Lënda Multimedia: Duke qënë se jepet në një program studimi ku kombinohet më së miri fusha e IT me atë të ekonomisë dhe biznesit, do ishte e përshtatshme të trajtohej në kënvështrimin e

<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>analizës dhe implementimit të aplikacioneve multimediale të natyrave të ndryshme. Pjesë përbërëse e saj për trajtim të jenë edhe elementet e multimedias (tekst, grafik, audio, video, animim), interaktiviteti si komponenti kyç i multimedias si dhe dizenjimi i pamjes së jashtme dhe interaktivitetit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shikohet mundësia e bashkimit të lëndëve nga Fusha e Financës në një, duke shqyrtuar objektivat e të dyja lëndëve dhe duke identifikuar dhe përmbledhur temat kyçe të tyre që mund të mbulohen në një kurs të kombinuar pa humbur thellësinë dhe gjerësinë e materialit. Kjo për të mundësuar shtimin e lëndëve të reja. • Të shikohet mundësia e shtimit të lëndës Shkrim Akademik. • Programi nuk përmban asnjë lëndë të tillë si Machine Learning, Inteligjencë Artificiale, Siguri Informacioni, etj, që janë klasike për programet e shkencave kompjuterike, aq më tepër të zbatuara në një fushë të dijes; • Lënda Arkitekturë Kompjuteri të zhvendoset në semestrin II, para se të fillojnë lëndët e rëndësishme të programimit, siç logjikisht duhet të ndodhë me rrjedhën e përvetësimit të dijeve të një specialisti IT (Harduer -> Sisteme Shfrytezimi -> Softuer). <p>Që GVJ të japë sugjerime më të detajuara referuar edhe përmbajtjeve të lëndëve, duhet që IAL të verë në dispozicion të gjitha syllabuset e lëndëve të programit BA IE&B.</p> <p>Sugjerimet e mësipërme ndihmojnë në strukturimin më të mirë të njohurive dhe aftësive të studentëve, e për pasojë pozicionimin dhe punësimin më të mirë të tyre në tregun lokal, gjithsesi IAL mund të konsiderojë të gjitha ose një pjesë të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Sipas GVJ, lëndët dhe modulet e ofruara [Ev. 3_9_1_Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit], [Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III] mbulojnë pjesërisht fushat e studimeve të informatikës dhe biznesit duke ju mundësuar studentëve profilizimin në specializime të ndryshme profesionale.</p> <p>Referuar vizitës në IAL, departamenti në përfundim të çdo viti akademik realizon një analizë të punës dhe pjesë e kësaj analize është rishikimi i kurrikulës duke e përshtatur me tregun e punës.</p> <p>Lëndët në programin BA IE&B kanë numër jo të njëjtë kreditesh dhe variojnë nga 5 kredite – 8 kredite. Ngarkesat nëpër lëndë janë të përafërta.</p>

Kriteri 3.
Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Sipas RVB dhe vizites në IAL, programi i BA IE&B është hartuar duke shfrytëzuar përvojat më të mira bashkëkohore të vendeve të huaja dhe universiteteve me programe të ngjashme në Shqipëri si ai i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë apo Universiteti Bujqësor i Tiranës, etj, duke e përshtatur atë me kërkesat aktuale dhe prespektivat e tregut të punës [Ev. 3_7 Studimi i tregut të punës për programin e studimit].

GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në fushën e IT (në nivel programuesi junior ose si specialist IT), por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore në lëndë të veçanta (sidomos ato me profil IT) aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore, nga të cilat do të përfitojë studenti. Nevojitet të theksohet më shumë mendimi kritik nëpërmjet kërkimit shkencor dhe ngritjes së hipotezave, matjeve, eksperimenteve, mbledhjes së të dhënave, analizës dhe parashtrimit të rezultateve. Kjo është pjesa që mungon në programin e studimit BA IE&B, pjesë që në fakt është e rëndësishme në programe të ngjashme ndërkombëtare.

Gjatë takimit me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit të programit të studimit, u theksua se syllabuset përditësohen çdo vit me rreth 20 % të përmbajtjes së tyre si dhe literatura e lejuar për përdorim të jetë jo më pak se 2017-2019. Ky fakt është për tu vlerësuar, ndërkohë këto ndryshime duhet të reflektohen me përgjegjësi nga stafi akademik në syllabuset e lëndëve.

Raporti Teori /Praktikë, i përlogaritur si raporti: (orë totale leksioni) / (orë Seminari + Lab + Ushtrime + Praktike), në programin BA IE&B nëse përlogaritet në bazë të dokumentit "Plani Mësimor" [Ev. 3_9 Plani mësimor] do të figurojë që:

Semestri	Leksion Orë/ECTS	Seminar Orë/Ects	Ushtrime Orë/ECTS	Laborator Orë/ECTS	ETC total
I	165	120		15	28
II	195	150		15	32
III	165	105		75	32
IV	150	90		45	28
V	165	105		75	32
VI	75	30		30	28
TOTAL	915	600		255	180

Total: 180 ECTS
Praktika: 8 ECTS
Diploma: 7 ECTS
Lëndët: 165 ECTS

	<p>Orët: Leksion 915 orë; Seminare 600 orë; Laborator 255 orë Total orë: 1770 orë Sipas përlogaritjeve, raporti Teori/Praktikë qëndron si 915 / (600 + 255), pra është në nivelet 51.69 % teori / me 48.31 % praktikë. Ky është një raport, mjaft i mirë për ciklin Bachelor.</p>																								
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Duke pasur parasysh veprimtaritë formuese të përcaktuara në VKM 41, viti 2018, të dhënat për programin e studimit BA IE&B janë si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="480 674 1369 1671"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Tipi i komponentit mësimor</th> <th>Cikli i parë / Bachelor (sipas VKM 41, viti 2018)</th> <th>Cikli i parë Bachelor (BA IE&B, KUQ)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</td> <td>15% - 20% (kredite)</td> <td>18.8% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore</td> <td>50% - 55% (kredite)</td> <td>53.9% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje</td> <td>12% -15% (kredite)</td> <td>12.8% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale</td> <td>10-15% (kredite)</td> <td>10.6% (kredite)</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>3%-5% (kredite)</td> <td>3.9% (kredite)</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ vë re se dokumentacioni i programit të studimit konsiderohet në përputhje me komponentët mësimorë që përbëjnë aftësitë formuese. Programi i studimit ka shumë lëndë që i përkasin programit të studimit Informatikë Ekonomike dhe Biznesi në tërësinë e tyre, ku ruhen raportet midis formimit teorik dhe praktik.</p> <p>[Ev. 3_9_2 Kredite sipas veprimtarive formuese të programit të studimit BA në IEB] [RVB].</p>	Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Cikli i parë / Bachelor (sipas VKM 41, viti 2018)	Cikli i parë Bachelor (BA IE&B, KUQ)	A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15% - 20% (kredite)	18.8% (kredite)	B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	50% - 55% (kredite)	53.9% (kredite)	C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12% -15% (kredite)	12.8% (kredite)	D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10-15% (kredite)	10.6% (kredite)	E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%-5% (kredite)	3.9% (kredite)
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor	Cikli i parë / Bachelor (sipas VKM 41, viti 2018)	Cikli i parë Bachelor (BA IE&B, KUQ)																						
A	LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme	15% - 20% (kredite)	18.8% (kredite)																						
B	LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	50% - 55% (kredite)	53.9% (kredite)																						
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	12% -15% (kredite)	12.8% (kredite)																						
D	LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10-15% (kredite)	10.6% (kredite)																						
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3%-5% (kredite)	3.9% (kredite)																						

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Sipas RVB, Vizitës në IAL dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, Departamenti i Menaxhim Biznesit tenton të reflektojë në syllabuset e lëndëve literaturën e viteve të fundit për të reflektuar aritjet shkencore në fushën e shkencave informatike, ekonomike, menaxheriale dhe aplikimeve kompjuterike në biznes. Këto ndryshime bëhen në fillim të secilit semestër. Pavarësisht titujve të vendosur në syllabus-et e lëndëve përkatëse, të cilët mund të jenë tekste mjaft të mira në vetvete, GVJ konstaton që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga 29 lëndë gjithsej të ofruara në këtë program studimi (duke përfshirë edhe të gjitha lëndët me zgjedhje), ofrohen syllabuset e vetëm 7 prej tyre. [Ev_3_9_ Plani mësimor], [Ev_3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III] • Mungojnë syllabuset e 22 lëndëve • Lënda ASP.NET dhe C#: literatura e detyrueshme është Cikël Leksionesh, 2023. Ndërsa literatura e rekomanduar nuk ka vite botimi. • Lënda e Drejtë Biznesi: Nga dy literatura të detyrueshme, një daton në vitin 2013 tjetra nuk përmban datë. Ndërsa literatura e rekomanduar daton në vitin 2007 ose pa datë. • Lënda Financa Publike: literatura e detyrueshme nuk ka datë, ndërkohë literaturat e rekomanduara datojnë midis viteve 1999-2014. • Lënda Menaxhim i Burimeve Njerezore: literatura e detyrueshme është midis viteve 2009 dhe 2011. ndërsa literatura e rekomanduar varjon midis viteve 2011, 2015 ose pa datë. • Lënda Menaxhim Turizmi: Literatura e detyrueshme është e vitit 2006, ndërsa literatura e rekomanduar është e viteve 2004 dhe 2007. • Lënda Programim në Windows: Literatura e detyrueshme është cilësuar si leksione të shkruara pa datë apo referenca të tjera, ndërsa literatura e rekomanduar është e viteve 2006 – 2021. • Lënda Multimedia (Vizioni Kompjuterik): Literatura e detyrueshme cilësohet si Leksione të shkruara 2023 pa vendosur referenca të tjera. Ose libra të botuara për të cilat nuk është vendosur data e botimit. Ndërsa literaturë e rekomanduar është e viteve 2019, 2020. <p>Siç vihet re:</p> <p>1. Në këto bibliografi, në pjesën dërmuese të tyre, mungon vendosja e vitit të botimit (i detyrueshëm në cdo standard). Për pasojë, nuk mund të themi kohën e botimit të tyre duke lexuar syllabusin.</p>
--	--

	<p>2. Literatura e cituar nën seksionet: a. Literatura bazë e detyrueshme, dhe b. Literatura e rekomanduar, nuk ndjek në mënyrë konsistente të njëjtin standard referimi (p.sh. APA style, apo të tjerë).</p> <p>3. Literatura ekziston por nuk ka aplikuar standartin e referimit të burimeve në leksionet përkatëse.</p> <p>4. Disa lëndë, në një pjesë të mirë të tematikave që zhvillon ka si literaturë bazë dhe të detyruar Leksione të shkruara pedagogu i lëndës pa dhënë më shumë informacione.</p> <p>Bazuar në sa më sipër GVJ rekomandon rishikimin e literaturave për lëndët e këtij programi mësimor duke përfshirë literaturë të 5 viteve të fundit, pasi mungesa e përditësimit të përmbajtjeve lëndore mund të sjellë dobësim të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional</p> <p>Në rastet e mos ribotimeve të librave të caktuar nga autorët rekomandohet përzgjedhja e një literature të një autori tjetër të huaj apo vendas, literaturë e cila përdoret edhe nga programe të tjera të ngjashme brenda apo jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Referuar dokumentacionit, programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit. Ky departament ofron programe studimi në fushën e menaxhimit të biznesit duke synuar arsim profesional dhe kualifikimin shkencor të studenteve. [Ev. 2_6_1 Rregullore e DMB], [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB]. Konkretisht në auditore, në bazë dhe të vizitës së GVJ në IAL në takimin me studentë, u vu re një nivel mesatar kompetencash.</p> <p>GVJ sugjeron që ky program të orientohet pak më tepër drejt zbatueshmërisë në biznes, që të justifikohet dhe emërtimi i programit të studimit. Në këtë mënyrë ky program do gjendej saktësisht brenda njësisë së tij dhe mbi të gjitha do të plotësonte një drejtim kombëtar mjaft të rëndësishëm, siç është ai i dixhitalizimit të proceseve të biznesit.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit BA IE&B është në konformitet me përcaktimet e bëra në Vizionin dhe Misionin e KUQ, si një program i rëndësishëm studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive [Ev. 1_1 Statuti KUQ]. Është një fushë studimi me profil Teknik dhe rezultojnë se të diplomuarit në këtë program studimesh janë të kërkuar në tregun e punës [Ev. 3_7 Studimi i tregut të punës për programin e studimit]. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, është në dobi dhe në mbështetje të nevojave dhe kërkesave për një lloj diversifikimi të mëtejshëm të diplomave që ofron FE dhe në dobi të studentëve që pranohen në këtë fakultet.</p> <p>Të diplomuarit në këtë program studimi mund t’i përgjigjen mjaft mirë nevojave të vendit. Ritheksojmë që këto prioritete janë të qarta për FE</p>




	<p>dhe DMB, por sikurse i sugjeruam dhe në kriterin e mësipërm, duhet të konkretizohen më fort në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p>Vetë studentët e degës, gjatë vizitës në IAL, u shprehën se ishin mjaft të kënaqur me profilin që kishin marrë, si IT të ardhshëm. Por vunë theksin tek rinovimi i laboratorëve pasi do i ndihmonte ata në procese të ndryshme të pjesës praktike të lëndëve. FE ka nënshkruar gjithashtu mjaft marrëveshje bashkëpunimi me bizneset, në të cilët studentët realizojnë praktikat mësimore, gjejnë mundësi punësimi, si dhe ka konsulta të ndërsjellta mes tyre dhe stafit akademik në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit [Ev.3_27_Lista e marrëveshjeve në funksion të programit]</p>			
Konkluzione	<p><i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit BA IE&B janë në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës. GVJ sugjeron rishikimin e mundësive për shtim të tematikave si Machine Learning, Inteligjencë Artificiale, Siguri Informacioni dhe shkrirjen e lëndëve të financës për të përmirësuar strukturën dhe përmbajtjen e programit. Lëndët dhe modulet mbulojnë pjesërisht fushat e studimeve të informatikës dhe biznesit, dhe kurrikula rishikohet çdo vit për t'iu përshtatur tregut të punës. Programi është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit, por kërkohet theks më i madh në aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore në lëndët me profil IT. Dokumentacioni i programit ruan raportet midis formimit teorik dhe praktik, por nevojitet një rishikim i plotë i syllabusit dhe literaturës për të përfshirë materiale më të reja. Programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, por kërkohet një orientim më i madh drejt zbatueshmërisë në biznes. Programi mundëson vijimin e studimeve dhe punësimin e studentëve, dhe bashkëpunimet me bizneset ndihmojnë në realizimin e praktikave mësimore dhe gjetjen e mundësive të punësimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit	Sipas RVB, vizitës pranë IAL, dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione dhe aktorë të tjerë në tregun e punës [Ev.3_27_Lista e

<p>të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>marrëveshjeve në funksion të programit], nga të cilat institucioni pranon dhe merr sugjerime, të cilat i shtojnë vlerë programit. Nga institucionet homologe merret përvoja e përparuar si dhe bashkëpunohet me formën e propozimeve për realizimin e programit.</p> <p>Vlen të theksohet se nuk ka një komunitet alumni të këtij programi pasi nuk janë diplomuar ende studentët e parë.</p> <p>GVJ sugjeron që kriteri (siç është i shprehur në këtë raport) të konsiderohet i plotësuar, duhet që këto konsulta e propozime (që më pas kthehen në vendime në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit) të jenë dhe të dokumentuara.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, në RVB dhe në vizitën pranë IAL, GVJ konstaton se institucioni ka në vëmendje jo vetëm përshtatjen e programeve të studimit me tregun e punës por edhe me pritshmëritë dhe kënvështrimet e stafit akademik dhe studenteve. Institucioni kryen mbledhje të ndryshme me studentët me qëllim mbledhjen e eksperiencave dhe mendimeve të drejpërdrejta në lidhje me shërbimet ndaj studentëve, procesin e mësimdhënies, sugjerimet për përmirësim të mëtejshëm të institucionit, lëndëve, programeve akademike, etj, ku gjatë tyre mbahen edhe evidenca. [Ev. 3_22_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë][vizita IAL][RVB].</p> <p>Në KUQ, është funksionale Zyra e Mardhënieve me Jashtë e Pranimeve dhe Këshillimit të Krarierës, e cila mban kontakte të vazhdueshme me studentët. Kjo zyrë ndihmon në ruajtjen e mardhënieve midis institucionit dhe studentëve. [Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK].</p> <p>Gjatë takimit me studentët në ambientet e IAL, të pyetur nëse meren parasysh sugjerimet e tyre nga ana e institucionit ata u shprehën pozitivisht.</p> <p>GVB gjithashtu shprehet se Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit, realizon takime të ndryshme në formën e diskutimeve me studentët e diplomuar për të marrë këndvështrimin e tyre si pjesë e tregut të punës dhe për ti reflektuar sugjerimet e tyre në program. Ndërkohë vlen të përmendet që nuk janë diplomuar ende studentët e parë në programin e studimit BA IE&B.</p> <p>Për sa u tha më sipër GVJ nuk ka në dispozicion një dokument që e vërteton reflektimin e tyre në programin mësimor (procesverbal, memo, apo shkresë tjetër).</p> <p>GVJ rekomandon që IAL të angazhohet seriozisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve alumni që funksionojnë pranë KUQ, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë ata në strukturat</p>

	konsultuese e drejtuese të universitetit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete/projekte zhvilluese të UMSH. Një politikë e tillë duhet ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga KUQ.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar RVB: “Departamenti i Menaxhim Biznesit, përshtat, përmirëson dhe përditëson programin e studimit, sipas sugjerimeve dhe zhvillimeve të fundit të propozuara nga rrjeti i bashkëpunëtorëve...këtij qëllimi i kanë ardhur në ndihmë edhe workshop-et me grupe interesi” Sipas prioriteteve të caktuara për vendin tonë, duke qenë se profilet me drejtim IT janë gjithmonë të kërkuara e për të cilat ka mjaft nevojë tregu, edhe programi i BA IE&B është pikërisht rezultat i nevojës për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës për kualifikimin e nëpunësve të angazhuar në procese pune të lidhura me informatikën. [Ev_3_7_Studimi i tregut të punës për programin e studimit].			
Konkluzione	<i>KUQ nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit për të përmbushur objektivat dhe kërkesat e tregut të punës. GVJ vlerëson se njësiti përgjegjëse marrin në konsideratë sugjerimet nga institucionet partnere dhe aktorët e tregut të punës, nga studentët, por rekomandon dokumentimin e këtyre konsultave e propozimeve. Institucioni mbledh mendime nga studentët dhe stafi akademik për përmirësimin e programit dhe realizon takime me studentët e diplomuar te KUQ, megjithëse nuk ka ende të diplomuar në programin e studimit BA IE&B. Rekomandohet fuqizimi i rrjeteve ALUMNI dhe përfshirja e tyre në strukturat konsultuese dhe drejtuese të universitetit. Programi përmirësohet dhe përditësohet bazuar në sugjerimet e rrjeteve të profesionistëve dhe shoqatave, duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës për profilet e IT.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të ndryshëm të vënë në dispozicion të GVJ, si dhe nga vizita gjatë institucionit, u konstatua që procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, me laboratore, me detyra kursi, praktikat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar [Ev. 3_9_ Plani mësimor], [Ev. 3_14_Syllabusët e lëndëve të programit të studimit BA në IEB III].</p> <p>GVJ konstaton që format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë sipas kategorive të ndryshme, sic kërkohen në këtë kriter. Detyrat e kursit apo projektet janë të specifikuar në çdo syllabus, në rastet kur ato janë të planifikuara nga lektori, por në përgjithësi kanë një peshë mjaft të ulët nga gjithë vlerësimi 100% i lëndës, referuar [Ev. 3_14] nga 7 syllabuse të dorëzuara, në 6 prej tyre detyra e kursit është e vlerësuar me 10%, ndërsa në 1 vlerësohet me 15%. Sipas syllabus-eve të lëndëve u vu re që përveç provimit përfundimtar, kontrolli i dijeve bëhet i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Institucioni ka zhvilluar dhe leksione të hapura me institucione dhe biznese me të cilat KUQ ka marrëveshje bashkëpunimi [Ev. 3_27_Lista e marrëveshjeve në funksion të programit].</p> <p>Në kurrikulën e studimeve të programit BA IE&B i është dhënë hapësirë e gjerë si në kredite edhe në kohë praktikës profesionale, me përkatesisht 8 ECTS dhe 200 orë gjithsej nga të cilat 50 janë orë në auditor dhe 150 janë orë punë e pavarur. [Ev. 3_9_1_Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit].</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Sipas RVB, por edhe në bazë të dokumentacionit të konsultuar, GVJ evidenton që personeli akademik ka respektuar diversitetin e studentëve dhe nevojat e tyre. Metodatat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programet e ciklit të parë Bachelor janë të shumëllojshme.</p> <p>Sipas vizitës në IAL, gjatë takimit me stafin akademik dhe grupin GVB u vu theksi tek numri i vogël i studentëve, 26 studentë në total [Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC], Tabela 4, [Ev. 2_26_Numri i studentëve të diplomuar, notat në hyrje & dalje]. Sipas Pedagogëve, numri i vogël i studentëve në auditore</p>

	<p>bën të mundur që kontrolli i dijeve dhe përshtatja me gjithsecilin prej tyre të jëtë më cilësore. Po sipas vizitës në IAL, në takimin me studentët, duke qenë se shfaqin heterogjenitet në formimin e tyre Bachelor, ata mendojnë që shtimi i pjesëve praktike në lëndët e profilit do ishte edhe më në dobi të avancimit të tyre praktik dhe për pasojë rritjes së mundësisë së punësimit të tyre në një profil të fushës së IT.</p> <p>Gjithashtu nga RVB, GVJ konstaton që departamenti dhe stafi akademik janë zhvendosur nga forma tradicionale e mësimdhënies në atë bashkëkohore të ndërveprimit. Ata theksojnë që disa nga format e mësimdhënies janë shfrytëzimi i platformave e-learning si dhe dizenjimi dhe ofrimi i programeve/softuere-ve të vecantë të aplikacioneve kompjuterike.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Sipas RVB, dhe dokumentacionit të venë në dispozicion, sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion lidhet ndër të tjera dhe me trajnimin dhe kualifikimin e pedagogëve. Institucioni organizon trajnimin e pedagogëve sipas nevojave dhe nivelit të kualifikimit të secilit [Ev. 3_25 Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja].</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, apo edhe të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave ndihmese të të nxënit [Ev. 1_24 Infrastruktura mësimore KUQ]. Sallat e leksioneve apo seminareve ishin pjesërisht të pajisura me projektor. Laboratorët e kompjuterave nuk janë të pajisur me teknologjinë bashkëkohore. Pajisjet janë të vjetra, dhe gjatë takimit me studentët në ambientet e IAL, u përmënd fakti që ata zhvillojnë projekte për lëndët të ndryshme por i marrin dhe i zhvillojnë në shtëpi, dhe se shpesh herë kompjuterat vonojnë të ndizen dhe të ekzekutojnë në kohë detyrat. Kjo tregon që mjetet e ndryshme teknologjike që stafi akademik shfrytëzon për procesin mësimor, janë jo të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p> <p>Institucioni në mënyre periodike bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të angazhuar me kohë të plotë dhe të ftuar, i cili vlerësohet nëpërmjet pyetësorëve studentore të shpërndarë në fund të çdo semestri nga zyra e NJSBC [Ev. 1_17 Udhëzues për kualifikimin e stafit], pika 12. Ndërkohë institucioni KUQ operon nëpërmjet paketës së “Instrumentave për Matjen e Cilësisë” ku janë rreth 11 pyetësorë dhe formularë të ndryshëm që plotësohen nga studentët dhe stafi [Ev. 1_5_1 Politikat e Njsbc], por GVJ nuk i disponon këto dokumenta. Raporti përfundimtar i performancës ndihmon stafin të përmirësojë</p>




	<p>aspekte të caktuara, si dhe vlen si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Pas shqyrtimit të CV të dorëzuara nga IAL për anëtarët e stafit që japin mësim në programin BA IE&B, GVJ arrin në përfundimin që ky personel akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, si pasojë e edukimit të tyre, përvetësimit të titujve dhe gradave apo edhe nga eksperiencia e tyre profesionale në kompani, projekte apo fusha të tjera. [Ev. 3_12_CV-të e stafit akademik që japin mësim, në programin e studimit.pdf], [Ev. 3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit.pdf]</p> <p>Sigurisht që personeli akademik i brëndshëm dhe i jashtëm që angazhohet në mësimdhënie është i diplomuar në fushën përkatëse dhe ka kryer studime të mëtejshme në atë fushë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që një pjesë e mirë e pedagogëve prezentë në takim përdorin metoda interaktive dhe diskutimi me studentët në varësi të tematikës.</p> <p>KUQ për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, qofshin efektiv apo me kontratë të pjesshme, plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore, me të cilën GVJ u njoh dhe gjatë vizitës në IAL. Është departamenti ai që formulon kërkesën për ekspertizën e personave në profesion të specifikuar dhe bën një planifikim paraprak të moduleve që këta pedagogë të rinj do të mbulojnë duke zhvilluar leksionet dhe seminarët.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Sipas strukturës organizative të KUQ, ngritja e zyrave të ndryshme në veçanti NjSBC, apo bërja pjesë e kompetencave të përgjegjësve të departamenteve, dekanëve, apo stafeve të tjera menaxhuese të institucionit [Ev. 1_1_Statuti KUQ], të vlerësimit të performancës së lektorëve nga studentët, bën që GVJ të konstatojë që IAL e vlerëson dhe përpiqet të përmirësojë mësimdhënien në përgjithësi në mënyrë periodike. Gjatë proceseve të ndryshme të vlerësimit apo kontrolleve krijohen raporte dhe mbahen evidenca [Ev. 3_31_Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë]. Gjithashtu, sic u theksua edhe në kriteret më sipër, institucioni KUQ operon në bazë të një pakete për matjen e cilësisë ku përfshihen një sërë formularësh dhe pyetësorësh. Të cilat janë periodike, kompetencë e zyrës NjSBC [Ev. 1_5_1 Politikat e NjSBC], por GVJ nuk disponon këto materiale.</p> <p>Bazuar edhe në informacionin e grumbulluar gjatë vizitës, këto vlerësime mund të jenë vendimtare për vazhdimësinë e punës në KUQ. Studentët kanë një rol aktiv në dhënien e sugjerimeve, duke u përfshirë në strukturat organizative sipas ligjit aktual</p>

	<p>[Ev. 3_22 Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë]. NjsBC dhe njësia bazë mbledhin pikëpamjet dhe sugjerimet lidhur me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për programin BA IE&B, duke përdorur metoda si plotësimi i formularëve dhe konsultimet me studentët. Pas analizës së rezultateve të mbledhura, hartohen raporte [Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC] dhe bazuar në to institucioni mer masa për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në të ardhmen.</p> <p>GVB i referohet dokumentit [Ev.3_18_Pyetesoret e Studenteve], por ky dokument nuk gjendet në listën e dokumentave të dorëzuara nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në IAL KUQ, vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit [Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë], Neni 2. Ndër detyrat e kësaj strukture është të vlerësojë periodikisht, sipas një plani kalendarik të përvitshëm [RVB]veprimtaritë e mësimdhënies, kërkimit shkencor si dhe të çdo shërbimi në KUQ [Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC], Neni 3. Përveç kësaj strukture të dedikuar, janë dhe strukturat drejtuese dhe autoritetet të institucionit të cilat janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë [Ev. 1_1_Statuti KUQ].</p> <p>GVJ konstatoi nga vizita në IAL që Fakulteti i Ekonomisë dhe Departamenti i Menaxhim Biznesit, pavarësisht synimit që kanë për të mbështetur zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, është në disavantazh për shkak të mungesës të teknologjisë inovative të implementuar në këtë institucion.</p> <p>Bazuar në dokumentacion, personeli akademik i KUQ mund të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar trajnime dhe kualifikime të herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të KUQ. [Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit], [https://qiriaz.edu.al/wp-content/uploads/2023/05/Bashkepunime.pdf]</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që një pjesë e mirë e pedagogëve prezentë në takim përdorin metoda interaktive dhe diskutimi me studentët. Nga vëzhgimi i syllabus-ëve të detajuar (për lëndët e dorëzuara), GVJ konstaton mungesën e vendosjes në syllabus të këtyre metodave si: diskutimi i rasteve, punën në grup, etj. GVJ sugjeron përmirësim të mëtejshëm të aspekteve teknike.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional me metoda dhe praktika të përqendruara te studenti, duke përfshirë leksione, seminare, punë laboratorike, detyra kursi, projekte dhe</i></p>

	<p><i>praktika profesionale. Megjithatë, detyrat e kursit kanë një peshë të ulët në vlerësimin përfundimtar. Institucioni respekton diversitetin dhe nevojat e studentëve duke ofruar forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përfshirë përdorimin e platformave e-learning dhe aplikacioneve kompjuterike. Personeli akademik mbështetet për përmirësimin e kompetencave didaktike përmes trajnimeve dhe vlerësimeve periodike, dokumentat e të cilave duhet të vihen në dispozicion te GVJ. Infrastruktura teknologjike është e pamjaftueshme dhe pajisjet janë të vjetra. KUQ promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes vlerësimit të performancës dhe përfshirjes së studentëve në procesin e reflektimit të mendimeve të tyre. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave të reja dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, në lidhje kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, IAL ka të përcaktuara në dokumentin [Ev. <u>2_6_1_Rregullore</u> e DMB]:</p> <ul style="list-style-type: none"> Neni 26, ku thuhet shprehimisht që pjesmarrja e studentëve në mësim gjatë leksioneve është fakultativ, por i rekomanduar, së paku 50%. Ndërsa pjesmarrja e studentëve në seminare dhe ushtrime është i detyrueshëm në masën 75%. Neni 27, ku thuhet që format bazë të kontrollit të dijeve janë provimi dhe kolokiumi. Mënyrat e kontrollit të dijeve (provim/kolokium) përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit. Gjithashtu studentit i lind e drejta të futet në provim, kur shlyerja e detyrimeve semestrale konfirmohet nga pedagogu në javën e fundit të përfundimit të procesit mësimor. Neni 29, ku thuhet se Provimi mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. DMB përcakton nëse

pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.

- Neni 32, pika 1, ku thuhet se shkalla e përvetësimit është sistemi me dhjetë nota dhe se nota më e ulët kaluese është 5.
- Neni 32, pika 2, ku thuhet se në të gjitha format e provimit përdoret edhe sistemi i vlerësimit me pikë ku vlera përkatëse konvertohet në notë si më poshtë:

NR	Intervalet e pikeve	Nota
1	0-44	4
2	45-54	5
3	55-64	6
4	65-74	7
5	75-84	8
6	85-94	9
7	95-100	10

Bazuar në dokumentin [Ev. _3_5_3 Rregullore IEB.pdf], GVJ vë re se:

- Neni 12 shpjegon frekuentimin e programit të studimit. GVJ këshillon që tek ky nen të zëvendësohet termi i programit “Administrim Biznes” me “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”.
- Neni 13, Neni 14, Neni 15, mbështesin apo detajojnë më tej kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dhe dijeve të përmendura edhe në rregulloren e DMB. Neni 13, pika 1. B) thotë që: nota përfundimtare është shumatore e elementëve, përgjithësisht në raporte

Vlerësimi i Vazhduar (1-100)			
1 -10 pikë	1-30 pikë		1-60 pikë
Pjesëmarrja/ Aktivizimi	Detyrë Kursi	Provimi ndërmjetëm	Provimi përfundimtar

Duke ju referuar programeve të lëndëve [Ev. _3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III], lëndët për të cilat është dorëzuar syllabus vihet re se e respektojnë ndarjen 40% detyrimet simestrale dhe 60% provimi final. Ndërkohë

	<p>lëndët ASP.Net dhe Multimedia detyrimet simestrale i kategorizojnë në:</p> <p>Pjesëmarrja/Aktivizimi 5%</p> <p>Provimi i ndërmjetëm 20%</p> <p>Detyra e kursit 15%</p> <p>Provimit përfundimtar 60%.</p> <p>Lënda Programim në Windows përdor ndarjen</p> <p>Pjesëmarrja/Aktivizimi 10%</p> <p>Provimi i ndërmjetëm 15%</p> <p>Detyra e kursit 15%</p> <p>Provimit përfundimtar 60%.</p> <p>Ndërsa lëndët e tjera përdorin ndarjen:</p> <p>Pjesëmarrja/Aktivizimi 10%</p> <p>Provimi i ndërmjetëm 20%</p> <p>Detyra e kursit 10%</p> <p>Provimit përfundimtar 60%.</p> <p>Referuar RVB, format dhe kriteret e vlerësimit të studentit i bëhen të ditura paraprakisht studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas RVB, vizitës në KUQ, dhe dokumentave në dispozicion të cituara dhe në kriterin e mësipërm, studentët njihen me silabusin e lëndës në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës, në fillim të çdo semestri. Gjatë takimit me studentët në ambientet e IAL, ata shprehën që ndarja e pikëve ju bëhet e qartë që në fillim.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ vlerëson që të gjitha format e vlerësimit të njohurive të përmendura në kriterin 1, i japin mundësi studentit që të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara [Ev. 3_14 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III]. Gjatë gjithë vitit ata janë në një proces të pandërprerë të të mësuarit dhe vlerësimit nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, rasteve të studimit etj.</p> <p>GVJ sugjeron që këto masa vlerësimi të mos jenë të njëjta për të tre vitet akademike. Gjatë vitit të parë të studimeve pesha e provimit përfundimtar mund të mbetet në masën 70-80%, ndërsa në vit të dytë dhe të tretë, ku detyrat dhe projektet janë më komplekse, pesha e tyre të jetë rreth 50-60%, dhe në detyrimet simestrale të shtohen forma të tjera të kontrollit të dijeve si: projekte në grup, raporte, prezantime, etj.</p>





	<p>Së dyti, sugjerohet që detyrat e kursit në ndonjë prej lëndëve të jenë në formën e “short paper”, në mënyrë që studentët të trajnohen me mënyrën e të bërit kërkim shkencor.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Referuar RVB, dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe vizitës në IAL theksohet se njësia bazë dhe studentët kryejnë vlerësimin e kompetencave të stafit akademik për procesin e mësimdhënies/nxënies nëpërmjet pyetësorëve në mënyrë periodike. [Ev. 1_5_1 Politikat e NjsBC], [Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC]. Dokumenti [Ev. 3-18 Pyetësor e studenteve] tek i cili mbështetet RVB për këtë pikë, mungon në listën e dokumentave të dorëzua. Këta pyetësorë më pas përpunohen dhe rezultati i tyre i dërgohet Rektorit i cili ua bën të ditura njësive kryesore dhe bazë [Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë], Neni 2, pika h]. Bazuar në RVB Drejtuesi i departamentit në mënyrë kofidenciale i komunikon rezultatin pedagogut, i cili bazuar në nevojat, mendimet dhe sugjerimet e studentëve, vlerëson dhe përmirëson metodat e mësimdhënies. IAL duhet të tregojë kujdes me dokumentacionin, dhe mënyrën si i referohet njësive të caktuara nëpër dokumenta psh Njesisë NjsBC në [Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë], neni 9 dhe neni 11 i referohet me NJSBZHK.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në takimet me përgjegjësin e departamentit, stafin akademik dhe studentët, GVJ vuri re se stafi akademik zbaton metoda fleksibile dhe në përmirësim të vazhdueshëm duke ndërthurur formën klasike të mësimdhënies në auditor me platformat e-learning.</p> <p>U vu re një frymë e mirë bashkëpunimi midis pedagogëve dhe studentëve. Të dyja palët shprehën pozitivitet dhe theksuan që numri i vogël i studentëve në auditor i ndihmon të dyja palët në procesin mësimdhënie-mësimnxënie, pasi stafi akademik ka mundësi të adresojë stile të ndryshme të të mësuarit për secilin prej tyre.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në analizën e Standardit III.2, është evidentuar se institucioni ka hartuar dhe bërë publike rregulloret dhe procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe</p>

	<p><i>aftësive profesionale në përputhje me kërkesat e dokumentacionit akademik të caktuar. Rregulloret përfshijnë informacion mbi kriteret dhe mënyrat e vlerësimit, përqindjen e pjesëmarrjes së nevojshme në leksione dhe seminare, si dhe format e provimeve. Përkundër këtyre masave, sugjerohet që informacioni rreth proceseve të vlerësimit të bëhet më i qartë dhe më i arritshëm për të gjithë studentët. Gjithashtu rekomandohet një përditësim i rregulloreve për të reflektuar ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në mënyrën se si vlerësohen njohuritë dhe aftësitë e studentëve, duke siguruar që të gjitha format e vlerësimit janë të drejta dhe objektive.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas të dhënave të reflektuara në syllabus-et e lëndëve, e në bazë të Rregullores të Programit të studimit [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf], Neni 13, pika 1. B), vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit është shumë e elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja / Aktivizimi • Detyrë kursi • Provim i ndërmjetëm • Provimit përfundimtar. <p>Bazuar në takimet e bëra me stafin akademik dhe studentët, provimi i ndërmjetëm zhvillohet në mes të semestrit (java e 7-të ose e 8-të). Kjo është e reflektuar edhe një pjesë të syllabuseve të dorëzuara [Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III], seminarët janë të përjavshme, kurse detyrat e tjera janë të shpërndara sipas planit të secilit pedagog të lëndës. Kjo, për GVJ, vërteton shpërndarjen e vlerësimit përgjatë gjithë semestrit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në RVB, Vizitës në IAL dhe ne dokumentacionin e dorëzuar, GVJ vë re se institucioni inkurajon stafin akademik dhe studentët të përdorin platformën Google Classroom si sistem elektronik për kontrollin e dijeve të formës Quiz, Assignments apo forma të tjera të vlerësimit të njohurive duke ofruar trajnime dhe udhëzues të posaçëm [Ev. 1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave on-line].</p>

	<p>Ndërkohë gjate takimit me drejtues të IAL dhe stafin akademik u pohua se nuk ka sisteme elektronike specifike për testimet e ndërmejtme ose provimet përfundimtare të lëndëve. Nga njëra anë, kjo mund të jetë e kuptueshme për lëndët me karakter teknik, sic janë pjesa më e madhe e lëndëve të programit të studimit.</p> <p>Referuar takimeve me stafin akademik [RVB, kriteri 3], GVJ konstaton së për të rritur transparencën gjatë procesit të provimit dhe meritokracinë gjatë procesit të vlerësimit të tezës, sekretaria sekreton provimet. Pedagogët i korrigjojnë ato të sekretuara dhe në përfundim të procesit të korrigjimit, sekretaria i ç'sekreton provimet dhe hedh pikët në listën e studentëve pjesëmarrës në provim. GVJ konstaton, se në rregulloret e skretarisë mësimore, rregulloren e DMB dhe rregulloren e programit të studimit nuk ka asnjë shpjegim për këtë pikë.</p> <p>GVJ rekomandon që kjo fazë e kryerjes së provimit të pasqyrohet në rregulloret përkatëse.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në IAL, theksohet se mënyra e vlerësimit është e paraqitur në syllabusin e secilës prej lëndëve të programit BA IE&B dhe se vlerësimi bëhet në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatore të Fakultetit të Ekonomisë.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas dokumentit [Ev. _3_5_3 Rregullore IEB], Neni 16, pika 2, vlerësimi në asnjë rast nuk kryhet nga një pedagog i vetëm por duhen gjithmonë 2(dy). Gjatë takimeve me stafin akademik, GVJ kostatoi se pavarësisht mënyrës se si zhvillohet provimi (me shkrim apo me gojë), pedagogu i lëndës e ka për detyrë që në tezën e miratuar të vendosë shënime, pikë dhe notë në çdo tezë, duke lënë gjurmë për vlerësimin e studentit. Në rast se provimi zhvillohet në formën e pyetjeve me përgjigje alternative, komisioni shpall çelësin e zgjidhjeve [Ev. _2_6_1_Rregullore e DMB], Neni 32, pika 4.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ndjek dhe një procedurë të mirërregulluar për rastet kur studenti ka ankesë për pikët e vlerësimit të lëndës. Në rastet kur pikët ndryshojnë si pasojë e seancave sqaruese apo ankimore, pedagogu duhet të japë sqarime për çdo ndryshim. [Ev. _2_6_1_Rregullore e DMB], Neni 32, pika 5].</p> <p>Bazuar në RVB, gjatë seancave sqaruese studentët marin informacione më të detajuara mbi problematikat e konstatuara në zgjidhjen e tezës së provimit.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë</p>	<p>Referuar dokumentit Kodi i Etikës të KUQ, Neni 5, pika f dhe Neni 7, pika c, GVJ konstaton që IAL ka të rregulluar rastet e evidentuara të kopjes, mashtrimit apo shmangies nga shlyerja e detyrimeve mësimore [Ev. _1_8_Rregullore e Këshillit të Etikës].</p>

<p>plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Gjithashtu GVJ evidenton se, referuar dokumentit [Ev. <u>2_6_1_Rregullore e DMB</u>], Neni 33, pika 2 C) studenti që kapet duke kopjuar në çfarëdo lloj provimi mësimor apo përfundimtar, përjashtohet nga provimi dhe vlerësohet me notën 4 (katër) ose sipas Nenit 67, pika 2 d), e po të njëjtës rregullore, ndaj studentit merren masat deri në përjashtim përgjithmonë nga Kolegji.</p> <p>GVJ konstaton se nuk është e saktësuar në dokumenta se çfarë ndodh nëse studentit i rezulton e kopjuar detyra e kursit ose diploma, pas verifikimeve të pedagogëve. Gjithashtu mungon shpjegimi nga ana e IAL se si mundet që pedagogët udhëheqës të zbulojnë plagjiaturën dhe çfarë mjetesh ata përdorin.</p> <p>Një rikujtesë mbi plagjiaturën dhe kopjimin bëhet edhe në silabuset e çdo lëndë të programit Informatike Ekonomike dhe Biznes ku shpjegohet se shkelja penalizohet sipas përcaktimit në Kodin e Etikës së KUQ.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Ashtu siç u përmend edhe në kriterin 2, provimet sekretohen për të rritur transparencën dhe meritokracinë. Pedagogët i korrigjojnë ato të sekretuara dhe në përfundim të procesit të korrigjimit, sekretaria i ç'sekreton provimet dhe hedh pikët në listën e studentëve pjesëmarrës në provim. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik u konfirmua shpërndarja e njoftimeve në kohë, kjo theksohet edhe në dokumentin [Ev. <u>2_6_1_Rregullore e DMB</u>], Neni 32, pika 5 a.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në dokumentin [Ev. <u>2_6_1_Rregullore e DMB</u>], Neni 28, pika 1. theksohet se studentët mund të hyjnë në provim vetëm pasi konfirmohet nga pedagogu shlyerja e detyrimeve semestrale. Ky proces forcon pjesëmarrjen dhe meritokracinë e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin e tyre, gabimet, apo çdo paqartësi tjetër nga pedagogu i lëndës. [Ev. <u>2_6_1_Rregullore e DMB</u>], Neni 32, pika 4, pika 5 b, Neni 34.</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në programin e studimit, studenti i cili mendon se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, ka të drejtë të ankohet për vlerësimin në notë, dhe ankimimi bëhet me shkrim brenda tri ditëve nga data e dhënies së provimit. Ankimimi shqyrtohet nga një komision me kryetar përgjegjës e departamentit. Dhe nëse e sheh të arsyeshme ky komision e rimerr në provim studentin ankues jo më shumë se 5 (pesë) ditë nga dita e provimit të kontestuar. [Ev. <u>3_5_3 Rregullore IEB</u>], Neni 18. Gjithashtu referuar [Ev. <u>2_6_1_Rregullore e DMB</u>], Neni 32,</p>

	pika 5 b, Neni 34 , konfirmohet edhe njëherë procedura për procesin e ankimimit dhe rishikimit të provimeve.			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent duke përfshirë një proces të ankimimit, me rregullore dhe procedura të posaçme për testimin dhe vlerësimin e njohurive gjatë gjithë vitit akademik, të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Vlerësimi përbëhet nga elemente të ndryshme si pjesëmarrja, detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare, të cilat janë të shpërndara gjatë semestrit. Institucioni inkurajon edhe përdorimin e platformës Google Classroom për kontrollet e dijes, por nuk ka sisteme elektronike specifike për testimet përfundimtare. Transparenca rritet duke sekretuar provimet gjatë korrigjimit. Vlerësimi përfundimtar është në përputhje me syllabuset dhe bazën ligjore në fuqi, dhe përfshin komente dhe feedback për studentët. Institucioni ka politika të rregulluara për të shmangur plagjiaturën dhe kopjimin, duke përjashtuar studentët që kapen duke kopjuar. Rezultatet bazohen në meritë dhe jepen në kohë, dhe studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin dhe të kërkojnë rishikim. Çdo ankimim shqyrtohet nga një komision i posaçëm, dhe procedura është transparente dhe e dokumentuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit BA IE&B, sipas dokumentit [Ev. _3_5_3 Rregullore IEB] Kreu I, Neni 4, synon të përgatisë studentët të jenë të aftë të pozicionohen në karrierën profesionale në fushën e informatikës ekonomike dhe biznesit në sektorin privat dhe publik.</p> <p>GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, por GVJ sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhurnimin e literaturave, si dhe shtimin/ modifikimin e lëndëve të caktuara, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.</p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Referuar programit mësimor [Ev. 3_9_Plani mësimor] nga 27 lëndë që zhvillohen gjithsej në tre vitet e studimit 13 prej tyre janë me profil në fushën e IT. Kjo tregon që 48.15% të lëndëve të kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit. Përveç këtyre kemi dhe lëndë plotësuese si Gjuha e Huaj Anglisht 1 dhe Anglisht 2, literaturat plotësuese të lëndëve janë pjesa më e madhe në anglisht (nga vetë natyra e programit të studimit në fushën e informatikës), por nuk ka lëndë që jepet në gjuhë të huaj.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, theksohet se rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në këtë program studimi të Ciklit të Parë vlerësohet çdo vit, në përfundim të tij, sipas modaliteteve të përcaktuara nga njësia NjSBC (modalitete të cilat janë përmendur edhe më sipër në raport). Ky vlerësim shërbën si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit në vitin e ardhshëm [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB], Neni 23.</p> <p>Referuar takimit me studentët dhe stafin akademik gjatë vizitës në IAL si dhe dokumentit mbi syllabuset e lëndëve, GVJ vë re se: në përfundim të çdo lënde pedagogu i modulit bën një përmbledhje të çështjeve më të rëndësishme duke i orientuar në lidhje me provimin përfundimtar, zbatimin e tyre në praktikë si dhe sjell raste studimi nga eksperiencia e tij të viteve të kaluara. Një pjesë e mirë e syllabuseve kanë të parashikuar orët mbi përsëritje dhe udhëzime mbi testin, [Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III], të cilat janë seanca speciale për përsëritjen e lëndës, pra evidentimin e temave më të rëndësishme me sqarimet e nevojshme. Departamenti garanton realizimin e këtij procesi nëpërmjet anketave të vazhdueshme me studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të</p>	<p>Bazuar në RVB, vizitën në IAL dhe dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton që në programin e studimit BA IE&B, përveç leksioneve janë dhe seminarët të cilat aplikojnë çdo njohuri të marrë në leksione duke i zbatuar ato me përdorimin e softuerëve që ndodhen të instaluar në laboratorët e programit të studimit. Gjithashtu, për t'i dhënë mundësi studentëve që të zhvillojnë më shumë njohuritë e tyre në praktikë kurikula e programit të studimit është në ndryshim, duke e përmirësuar ndjeshëm cilësinë e saj.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, në takimin me stafin GVJ konstatoi mirëkuptimin dhe dëshirën e stafit për të zhvilluar më tej programin e studimit. Në këtë takim morën pjesë pothuajse pjesa më e madhe e stafit akademik. Në programet lëndëve të</p>

<p>përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>dorëzuara, GVJ konstaton që në lëndët e tyre studentët zhvillojnë detyra kursi te cilat përfshihen dhe në vlerësimin e vazhduar të studentit. Kjo përveçse i ndihmon studentët për të rritur frymën e bashkëpunimit në grup dhe për të marrë njohuri më të thella lidhur me lëndë të caktuara, i ndihmon ata edhe për një vlerësim më të plotë të lëndës përkatëse. GVJ mendon që për të zhvilluar idetë inovative, për të kryer studime të avancuara kërkimore e shkencore detyrat e kursit nuk mund t'i plotësojnë mjaftueshëm këto aftësi. Rasti më i mirë do të ishte nëse këto aftësi plotësohen duke përfshirë stafin dhe studentët në projekte kërkimore (gjë e cila siç edhe është përmendur në kriteret më sipër është në mungesë).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në takimet që GVJ pati me stafin akademik të KUQ dhe studentët, mund të thuhet se përgjithësisht stafi akademik mundohet të integrojë të rejat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit të zhvillimit të modulit si dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Kjo shikohet në përpjekjet që bën stafi akademik i programit BA IE&B për të bashkëpunuar me studentët në realizimin e leksioneve të hapura, workshopeve, apo konferencave [Ev_3_24_Konferenca IPE me pjesëmarrje Staf Akademik dhe student..pdf]. Megjithatë numri i tyre i raportuar nga IAL për këtë program studimi nuk është i mjaftueshëm.</p> <p>GVJ mendon se IAL duhet të përpiqet të rritë frekuencën e eventeve akademike si: leksioneve të hapura, seminareve dhe workshopeve, duke përfshirë tema të ndryshme të reja dhe aktuale në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Si dhe të organizohen më shumë evente ku ftohen ekspertë të njohur nga fusha e shkencës dhe teknologjisë për të dhënë leksione të hapura dhe për të ndarë përvojat e tyre me studentët.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL ka struktura të posaçme që promovojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit, duke garantuar zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve. Programi i studimit BA IE&B ka një përqindje të konsiderueshme të lëndëve të profilit të teknologjisë së informacionit, dhe ai siguron zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e IT-së dhe fushave të tjera relevante. Megjithatë, GVJ sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, përditësimin e literaturës dhe shtimin e lëndëve specifike që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive kërkimore dhe praktike. Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie duke përdorur metoda të ndryshme interaktive dhe duke integruar të rejat më të fundit të</i></p>

	<i>shkencës dhe teknologjisë. Gjithashtu, GVJ rekomandon rritjen e frekuencës së eventeve akademike dhe përfshirjen e ekspertëve të njohur për të ndarë përvojat e tyre me studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	<p>Referuar RVB dhe takimeve në IAL me drejtuesin e departamentit, stafin akademik dhe studentet, u theksua se kufiri ndarës që përcakton nëse studenti mund të marrë punim diplome ose ti nënshtrohet provimit të përgjithshëm përfundimtar është nota 8. Ku u theksua se studentët me mesatare mbi 8 mund të marrin punim diplome.</p> <p>Ndërkohë bazuar në dokumentin [Ev. 3_23_2 Rregullorja e Diplomimit] përmbliidhen të gjitha nenet që sqarojnë të gjithë procesin e zhvillimit të diplomës ose nënshttrimin të provimit të përgjithshëm. Në RVB theksohet se procesi i realizimit të diplomimit bëhet në këndin e Njoftimeve. Nga kontrolli që i është bërë faqes zyrtare të KUQ, GVJ konstaton se dokumenti i lart përmendur apo dokumenta të tjera të ngjashme që shpjegojnë procesin e përcaktimit të të drejtës për të dorëzuar një punim diplome, nuk ka të publikuara. Në këtë pikë nuk është e qartë se në çfarë forme, ky informacion i vihet në dispozicion të studentit.</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Departamenti vë në dispozicion të studentëve formatin e Diplomës [Ev. 2_6_1 Rregullore e DMB], Aneks 2, jepet modeli i strukturës dhe kompozimit të tezës së diplomës, në të cilin janë të përcaktuara jo vetëm rregulla të formatimit të tekstit, por ka dhe instruksione për përmbajtjen, çështjet kryesore që duhet të mbajë tema, hipotezat, referencat etj.</p> <p>GVJ konstaton që kjo është një ndihmë e rëndësishme që u jepet studentëve, por theksojmë sërish që për procesin e shkrimit të një punimi shkencor/diplome ata duhet të jenë instruktuar në një lëndë të veçantë ose në përbërje të ndonjë lënde ekzistuese, siç kemi sugjeruar, Shkrim Akademik.</p> <p>Studentët me mesatare nën 8 zhvillojnë provim të përgjithshëm, të cilëve u vihet në dispozicion një listë me pyetje dhe ushtrime. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është</p>

	<p>gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. [Ev. 3_23_1_Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në bazë të RVB dhe dokumentin e pyetjeve orientuese për Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar, institucioni ka vendosur që për programin BA IE&B, duke qënë se fokusi i programit është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit, edhe provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë pikërisht këto aftësi të përfituara nga programi i studimit.</p> <p>Bazuar në dokumentin [Ev. 3_23_1_Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)]: GVJ, vë re se pyetjet janë nga fushat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programim dhe Algoritmikë • Proramim në Java • Bazë të Dhënash • Sisteme Informacioni dhe Arkitekturë Kompjuteri • Marketing • Statistikë • Menaxhim i Burimeve Njerezore • Menaxhim i SME <p>Në këtë dokument nuk përcaktohet se kush është pjesa e përgjithshme dhe kush është pjesa e profilit. Gjithashtu mungon dhe sasia në pikë për të dyja këto kategori.</p> <p>Referuar Planit Mësimor [Ev. 3_9_Plani mësimor], GVJ vë re se nga lëndët e tipit A (lëndë bazë) është përfshirë në shëmbullin e PPP vetëm lënda e Statistikës, ndërkohë lëndët e tjera të kësaj kategorie nuk janë përfshirë. Në lëndët e tipit B (lëndë karakterizuese) janë përfshirë 5 nga 11 lëndë. Ndërkohë nga lëndët e tipit C (lëndë ndërdisiplinore), përfshihet vetëm 1(një) nga 3(tre) lëndët e paraqitura në planin mësimor. GVJ rekomandon mundësisht përfshirjen e të gjitha lëndëve të kategorive B dhe C në provimin e formimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e</p>	<p>Në bazë të dokumentit “Rregullore e diplomimit”, temat e diplomave udhëhiqen nga stafi mësimor-shkencor që kanë titull ose gradë shkencore, [Ev. 3_23_2_Rregullorja e Diplomimit], Neni 84, pika 4.</p> <p>Bazuar në RVB dhe takimet me stafin dhe studentët, konkludohet se orientimi dhe ndihma e personelit akademik për studentët në përgatitjen e temës së diplomës realizohet nëpërmjet konsultimit, në rastet kur studenti ka nevojë.</p>

<p>tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe infrastrukturës mësimore, KUQ vë në dispozicion të studentëve të gjitha kapacitetet e tij logjistike dhe infrastrukturore, si biblioteka, laboratorët, sallat, etj edhe jashtë orareve mësimore kur këta kërkojnë ti përdorin për kryerjen e praktikave të tyre mësimore, zhvillimin e projekteve, etj [Ev. 1_24 Infrastruktura mësimore KUQ].</p> <p>Në këtë kriter kërkohet dhe asistenca e IAL për kryerjen e matjeve apo analizave, pra procedurave eksperimentale jashtë institucionit. Bazuar në RVB, studentëve u vihen në dispozicion ambiente dhe pajisje të tjera jashtë institucionit, por kjo gjë nuk faktohet me dokumenta. GVJ rithekson nevojën që ka ky program studimi veçanërisht për zhvillimin e këtyre proceseve, shumë më tepër se programe të tjera të ngjashme studimi në IAL shqiptare.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar ose Punimi i Diplomës ka 7 kredite [Ev. 3_9 Plani mësimor] dhe vlerësohet me notë që llogaritet si mesatare e thjeshtë e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit (3 deri në 5 anëtarë). Shkalla e vlerësimit është e njëjtë me lëndët e tjera të këtij programi [RVB], [Ev. 2_6_1 Rregullore e DMB], Neni 51, pika 2 dhe pika 4. Në po këtë rregullore, Aneks 2, jepet modeli i strukturës dhe kompozimit të tezës së diplomës.</p> <p>Dokumenti [Ev. 3_23_2 Rregullorja e Diplomimit] sqaron në detaje vlerësimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe punimit të diplomës. Ndërkohë GVJ konstaton se nuk ka informacion se çfarë ndodh kur studenti vlerësohet me notë jo kaluese në provimin përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit, Neni 21, pika 4: thuhet se diploma e studentit lëshohet në formatin e saj të miratuar, shoqërohet në listën e notave dhe me Suplementin e saj [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB].</p> <p>Bazuar në rregulloren e Departamentit DMB [Ev. 2_6_1 Rregullore e DMB], në nenin 54 thuhet se diploma e Ciklit të Parë të studimeve bachelor regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Neni 55 thekson se studenti që ka plotësuar të gjitha</p>


programit të studimit të zhvilluar.	<p>kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me diplomën përkatëse, e cila i dorëzohet studentit së bashku me Diplomën Supplement.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diploma plotësohet me shkrim, qartë dhe me bojë teknike. Diploma është e vecantë për secilin nivel dhe nënshkruhet nga Rektori i KUQ dhe Dekani i Fakultetit të Ekonomisë e shoqëruar me vulën e institucionit. <p>Formati i diplomës dhe suplementi i saj janë dokumente të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Megjithatë mungon një dokument mbështetës në lidhje me vendimin e ministrisë përgjegjëse.</p>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>Sipas RVB, por edhe nga vizita e kryer në institucion, GVJ konstatoi që institucioni ruan duke magazinuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse ato kërkohen. Nga depozitimet përkatëse të dokumentacioneve mund të gjendet në çdo moment një kopje respektive duke verifikuar zbatimin e rregullores në çdo pikë.</p> <p>RVB bazohet n dokumentat [Ev. 1_11_], [Ev. 1_12_] dhe [Ev. 1_13_], por GVJ nuk gjeti saktësisht ku përshkruhet ruajtja e dosjeve të studentëve dhe për sa kohë ato mbahen në arkivë.</p>			
Konkluzione	<p><i>IAL garanton një procedurë të qartë për detyrimet përmbyllëse të studentit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Studentët me mesatare mbi 8 përgatisin punimin e diplomës, ndërsa të tjerët i nënshtrohen provimit përfundimtar, por mungon informacioni publik për këtë proces. Rregullorja ofron udhëzime të detajuara për strukturën e diplomës, por nuk ka lëndë specifike për shkrimin akademik. Provimi përfundimtar përfshin tematika kryesore, por jo të gjitha lëndët janë të përfaqësuara. Personeli akademik asiston në përgatitjen e diplomës dhe institucioni ofron kapacitete logjistike. Vlerësimi realizohet nga komisioni dhe notat janë të standardizuara. Studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e saj të miratuar nga ministria përkatëse. Institucioni ruan dokumentacionin e studentëve dhe paraqet informacionin kur kërkohet, megjithatë mungon një dokument specifik për ruajtjen dhe kohëzgjatjen e arkivimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

standardeve të fushës III				
------------------------------	--	--	--	--

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KUQ, GVJ konstaton se departamenti përgjegjës 'Menaxhim Biznesi', për këtë program studimi mban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie, ku përfshihet personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet çdo vit, lëndët që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për çdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale. Personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor 'Informatikë Ekonomike e Biznesi', përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik por nuk është në përputhje plotësisht me fushën e studimit. Fushën e Informatikës e mbulon staf PAK.</p> <p>Rekomandime: <i>GVJ rekomandon zgjerimin e stafit PAE në fushën e Informatikës dhe Shkencave Kompjuterike.</i></p> <p>Evidenca: Ev. 3 10 Staf akademik Departamentit.pdf Ev. 3 11 Staf akademik që jep mësim në programin e studimit. -.pdf</p>

programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.									
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KUQ, GVJ konstaton se Institucioni ka një rregullore në të cilën përcaktohen procedurat dhe funksionet e njëjse drejtuese, të cilat ndikojnë në ndarjen e ngarkesës [Ev. 1 4 Rregullore KUQ.pdf, Neni 50, 51, 52]. Personeli akademik efektiv aktualisht në vitin akademik 23-24, mbulon kurset e fushës ekonomike dhe të Biznesit, te ngarkesës mësimore për programin e studimit. Nuk ka informacion tek evidencat e paraqitura per vitin akademik 21-22								
Titulli	Stafi akademik për programin e studimit Bachelor 'Informatikë Ekonomike e Biznesi'								
	(Viti akademik 21-22)			(Viti akademik 22-23)			(Viti akademik 23-24)		
PAE	PAK	Raporti PAE/P AK	PAE	PAK	Raporti PAE/P AK	PAE	PAK	Raporti PAE/P AK	
Lektor ë me titullin Prof. Dr			1	0	1/0	3	0	3/0	
Lektor ë me titullin Prof. të Assoc.			1	1	1/1	2	1	2/1	
Lektor ë me gradën Dr/Phd			1	0	1/0	4	5	4/5	
Asistente me Msc (në proces Dr)			1	0	1/0	0	0	0/0	

	Asiste ntë me Msc				1	0	1/0	6	1	5/1
	Totali				5	1	5/1	15	7	15/7
	<p>Evidenca: <u>Ev. 3 10 Stafi akademiki Departamentit.pdf</u> <u>Ev. 3 11 Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit. -pdf</u> <u>Ev. 3 13 Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim në programin e studimit.pdf</u></p>									
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KUQ, GVJ konstaton se KUQ ka kontrata pune me secilin punonjës të stafit akademik PAE dhe PAK. Çdo fillim viti burimet njerëzore në bashkëpunim me fakultetin dhe departamentin përgjegjës për programin Bachelor 'Informatikë Ekonomike e Biznesi' përditësojnë listën e personelit akademik. Në zyrën e burimeve njerëzore gjenden dosjet e personelit, në të cilat përfshihen kontratat e punës, raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit, cv, diploma, kualifikime etj. Sa i përket qëndrueshmërisë së personelit akademik, 2021-2024, nuk ka një informacion të saktë nga viti në vit. Ajo që dallohet qartazi, është mungesa e stafit akademik në fushën informatike, e cila mbulohet nga stafi PAK.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>Që KUQ duhet të krijojë strategji në mbështetje të stafit dhe zgjerimit të tij.</i></p> <p>Evidenca: <u>Ev. 1 13 Rregullore e ZBNJ dhe procedura.pdf</u> <u>Ev. 1 13 5 Plani Strategjik mbijetimit.pdf</u> <u>Ev. 2 34 Numri i personelit akademik.pdf</u> <u>Ev. 3 7 Ngarkesa mësimore.pdf, fq 3</u> <u>Ev. 2 4 1 Relacion përrealizimin e Plan Veprimit.pdf</u> Informacion nga burimet njerëzore</p>									
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme</p>	<p>Bazuar në RVB-në e paraqitur nga KUQ dhe në varësi të nevojave të departamentit Fakulteti i Ekonomisë, i paraqet zyrës së burimeve njerëzore (ZBNJ) kërkesën për fillimin e procesit të rekrutimit. ZBNJ shpall vëndin vakant në faqen zyrtare të kolegjit, https://qiriaz.edu.al/pozicione-vakante/. Aplikantët ftohen të dergojnë online dokumentacionin e specifikuar në thirrjen e shpallur. Vlerësimi i kandidatit kalon në 2 faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Vlerësimi paraprak i dosjes ✓ Intervista <p>Aplikantët njoftohen nga ZBNJ përmes mail-it /telefonit.</p>									

<p>dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Evidenca: Ev. 1 13 Rregullore e ZBNJ dhe procedura.pdf Ev. 1 13 5 PlaniStrategjikmbi trajnimin.pdf Ev. 1 4 Rregullore e Kolegjit.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në IAL, nuk ka personel të deklaruar ndihmës akademik i angazhuar pranë departamentit të Menaxhim Biznesit.</p> <p>Evidenca: Ev. 3 0 RVB_Informatike Ekonomike & Biznesi.pdf Ev. 3 10_ Staf i akademik i Departamentit.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni</p>	<p>GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishme dosje të lektorëve të brendëshëm dhe të jashtëm, nga ku konsaton se ZBNJ ka dosjet me dokumentat përkatëse për</p>

<p>mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>të gjithë personelin, ku për çdo pedagog të programit disponon të dhënat e kualifikimeve të tij/ të saj, kontratat e punës, dokumente që lidhen me vjetërsinë në punë, të dhëna për zhvillimin e vijueshëm profesional. Të dhënat azhurnohen çdo vit akademik.</p> <p>Evidenca: Vizita ne IAL Ev._1_13_ Rregullore e ZBNJ dhe procedura.pdf</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me</p>	<p>KUQ ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në rang universiteti. Janë marrëveshje me universitete kombëtare/ndërkombëtare, institucione ose kompani. Këto marreveshje i vijnë në ndihmë studentëve për zhvillimin e praktikave profesionale. Studentët e këtij programi studimi janë në vitin e 3, kështuqë nuk ka një procedurë praktike të realizuar. Bazuar në evidencat e dorëzuara nga GVB nuk ka një relacion specifik të përfitimeve që mund të</p>




<p>institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>kenë studentët e programit Informatike Ekonomike & Biznesi, nga këto marrëveshje.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>Hartimin e një relacioni të përfitimeve që mund të kenë studentët e programit Informatikë Ekonomike & Biznesi, nga këto marrëveshje.</i></p> <p>Evidenca: Ev. _3_15_3_Lista e bashkëpunëtorëve me praktika.al.pdf Ev. _1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf Ev. _1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit pj 1.pdf</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen</p>	<p>Kurrikula e programit bachelor Informatikë Ekonomike & Biznesi, ka në përbërje Praktikën Profesionale (8 kredite). Departamenti nuk ka një rregullore të miratuar për procesin e zhvillimit dhe vlerësimit të praktikave profesionale për këtë program studimi.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>Hartimin e një rregullore / udhëzimi për procedurën e organizimit dhe vlerësimit të praktikës profesionale.</i></p> <p>Evidenca: Ev. _3_9_Plani mësimor.pdf Ev. _3_9_1_Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit..pdf Ev. _3_9_2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit BA në IEB.pdf .pdf</p>

e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se në KUQ/FE programi i studimit bachelor “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit, nuk përmbush standardet në përputhje me fushën e programit të studimit. KUQ ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi në rang universiteti. Janë marrëveshje me universitete kombëtare/ndërkombëtare, institucione ose kompani.</i></p> <p>GVJ rekomandon: <i>Që KUQ duhet të krijojë strategji në mbështetje të stafit dhe zgjerimit të tij në fushën e Informatikës dhe Shkencave Kompjuterike.</i> <i>Hartimin e një udhëzimi për procedurën e organizimit dhe vlerësimit të praktikës profesionale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit</p>	<p>GVJ nga vizita në institucion konstaton se procesi mësimor zhvillohet në godinën që ndodhet në qendër të Kampusit UBT. Çdo klasë, auditor, laborator ku zhvillohet procesi mësimor janë brenda standardeve ligjore. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar.</p> <p>Evidenca: Ev._1_24_Infrastruktura mësimore KUQ.pdf Ev._1_24_Infrastruktura mësimore pjesa II.pdf</p>

dhe moduleve përkatëse.	Ev._1_21_Certifikata për sigurinë zjarri, Sanitar,Dezinfektim.pdf Ev._1_20_Raport vlerësimi.pdf
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në KUQ, auditoret janë t* p*rshtatshme p*r zhvillimin e m*simit teorik, kurse laborator*t janë të pajisura n* nivel bazik me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Sa i përket programit të studimit bachelor 'Informatikë Ekonomike dhe Biznesi', në dispozicion ka 2 laboratorë të pajisur me PC, projektor etj. Evidenca: Ev._1_24_Infrastruktura mësimore KUQ.pdf Ev._1_24_Infrastruktura mësimore pjesa II.pdf
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në KUQ laborator*t janë të pajisura n* nivel bazik me mjete elektronike, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Sa i përket programit të studimit bachelor 'Informatikë Ekonomike dhe Biznesi', në dispozicion ka 2 laboratorë ku teknologjia HW dhe SW duhet t* azhurnohen me zhvillimin e tregut. Evidenca: Ev._1_24_Infrastruktura mësimore KUQ.pdf Ev._1_24_Infrastruktura mësimore pjesa II.pdf
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në ambientet e IAL-së, GVJ konstaton se KUQ ka laborator të dedikuar për programin e studimit, i cili është i pajisur me aparatura dhe mjete të nevojshme për të trajtuar lëndë të shkencave kompjuterike. GVJ rekomandon: <i>Azhornimin e parametrave teknologjikë sa i përket PC, SW etj, në funksion të programit të studimit.</i> Evidenca: Ev._1_20_Raport vlerësimi.pdf

	<p>Ev_3_30_Lista e software-ve në Laboratorin e Ekonomisë së Aplikuar..pdf</p> <p>Ev_3_20_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit..pdf</p> <p>Vizita ne IAL</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se KUQ ka mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit të mësimdhënies. Në dispozicion të studentëve janë auditorë dhe laboratorë në përmbushje të kërkesave të programit të studimit.</i></p> <p>GVJ rekomandon:</p> <p><i>Azhornimin e parametrave teknologjikë sa i përket PC, SW etj, në funksion të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura e cila ofrohet në format elektronik ose të printuar, mund të përdoret nga studentët për të marrë njohuritë në kurset e programit që ato ndjekin. Materialet në formë elektronike gjenden në klasat virtuale të krijuar në platformën google classroom, në mënyrë individuale nga lektori. Gjithashtu KUQ disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar. Referuar syllabus-eve të paraqitura si evidenca, vërehet që kurset kanë literaturë në përputhje me përmbajtjen e kursit, e cila ofrohet në shqip por literatura nuk është e azhornuar brenda 5 viteve të fundit.</p> <p>Referuar evidencave [Ev_3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III.pdf] të paraqitura nga IAL-ja dhe GVB-ja, rezulton se ka mangësi në numrin e syllabuseve të paraqitura, në referencë me kurrikulën e programit të studimit, edhe pse gjatë vizitës në institucion është vënë në dijeni GVB-ja dhe koordinatori i programit.</p> <p>Evidenca:</p>

	Ev._3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III.pdf
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>GVJ konstaton se çdo fillim viti akademik, përgjegjësi i njësisë bazë dhe kordinatori i programit të studimit në bashkëpunim me pedagogët e lëndës sugjerojnë titujt që duhet ti shtohen bibliotekës. Sa i përket programit të studimit, bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” vërehet se literatura nuk është e pasur dhe e përditsuar, kryesisht në fushën informatike.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>Azhornimin e literaturës së sugjeruar, pasi për kurse specifike, i përket viteve 2006-2010.</i></p> <p>Evidenca: Ev._3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III.pdf Ev._3_20_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit..pdf Ev._1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf, Neni6, 7 Ev._2_22_Shembull Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve.pdf</p>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Tek KUQ, ofrohet një bibliotekë e cila i krijon mundësi studentëve të aksesojnë fizikisht materialet dhe tutorialet e nevojshme. Literatura në bibliotekë shtohet çdo vit bazuar në kërksat e stafit akademik.</p> <p>Evidenca: Ev._1_20_Raport vlerësimi.pdf Ev._1_24_Infrastruktura mësimore KUQ.pdf Ev._1_24_Infrastruktura mësimore pjesa II.pdf Ev._1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf Ev._2_22_Shembull Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve.pdf</p>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e	<p>Bazuar në vizitën në IAL, u verifikua që KUQ, ofron një bibliotekë fizike. Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe revista shkencore. Biblioteka ofron libra fizikë, ku një përqindje relativisht të vogël zënë botimet në fushën e informatikës në mbështetje të programit të studimit. Studentët duhet të paraqiten fizikisht në ambientet e bibliotekës, për të aksesuar burimet. KUQ nuk ofron një bibliotekë online, në mënyrë që të aksesohen materialet edhe online në distancë.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>KUQ duhet ti ofrojë studentëve mundësinë e aksesit online të materialeve në ndihmë të programit të studimit.</i></p> <p>Evidenca:</p>

veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Ev. _1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës.pdf Ev. _2_22_Shembull Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve.pdf
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	KUQ ofron një bibliotekë fizike dhe nuk ka burime online. Biblioteka online në KUQ ka të bëjë me digjitalizimin e literaturës së sugjeruar nga lektorët në CD, ku studentët mund të aksesojnë vetëm në ambientet e KUQ. Këto hapësira ofrojnë materiale të aksesueshme, pa pagesë për studentët. [Vizita në IAL]
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KUQ, GVJ konstaton se në bibliotekë ka PC, me software-t e nevojshëm, të lidhur në internet për të mundësuar një përdorim sa më eficient të burimeve që biblioteka ka apo ofron. [Vizita në IAL]
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orarin zyrtar 8.00-17.00. Këto orare janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, në përgjigje edhe të nevojave të studentëve. Në KUQ ofrohet shërbimi i internetit Wi-Fi, përmes së cilës studentët mund të aksesojnë literaturën e dëshiruar. Evidenca: Ev. _3_0_RVB_Informatike Ekonomike & Biznesi.pdf Vizita në IAL
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online	Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit të studimit bachelor “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, çdo fillim viti akademik zhvillojnë procedurën për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës përmes një kërkesë të departamentit bazuar në kërkesat e stafit. Këto kërkesa përfshihen në planin buxhetor të KUQ. Evidenca: Ev. _3_0_RVB_Informatike Ekonomike & Biznesi.pdf Ev. _3_20_Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit.pdf Ev. _1_3_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit.pdf, pika 2.7 Ev. _1_22_Plani buxhetor.pdf




nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se çdo lektor i vendos studentëve në dispozicion syllabusin e lëndës në të cilin ndodhet literatura bazë dhe ndihmëse. Literatura e cila ofrohet në format elektronik ose të printuar, mund të përdoret nga studentët për të marrë njohuritë në kurset e programit që ato ndjekin. Materialet në formë elektronike gjënden në klasat virtuale të krijuara në platformën google classroom nga vetë lektorët. KUQ disponon një bibliotekë në të cilën të gjithë studentët mund të aksesojnë literaturën e sugjeruar fizikisht.</i></p> <p>GVJ rekomandon:</p> <p><i>Azhornimin e literaturës së sugjeruar, pasi për kurse specifike, i përket viteve 2006-2010.</i></p> <p><i>KUQ duhet ti ofrojë studentëve mundësinë e aksesit të bibliotekës online të materialeve në ndihmë të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në</p>	<p>KUQ nuk disponon një sistem të unifikuar të menaxhimit të të dhënave, por përdor metoda alternative si platforma Google Classroom, ku administrohet dhe menaxhohet i gjithë informacioni që lidhet me mësimdhënien e studentët. Sipas drejtuesve dhe stafit, sistemet e menaxhimit të informacionit janë: faqja web e IAL-së, rrjetet sociale etj. KUQ po punon për implementimin e një sistemi të unifikuar për menaxhimin e të dhënave.</p> <p>GVJ rekomandon</p>

<p>diplomim në programin e studimit.</p>	<p><i>Të futet në përdorim një sistem i unifikuar për menaxhimin e të dhënave.</i></p> <p>Evidenca: Ev. 1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave on-line.pdf Ev. 1_18_Metodat e mësimdhënies në distancë.pdf Ev. 1_3_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në KUQ nuk ka një sistem të brendshëm menaxhimi, ku mund të administrohet informacioni, dokumentacioni dhe aktiviteti i personelit PAE/PAK, personelit ndihmësakademik, dhe zyrave përkatëse, siç është psh. sekretaria, të angazhuar në realizimin e programit. Të dhënat ruhen në formë digjitale, në PC e zyrave përkatëse.</p> <p>GVJ rekomandon <i>Të krijohet një sistem i brendshëm për menaxhimin e të dhënave.</i></p> <p>Evidenca: Ev. 1_10_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale.pdf Ev. 1_11_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.pdf Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf Ev. 1_13_Rregullore e ZBNJ dhe procedura.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në KUQ nuk ka një sistem të brendshëm menaxhimi, me akses të dedikuar ndaj dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik të angazhuar në IAL. Dosjet e personelit ruhen në formë fizike pranë ZBNJ sipas një formati të përcaktuar, në referencë me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf Ev. 1_13_Rregullore e ZBNJ dhe procedura.pdf Ev. 1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave on-line.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>IAL-ja ka integruar platforma dhe module në ndihmë të procesit të mësimdhënies, siç është Google Classroom, si një formë alternative e procesit mësimor. Komunikimi me publikun realizohet përmes faqes zyrtare web, mediave sociale etj.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave on-line.pdf https://qiriaz.edu.al/</p>




<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>KUQ nuk disponon një sistem të menaxhimit të të dhënave ku mund të administrohet, menaxhohet i gjithë informacioni që lidhet me mësimdhënien dhe studentët. KUQ po punon për ndërtimin e një sistemi të unifikuar për menaxhimin e të dhënave.</p> <p>Evidenca: Ev._1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave on-line.pdf Ev._1_18_Metodat e mësimdhënies në distancë.pdf Ev._1_26_Vendim i B A për pagesën e konferencave dhe bibliotekës.pdf Ev._1_3_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit.pdf</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit Bachelor në “Informatikë ekonomike dhe Biznesi”, personelin akademik dhe aktivitetet të ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, gjuha shqipe dhe gjuha angleze.</p> <p>Evidenca: https://qiriaz.edu.al/stafi-akademik/ https://qiriaz.edu.al/bachelor-nformatike-ekonomike-dhe-biznesi/</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KUQ nuk disponon një sistem të menaxhimit të të dhënave, nëpërmjet të cilit administrohen të gjithë informacionin që lidhet me stafin dhe studentët. E gjithë procedura akademike realizohet përmes metodave alternative. Sistemi i menaxhimit siguron akses për të gjithë personelin PAE/PAK dhe studentët e programit të studimit kështuqë është një domosdoshmëri për institucionin.</i></p> <p>GVJ rekomandon <i>Të krijohet dhe futet në përdorim një sistem i unifikuar për menaxhimin e të dhënave.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p> <p>X</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve




<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në KUQ, GVJ konstaton se në fillim të çdo viti akademik, IAL-ja depoziton raporte pranë fakulteteve të njësisë bazë dhe njësisë administrative të tjera të kolegjit për të mbledhur informacion mbi nevojat e tyre specifike. Në fillim të çdo viti akademik hartohet buxheti, i cili pasqyron shpenzimet bazuar në kërkesat e departamenteve dhe të ardhurat e IAL-së duke mbështetur një cikël të plotë studimi.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_1_Statuti KUQ.pdf Ev. 1_3_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit.pdf Ev. 1_22_Plani buxhetor.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstaton se KUQ fondet parësore i ka nga tarifat e studimit të studentëve dhe investimeve të vetë institucionit, fonde nga të tretë nuk ka. Çdo fillim viti akademik departamentet depozitojnë kërkesat për nevojat që ata kanë në lidhje me literaturën, kërkimin shkencor, pajisjet laboratorike etj. Zyra e financës përgatit planin financiar 1-3 vjeçar, për çdo program studimi.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_22_Plani buxhetor.pdf Ev. 3_21_Vendimi i Senatit Akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor miratuar.pdf Ev. 1_26_Vendim i B A për pagesën e konferencave dhe bibliotekës.pdf Ev. 1_25_Vendimi i BA për tarifa dhe bursa.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe</p>	<p>GVJ konstaton se KUQ realizon në mënyrë periodike një auditim të brendshëm, me kërkesë të drejtuesit të IAL-së. Çdo vit raporti i pasqyrave financiare i nënshtrohet kontrollit sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilizimit. Institucioni kryen auditime të përvitshme, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e</p>




<p>efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Shpenzimet për këtë program studimi bazohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Paga; ✓ shpenzime operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive; ✓ shpenzime për bibliotekën etj. <p>Të gjitha pasqyrohen ne raportin financiar vjetor të KUQ.</p> <p>Evidenca: Ev_1_1_Statuti KUQ.pdf Ev_1_22_Plani buxhetor.pdf Ev_1_4_2_Rregullore e BA.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>KUQ në fillim të çdo viti harton buxhetin vjetor dhe një parashikim të vetë institucionit dhe programit të studimit, që të kuptojë dhe planifikojë nevojat. KUQ krijon një raport financiar, ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet, i cili hartohet pasi është diskutuar në senat dhe në bordin e administrimit.</p> <p>Evidenca: Ev_1_22_Plani buxhetor.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KUQ garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”. KUQ pas diskutimeve dhe kërkesave deri në nivel departamenti, harton pasqyrat financiare, të cilat diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e senatit dhe Bordit të administrimit. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje dhe diversifikim të financimit të programeve të studimeve.</p> <p>Evidenca: Ev_1_22_Plani buxhetor.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se KUQ ka qëndrueshmëri të të ardhurave. Çdo fillim viti hartohet raporti financiar, ku përfshihen kërkesat dhe nevojat e njësisë bazë dhe programit të studimit bachelor “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”. Të ardhurat për këtë program studimi bazohen në: tarifat e studentëve dhe nga rrjeti i bizneseve të vetë shoqërisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	RVJ konstatoi se KUQ ka politika që ndjekin studentët nga hyrja në dalje, përmes një strukture të organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Orientimi dhe këshillimi i studentëve fillon që nga momenti i informimit të maturantëve për programet e studimit deri në përfundimin e tyre. Evidenca: Ev. 3 3 Plani strategjik i Programit të studimit.pdf Ev. 1 4 Rregullore e Kolegjit.pdf , Kreu XI, XII, XIII
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se programi i studimit bachelor 'Informatikë Ekonomike dhe Biznesi', mund të ndiqet nga çdo shtetas shqiptar, etnitë jashtë kufijve shtetërore si dhe çdo shtetas i huaj, në bazë të legjislacionit në fuqi. KUQ krijon mundësi komunikimi me ambientin e jashtëm nëpërmjet faqes web zyrtare, ditëve të informimit, fletëpalosjeve, etj. Kriteret bëhen të ditura në fillim të vitit akademik. Evidenca: Ev. 1 1 Statuti KUQ.pdf , Kreu V Ev. 1 4 Rregullore e Kolegjit.pdf , Kreu XI, XII, XIII
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni	GVJ konstaton se çdo vit akademik, referuar urdhërit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për regjistrimet dhe transferimet, publikon në web-in e KUQ, informacion lidhur me programet e studimit dhe kriteret përkatëse. Propozimi bëhet nga departamenti përgjegjës për programin e studimit. Kriteret e pranimit për maturantët që mbarojnë me sukses ciklin e mesëm janë: 1. Kriteri i meritës(mesatare e shkollës së mesme);

<p>bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>2. Udhëzimeve të MAS për regjistrimet e studentëve në vitin akademik vijues;</p> <p>3. Krieteve të hartuara nga KUQ për çdo program studimi.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_28_Kriteret e pranimit.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konstatoi se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, vlerësimet gjatë programit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të aksesueshme përmes faqes web. Gjithashtu në KUQ ndodhet zyra e marrëdhënieve me jashtë, pranimeve dhe këshillimit të karrierës që ndihmon studentët në lidhje me programin e studimit. Kriteret janë të përcaktuara në rregulloren e departamentit dhe fakultetit të programit të studimit, dhe në rregulloren e ZMJPKK.</p> <p>Evidenca: https://qiriaz.edu.al/bachelor-nformatike-ekonomike-dhe-biznesi/ Ev. 1_28_Kriteret e pranimit.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe evidencat se përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Këto kritere bëhen publike në në faqen web të KUQ, rrjetet sociale, takimet me maturanët, ditët e hapura, etj.</p> <p>Evidenca: Ueb: https://qiriaz.edu.al/bachelor-nformatike-ekonomike-dhe-biznesi/ Ev. 1_37_Fletëpalosje e Kolegjit.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, në përputhshmëri me Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe kandidatëve nga shtete të tjera.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_1_Statuti KUQ.pdf, Kreu V Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf, Kreu XI, XII, XIII Ev. 1_28_Kriteret e pranimit.pdf</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>Institucioni informon të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. Këto kritere</p>

akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	bëhen publike në në faqen web të KUQ, rrjetet sociale, takimet me maturantët, ditët e hapura, etj. Evidenca: Ueb: https://qiriazhi.edu.al/bachelor-nformatike-ekonomike-dhe-biznesi/ Ev. 1_28_Kriteret e pranimit.pdf								
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstatoi nga vizita në IAL se KUQ ka përcaktuar politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë bazuar në Ligjin 80/2015 dhe Urdhërit përkatës të përvitshëm të MAS. Gjithashtu me mbështetjen e KUQ, sipas një procedure të mirëpërcaktuar me ligj, ofron tarifa të reduktuara për studentët që regjistrohen në turin e parë dhe ata studentë që vazhdojnë studimet në KUQ. Në KUQ ofrohen politika për studentët me mesatare mbi tetë dhe studentët ekselentë. Evidenca: Ev. 1_25_Vendimi i BA për tarifa dhe bursa.pdf								
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se KUQ harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor 'Informatikë Ekonomike e Biznesi'. IAL-ja përdor faqen zyrtare të webit, rrjetet sociale si mjet komunikimi gjithëpërfshirës. KUQ ofron mundësinë e regjistrimit në këtë program, të studentëve shqiptarë, të huaj etj. Universiteti ofron bursa për studentët me arritje të larta dhe bursa ekonomike.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe	GVJ konstatoi nga vizita në IAL dhe RVB e dorëzuar në sistem se KUQ vë në dispozicion një informacion të pjesshëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. [Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf] Informacioni për mënyrën e vlerësimit, u dërgohet studentëve përmes mail-it, ose përmes sekretarisë mësimore. Koordinatori i programit ka detyrë të ndjekë studentët nga hyrja në dalje dhe koordinon procesin akademik brenda dhe jashtë. Evidenca:

kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Ev. 3_23_2_Rregullorja e Diplomimit.pdf Ev. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe detyrat e tij.pdf Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në programin e studimit bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, nuk ka patur raste transferimi të studentëve. Megjithatë procedura nuk është e paraqitur qartë, nuk ka një rregullore të transferimeve. Në rregulloren e programit të studimit dhe [Ev. 1_28_Kriteret e pranimit.pdf] jepet një pershkrim i shkurtër, për kriteret e pranimit në programin “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” por jo për procedurat e transferimeve. <i>GVJ rekomandon që KUQ të informojë përmes një rregullore ose udhëzimi studentët në lidhje me procedurën e transferimit të studimeve.</i> Evidenca: Ev. 1_28_Kriteret e pranimit.pdf Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga IAL-ja dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit. Java e parë të mësimi shërben si prezantim i programit të lëndës dhe vlerësimit përkatës. Evidenca: Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BA në IEB_III.pdf
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstatoi që institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e diplomimit të studentëve në programin e studimit bachelor “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, në semestrin e 5 të studimeve. KUQ ka një rregullore për procedurën e diplomimit të studentëve. Evidenca: Ev. 3_23_2_Rregullorja e Diplomimit.pdf Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për	KUQ përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale që ai menaxhon, ambientet e IAL-së, fletëpalosje dhe broshura, të cilat japin informacion rreth pershkrimit të programit të studimit, objektivat, kriteret, mundësitë e punësimit, kurrikulën etj. Gjithashtu në KUQ, organizohen Ditët e Hapura, të cilat shërbejnë për njohjen e studentëve me ambientet dhe stafin, dhe panairi ‘Work & Study’. Evidenca: Ev. 3_24_Raport për Ditën e Hapur.pdf

informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Ev. _3_3_Veprintaria formuese e programeve.pdf Ev. _3_29_ Raport për Panairin e Punës.pdf Ev. _3_30_ Katalogu i KUQ.pdf			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se KUQ përdor mjete të ndryshme informimi, përmes publikimit të informacionit në rrjetet sociale që ai menaxhon, ambientet e IAL-së, fletëpalosje dhe broshura. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të studentëve në programin e studimit dhe procesin e diplomimit.</i> <i>GVJ rekomandon që KUQ duhet të hartojë një udhëzim sa i përket procedurës së transferimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion në faqen web, rrjetet sociale etj., dhe fletëpalosje/ udhëzues për lëndët/modulet, kurrikulën dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion gjendet në rregulloren e programit të studimit dhe njësisë bazë. Evidenca: Ev. _3_23_2_Rregullorja e Diplomimit.pdf Ev. _3_5_3_Rregullore IEB.pdf Ev. _2_6_1_Rregullore e DMB.pdf, Neni 15 Ev. _3_3_Veprintaria formuese e programeve.pdf, fq 20
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion në faqen web, rrjetet sociale etj., dhe shpërndan fletëpalosje/ udhëzues për lëndët/modulet, kurrikulën dhe veprimtaritë formuese. Evidenca: Ev. _1_37_Fletëpalosje e Kolegjit.pdf Ev. _1_36_Faqja zyrtare e internetit.pdf Ev. _1_35_Marketingu në Kolegjin.pdf

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>KUQ, ka një strukturë përgjegjëse për orientimin dhe informimin e studentëve, siç është ZMJP&KK [Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf, Kreu III] ku synojnë mbështetjen e IAL-së dhe studentëve në tregun e punësimit. KUQ ka bashkëpunime në ndihmë të studentëve, por nuk ka një relacion që tregon sa % e bashkëpunimeve janë në mbështetje të programit ‘Informatikë Ekonomike dhe Biznesi’.</p> <p>Evidenca: Ev. 3_2_Dosja e programit të studimit.pdf Ev. 3_7_Studimi i tregut të punës për programin e studimit..pdf Ev. 3_28_Panairi Career Fair.pdf Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf, Kreu III</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët e programit “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi” njihen me orarin që në fillim të semestrit dhe njoftohen përmes sekretarisë mësimore ose rrjeteve sociale për ndryshime në orar. Koordinator i programit të studimit dhe sekretaria mësimore mbajnë kontakte të afërta dhe të shpeshta me studentët. Në KUQ zhvillohen Ditët e Hapura, ku studentët njihen me ambientet dhe personelin përgjegjës për menaxhimin e tyre. Staf i akademik që në fillim të semestrit njofton studentët në lidhje me programin e kursit dhe menyrat e vlerësimit. Ky informacion mund të gjendet edhe në faqen Web: https://qiriaz.edu.al/bachelor-nformatike-ekonomike-dhe-biznesi/</p> <p>Evidenca: Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore KUQ.pdf Ev. 1_20_Raport vlerësimi.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit paraqitet në faqen web të KUQ dhe rrjetet sociale, e cila është lehtësisht e arritshme nga studentët kudo ata ndodhen. Studentët marrin informacion rreth performancës dhe arritjeve të tyre akademike përmes sekretarisë mësimore. Nuk ka një sistem menaxhimi që studentët mund të aksesojnë.</p> <p>Evidenca: https://qiriaz.edu.al/bachelor-nformatike-ekonomike-dhe-biznesi/ Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se KUQ ofron mbështetje ndaj studentëve, në KUQ zhvillohen ditët e orientimit, ku studentët njihen me ambientet dhe personelin përgjegjës për menaxhimin e tyre. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për kurrikulën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Studentët marrin informacion rreth performancës dhe arritjeve të tyre akademike përmes sekretarisë</i></p>




	<i>mësimore. Nuk ka një sistem menaxhimi që studentët mund të aksesojnë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstatoi se KUQ mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar, në programin e studimit 'Informatikë Ekonomike dhe Biznesi'. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet në program dhe largimet. Studentët informohen në fillim të çdo viti për mënyrën organizimit të kurseve, kreditet, vlerësimin përmes syllabusit të kursit.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Informacioni ruhet në format elektronik dhe hard-copy, në sekretarinë mësimore në regjistrin themeltar. Në këtë program studimi statistikat janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Viti 2021-2022, 8 studentë të regjistruar ✓ Viti 2022-2023, 8 studentë të regjistruar ✓ Viti 2023-2024, 10 studentë të regjistruar Ky program nuk ka akoma studentë të diplomuar. Në sekretari nuk ka regjistër notash pasi IAL-ja nuk është pajisur akoma QSHA-ja. <p>Evidenca:</p> Ev. _2_25_Numri i studentëve të regjistruar.pdf Ev. _2_26_Numri i studentëve të diplomuar, notat në hyrje & dalje.pdf Ev. _3_28_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit..pdf Ev. _3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe	Informacioni statistikor në lidhje me programin e studimit ruhet në sekretarinë mësimore në formë fizike dhe në skedar elektronik. Studentët nuk mund të aksesojnë informacionin e vlerësimit, notave, provimeve përmes një sistemi të brendshëm, vetëm përmes sekretarisë mësimore. <p><i>GVJ rekomandon integrimin e një sistemi menaxhimi të të dhënave në mënyrë që të ketë akses online të informacionit.</i></p>

lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Evidenca: Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore.pdf
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ konstatoi që bazuar në rregulloren e NJSBC-së, IAL-ja zhvillon kontrole periodike çdo vit ku vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët dhe programet e studimit. Këto të dhëna paraqiten në raportin vjetor, dhe i dërgohen Komisionit të përhershëm të sigurimit cilësisë, i cili i përcjell në senat. Të dhënat në lidhje me vleresimet dhe analizat ndaj studentëve ruhen në sekretarinë mësimore, në formë elektronike CD/DVD ose në regjistrat themeltar të miratuar nga MASR <i>GVJ rekomandon përdorimin e sistemit të menaxhimit të brendshëm për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave.</i> Evidenca: Ev. 1_1_Statuti KUQ.pdf Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC.pdf Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC.pdf
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë harton raporte analitike, mbi aktivitetin akademik, ngarkesën, studentët, përqindjen e cilësisë së punësimit të tyre. Ky informacion paraqitet në raportin vjetor të njësisë bazë të IAL-ës. Në raport përfshihen edhe rekomandimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve. Në këtë program studimi nuk ka akoma studentë të diplomuar. Evidenca: Ev. 2_27_Numri i studentëve të diplomuar dhe punësimi.pdf Ev. 2_28_Të dhëna tabelore mbi anëtarët e NjsBC.pdf Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se KUQ mban statistika vjetore për numrin e studentëve, në programin e studimit bachelor "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi". Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, transferimet në program dhe largimet. Në sekretari nuk ka regjistër notash pasi IAL-ja nuk është pajisur akoma nga QSHA-ja. Në këtë program studimi nuk ka akoma studentë të diplomuar.</i> <i>GVJ rekomandon integrimin e një sistemi menaxhimi të të dhënave në mënyrë që të ketë akses online të informacionit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>KUQ parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore në fuqi. Në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 dhe statutin e kolegjit, studentët janë të përfaqësuar në organe vendimmarrëse, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Senati akademik; 2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; 3. Këshilli i etikës; 4. Këshilli studentor; 5. Mbledhje departamenti. <p>Studenti ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përfaqësinë studentore.</p> <p>Evidenca: Ev_1_4_1_Rregullore e Senatit.pdf Ev_1_4_3_Rregullore e Këshillit Studentor.pdf Ev_1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev_1_5_Rregullore e NJSBC.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>KUQ, garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, i cili në bashkëpunim me organet drejtuese ushtron veprimtarinë e tij. Studentët përfshihen përmes opinionit të tyre në hartimin e raportit vjetor nga NJSBC.</p> <p>Evidenca: Ev_1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev_1_4_3_Rregullore e Këshillit Studentor.pdf Ev_1_5_Rregullore e NJSBC.pdf Ev_1_8_Rregullore e Këshillit të Etikës.pdf Ev_1_31_Veprimtaria e shoqatave studentore.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit,</p>	<p>GVJ konstatoi se njësitë përgjegjëse, mbledhin të dhëna dhe informacion, me qëllim të diskutojnë performancën, kushtet laboratorike, nevojat dhe pritshmëritë, rishikimi i sugjerimeve për syllabuset dhe kurrikulën. Njësia e zhvillimit të kurrikulës dhe</p>

<p>rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>cilësisë kryen anketime çdo fund semestri, për çdo kurs dhe pedagog. Gjithashtu zhvillohen takime me studentët, për diskutime dhe informacione.</p> <p>Evidenca: Ev. _2_4_1_Relacion për realizimin e Plan Veprimit.pdf Ev. _2_10_3_Analiza vjetore e KPL.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët e programit “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”, shprehin mendimin e tyre përmes plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e lektorëve në formë anonime. Rezultatet analizohen dhe menaxhohen nga njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë. KUQ jep informacionin e plotë mbi procedurën e vlerësimit, rregulloren e IAL-së, rregulloren e programit të studimit dhe syllabuse. Nëse studenti ka pakënaqësi, ai mund të bëjë një ankimim, të cilin ja drejton dekanit apo njësive përgjegjëse.</p> <p>Evidenca: Ev. _1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. _1_5_Rregullore e NJSBC.pdf Ev. _2_32_Model pyetësori të studentëve i plotësuar.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se studentët janë të përfaqësuar në KUQ. Ata përfaqësohen në Senatin akademik, Këshillin e etikës, Njësinë e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë, Këshillin studentor, Mbledhje departamenti. Sugjerimet e tyre merren në konsideratë nga koordinatori i programit të studimit dhe përgjegjësi i departamentit. KUQ ka rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset, e cila jep informacionin e plotë mbi procedurën e vlerësimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të</p>	<p>KUQ në strukturën e tij ka njësi, me qëllim informimin dhe mbështetjen e studentëve, për procesin mësimor, praktikat</p>




<p>posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>profesionale, këshillim për gjetjen e punës pas diplomimit etj. Këto njësi janë: ZMJKK, Koordinatori i programit të studimit, sekretaria mësimore. Gjithashtu dhe njësitë kryesore dhe bazë kanë procedura për informimin e studentëve.</p> <p>Evidenca: Ev. _1_1_Statuti KUQ.pdf, Neni 15, Kreu V, VII Ev. _1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf, Neni 97, 98 Ev. _1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka një sistem për informimin, këshillimin, ndjekjen e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Njësitë përgjegjëse për këshillim dhe ndjekje të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Strukturat përgjegjëse, si fakulteti, departamenti etj. ⇒ Koordinatori ⇒ Sekretaria mësimore ⇒ ZMJKK
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>KUQ u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Koordinatori i programit të studimit dhe ZMJKK mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe tregun e punës. KUQ ka marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të praktikave profesionale. Studentët e këtij programi studimi duhet të informohen dhe këshillohen se cilat janë marrëveshjet që i vijnë në ndihmë.</p> <p>Evidenca: Ev. _1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf Ev. _1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf Ev. _1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit pj 1.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh,</p>	<p>ZMJKK ndjek studentët pas diplomimit. Kjo zyrë përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit bachelor “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”. ZMJKK realizon orientimin profesional, këshillimin</p>




përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	individual ose ne grup, gjithashtu bashkëpunon me studentët. Zyra e Këshillimit të karrierës realizon leksione të hapura për infomim. Çdo fillim viti kjo zyrë përgatit “Paketën e Informacionit”. Evidenca: Ev._1_14_Rregullore e ZMJP&KK.pdf, Kreu III			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se KUQ u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Njësia për këshillimin e karrierës, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Kjo zyrë realizon orientimin profesional, keshillimin individual ose në grup, gjithashtu bashkëpunon me Studentët dhe Alumni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë	KUQ nuk ka një sistem të mirëfilltë në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së programit të studimit. Bazuar në evidenca [Ev._1_13_5_Plani Strategjik mbi trajnimin.pdf], rezulton që janë bërë disa trajnime në fusha të ndryshme, ku përfshihet edhe integrimi i teknologjis në metodat e mësimdhënies.

<p>të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ rekomandon që të realizohet një relacion përshkrues rreth metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së programit të studimit "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi"</p> <p>Evidenca: Ev. 1_13_5_Plani Strategjik mbi trajnimin.pdf Ev. 1_17_Udhëzues për kualifikimin e stafit.pdf Ev. 1_18_Metodat e mësimdhënies në distancë.pdf Ev. 1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave on-line.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, vërehet se në KUQ ka një njësi të qëndrueshme, Komisioni i përhershëm i Sigurimit të Cilësisë. Kjo njësi bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, dhe menaxhon procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuece periodike, bazuar në strategjinë e zhvillimi institucional. GVJ konstatoi se janë miratuar disa udhëzime që i vijnë në ndihmë këtij qëllimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm.pdf ✓ Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf <p>Përmes pyetësorëve që zhvillohen në mënyrë periodike, ndaj studentëve për stafin dhe kurset, mbliidhen dhe analizohen të dhëna.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC.pdf Ev. 1_5_1 Politikat e NjsBC.pdf Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC.pdf Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>KUQ ofron metoda për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësori [Ev. 2_32_Model pyetësori të studentëve i plotësuar.pdf]. Nga evidencat e paraqitura rezultojnë që IAL-ja e ka të përcaktuar në rregulloren e fakultetit [Ev. 1_4_Rregullore KUQ.pdf, Neni 65] procedurën e ankimimit. Studentët në KUQ kanë hapësirë dhe mundësi të ankimojnë pakënaqësitë e tyre. Gjatë këtyre viteve nuk ka patur proces ankimimi nga ana e studentëve.</p> <p>GVJ rekomandon përfshirjen e të gjitha formave të vlerësimit, sikurse përmenden në manualin e cilësisë, dhe të krijojë një standard të unifikuar vlerësimi, ku çdo formë vlerësimi të ketë peshë të përcaktuar.</p> <p>Evidenca: Ev. 2_32_Model pyetësori të studentëve i plotësuar.pdf Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf</p>




	Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Në KUQ ekziston manuali i cilësisë, ku paraqiten strukturat përberëse dhe format e përdorura sa i përket sigurimit të cilësisë. Strukturat aktive të përfshira në këtë detyrë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati KUQ; • Rektori; • NJSBC; • Grupi i vlerësimit të Brendshëm; • Drejtuesi i Njësisë kryesore. <p>NJSBC ka si detyrë të planifikojë dhe organizojë 'Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë'. Ajo bën një vlerësim periodik të vepritarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. Rezultatet e gjeneruara nga pyetesorët dhe metodat e mbledhjes së të dhënave paraqiten në raportin vjetor që kjo njësi përpunon. Rezultatet i dërgohen njësisë drejtuese, duke ofruar transparencë në menaxhimin e tyre.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC.pdf Ev. 1_5_1 Politikat e NjsBC.pdf</p>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>KUQ praktikisht realizon një pyetësor ndaj studentëve, të cilët përgjigjen në lidhje me kurset që ndjekit dhe lektorët përkatës. NJSBC afishon rezultatet në raportin vjetor, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies bazuar në [Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm.pdf]. Nuk ka një procedurë të qartë për mënyrën e vlerësimit të stafit sipas një peshe të përcaktuar për secilin zë dhe promovimin e praktikave të mira.</p> <p><i>GVJ rekomandon përcaktimin e një standardi të unifikuar vlerësimi, ku çdo formë vlerësimi të ketë peshë të përcaktuar dhe çfarë masash merren për të përmirësuar performancën.</i></p> <p>Evidenca: Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm.pdf Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC.pdf Ev. 2_32_Model pyetësori të studentëve i plotësuar.pdf</p>
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se KUQ ofron mjete për vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies dhe kontrollin e njohurive. Në fund të çdo semestri, studentët japin mendimet e tyre përmes një pyetësori. NJSBC bashkëpunon me senatin, rektorin, GVB, departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet e gjeneruara nga pyetesorët paraqiten në raportin vjetor që kjo njësi përpunon.</i></p>

	<i>GVJ rekomandon përcaktimin e një standardi të unifikuar vlerësimi, ku çdo formë vlerësimi të ketë peshë të përcaktuar dhe çfarë masash merren për të përmirësuar performancën.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>KUQ në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 dhe statutin e kolegjit, ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Në këtë IAL, ekziston NJSBC e cila bashkëpunon me, senatin, rektorin, GVB, departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. GVJ konstatoi se ka disa njësi që i vijnë në ndihmë këtij qëllimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati KUQ; • Rektori; • NJSBC; • Grupi i vlerësimit të Brendshëm; • Drejtuesi i Njësisë kryesore. <p>Këto njësi kanë bashkëpunuar për shkrimin dhe miratimin e rregulloreve për mbarëvajtjen e proceseve akademike.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_1_Statuti KUQ.pdf Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC.pdf Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Cilësisë, e cila bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike, i gjeneron rezultatet në raport vjetor që kjo njësi përpunon. Kjo njësi ka disa detyra, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ⇒ Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies; ⇒ Rishikimin e syllabuseve dhe kurrikulave; ⇒ Gjurmimin e studentëve pasi diplomohen; ⇒ Vlerësimi institucional. <p>Kjo njësi është e angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm, në varësi të kërkesave të tregut.</p>

	<p>NJSBC bashkëpunon me zyrën e ZMJKK, sekretarinë, koordinatorin, departamentin, fakultetin, ku krijon një urë lidhëse me studentët Alumni.</p> <p>GVJ rekomandon që NJSBC të krijojë një standard vlerësimi të unifikuar, ku të gjithë elementët vlerësues të përlogariten sipas peshës specifike.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_1_Statuti KUQ.pdf Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC.pdf Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>KUQ përdor metodologji dhe teknika për vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. KUQ në kuadër të sigurimit të cilësisë realizon akreditimin institucional dhe akreditimin e programeve të studimit, bazuar në metodat e përcaktuara nga ASCAL. Disa nga proceset e NJSBC janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; 2. Ushtron funksionet në përputhje me Manuain e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; 3. Grumbullon, sistemon dhe analizon të dhëna sasiore dhe cilësore; 4. Përgatit raportin vjetor të vetvlerësimit. <p>Në analizën vjetore të departamentit [Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf] vërehet një analizë për të gjithë fakultetin dhe programet që ai ofron. Në të [Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf, fq 15-16], përcaktohen pikat e forta dhe të dobëta për Fakultetin ku bën pjesë programi i studimit bachelor 'Informatikë Ekonomike dhe Biznesi'. Analiza i referohet vitit akademik 21-22.</p> <p>GVJ rekomandon: që të azhurnohet analiza e departamentit për vitin akademik 22-23 dhe të paraqitet një relacion për përmirësimin e pikave të dobëta.</p> <p>Evidenca: Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në</p>	<p>KUQ, nuk ofron mekanizma për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Staf i akademik vlerësohet për angazhimin e tij gjatë semestrit sipas një formati të përcaktuar nga IAL-ja [Ev. 2_32_</p>

<p>mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Model pyetësori të studentëve i plotësuar.pdf]. Bazuar në rezultatet e pyetësorëve IAL vlerëson cilësinë e mësimdhënies. IAL-ja nuk ofron një procedurë të qartë në lidhje me promovimet nxitëse ndaj stafit me arritje të larta.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>KUQ, duhet të përcaktojë qartazi vlerësimin e përkthyer në pikë, për ti ardhur në ndihmë renditjes së performancës dhe cilësisë së stafit. Kështu do të jetë edhe më i qartë promovimi i stafit.</i></p> <p>Evidenca: Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC.pdf Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë.pdf Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm.pdf Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se KUQ përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për mbledhjen e të dhënave në lidhje me vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së literaturës si dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. NJSBC dhe ZMJKK, bashkëpunojnë me departamentet dhe fakultetet, në procesin e vlrësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. IAL-ja nuk ofron një procedurë të qartë në lidhje me promovimet nxitëse ndaj stafit me arritje të larta.</i></p> <p>GVJ rekomandon: <i>KUQ, duhet të përcaktojë qartazi vlerësimin e përkthyer në pikë, për ti ardhur në ndihmë renditjes së performancës dhe cilësisë së stafit. Kështu do jetë edhe më i qartë promovimi i stafit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.3


Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara</p>	<p>KUQ përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë pedagogjike dhe akademike. Në fund të çdo viti akademik, NJSBC [Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC.pdf] përgatit një raport, të cilin e shpërmdan në</p>




<p>për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>formë zyrtare. Bazuar në të dhënat e raportit nxirren rezultate në lidhje me cilësinë dhe mësimdhënien. Gjithashtu departamenti që mbulon programin e studimit vlerëson në mënyrë periodike veprimtaritë mësimore dhe kërkimore-shkencore, rezultat i cili paraqitet në analizën vjetore [Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf] të njësisë bazë.</p> <p>RVJ rekomandon: <i>Që KUQ të përcaktojë procedura për motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</i></p> <p>Evidenca: Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjSBC.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të cilësisë përfshijnë rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit, dhe analizën krahasuese me rezultatet e një viti më parë. Bazuar në këto rezultate nxirren rekomandimet përkatëse. Këto rezultate i komunikohen njësisë drejtuese.</p> <p>NJSBC harton raportin vjetor të përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik. Siç u citua edhe me lart, KUQ duhet të përcaktojë qartazi procedurën për përmirësimin e rezultateve.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>Që për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, performancës akademike, kërkimit shkencor, duhen përdorur forma/pyetësor/metodologji shtesë si psh. "vlerësim kolegj për kolegjin", vlerësim i literaturës së përdorur" etj, dhe jo vetëm [Ev. 2_32_Model pyetësori të studentëve i plotësuar.pdf].</i></p> <p>Evidenca: Ev. 3_5_Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjSBC.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të</p>	<p>KUQ në këtë program studimi përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i procesit të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Stafi i ri, këshillohet, orientohet dhe njihet me strukturat funksionale të KUQ që të kenë një përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>GVJ rekomandon</p>

<p>provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Që KUQ të përfshijë metoda të reja për vlerësimin e cilësisë, si dhe të përcaktojë një unifikim të mënyrës së vlerësimit, peshës që ka secili zë.</i></p> <p>Evidenca: Ev. _1_17_ Udhëzues për kualifikimin e stafit.pdf Ev. _1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Një tjetër metodë vlerësuese në KUQ janë edhe mbledhjet dhe takimet në departament. Vlerësimi i stafit me kohë të plotë, realizohet nga pyetësorët që plotësojnë studentët. Duke u bazuar n* vizit*n n* KUQ, u konstatua q* stafi realizon takime t* vazhdueshme p*r t*diskutuar p*r procesin m*simor dhe rritjen e cil*sis*.</p> <p>Evidenca: Ev. _1_17_ Udhëzues për kualifikimin e stafit.pdf Ev. _2_32_ Model pyetësori të studentëve i plotësuar.pdf</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se KUQ përdor metodologji vlerësimi sa i përket mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë pedagogjike dhe akademike. Në fund të çdo viti akademik, NJSBC përgatit një raport, të cilin e shpërndan në formë zyrtare tek njësitë drejtuese. Raportet e vlerësimit të cilësisë përfshijnë rezultatet e pyetësorëve të vlerësimit, dhe analizën krahasuese me rezultatet e një viti më parë.</i></p> <p>GVJ rekomandon <i>Që KUQ të përfshijë metoda të reja për vlerësimin e cilësisë, si dhe të përcaktojë një unifikim të mënyrës së vlerësimit, peshës që ka secili zë.</i></p>

	<i>Që KUQ të përcaktojë procedura për motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>KUQ, ka bashkëpunim ndërmjet fakulteteve dhe departamenteve, në ndihmë të ruajtjes së cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Informatikë Ekonomike dhe Biznesi”. NJSBC komunikon dhe bashkëpunon vazhdimisht me Fakultetin/ Departamentin që ofron këtë program studimi. Rezultatet e përpunuara nga pyetësorët përfshihen në analizën vjetore të njësisë bazë, në fund të çdo viti akademik.</p> <p>NJSBC ka përgjegjësi në menaxhimin, hartimin, përcaktimin e kriterëve, parimeve dhe standarteve për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, akreditimin e programeve të IAL-së.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC.pdf Ev. 2_32 Model pyetësori të studentëve i plotësuar.pdf Ev. 3_5 Analiza Vjetore e Departamentit 2022-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ vëren se gjatë mbledhjeve të senatit, rektoratit, dekanatit në KUQ janë të qarta detyrat dhe funksionet, përkallëzimi i tyre nga njësia kryesore, tek njësia bazë e deri në nivel lektorësh. Një sërë detyrash lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, si kontrolli i vazhdueshëm i kurrikulave, syllabuseve, organizimi i pjesëmarrjeve në orë leksionesh të hapura me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Një rol me rëndësi ka ZMJKKK, që shërben si urë lidhëse ndërmjet studentëve dhe njësisve përkatëse.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_4 Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. 1_5_1 Politikat e NJSBC.pdf Ev. 2_2 Plan i Punës së GVB.pdf Ev. 2_4 Plani 2 vjeçar i veprimtimit të grupit.pdf Ev. 2_10_3 Analiza vjetore e KPL.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë</p>	<p>Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një suport dhe nxisin përmirësimin e cilësisë në të gjitha nivelet. Të gjitha politikat për</p>

<p>së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>sigurimin e cilësisë së proceseve akademike hartohen nga njësitë drejtuese të KUQ si, Senati, Rektorati, NJSBC, Dekanati etj.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. 1_5_1 Politikat e NjsBC.pdf Ev. 3_6_Rregullore e Programit të studimit.pdf Ev. 2_28_Të dhëna tabelore mbi anëtarët e NjsBC.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>KUQ vlerëson dhe favorizon përshkallëzimin e metodikës në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë kuadër përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të IAL. GVJ konstatoi se ka disa njësi që i vijnë në ndihmë këtij qëllimi, si: Senati KUQ, Rektori, NJSBC, Grupi i vlerësimit të Brendshëm, Drejtuesi i Njësisë kryesore. Këto njësi kanë bashkëpunuar për shkrimin dhe miratimin e rregulloreve duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_1_Statuti KUQ.pdf Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit.pdf Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC.pdf Ev. 3_5_3 Rregullore IEB.pdf, Neni 5 Ev. 1_8_Rregullore e Këshillit të Etikës.pdf, Neni 4,5,6,7,8</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në nivel institucional, KUQ ka disa marrëveshje bashkëpunimi. Kjo lejon që të ketë mobilitet të stafit dhe studentëve, si një element plus në shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet palëve. Gjithashtu në KUQ organizohen takime në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së KUQ. Referuar evidencave të paraqitura nga GVB, në lidhje me programin e studimit Bachelor “Informatkë Ekonomike dhe Biznesi”, duhet të paraqiten qartazi marrëveshjet në dobi të programit.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>Hartimin e një relacioni, se cilat janë marrëveshjet në dobi të programit të studimit, sa i përgjigjen ata nevojave të IAL-së dhe studentëve për zhvillimin e praktikave profesionale.</i></p> <p>Evidenca: Ev. 1_33_Të dhëna të aktiviteteve për kërkimin shkencor.pdf</p>




	Ev_1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit pj 1.pdf Ev_1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se KUQ ofron procedura të sigurimit të cilësisë që demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me NJSBC. Të gjitha politikat për sigurimin e cilësisë së proceseve akademike hartohen nga organe drejtuese si, Senati, Rektori, Dekanati etj.</i></p> <p>GVJ rekomandon:</p> <p><i>Hartimin e një relacioni, se cilat janë marrëveshjet në dobi të programit të studimit, sa i përgjigjen ata nevojave të IAL-së dhe studentëve për zhvillimin e praktikave profesionale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC, bashkëpunon me departamentet dhe fakultetet, në procesin e përmirësimit të cilësisë sipas një frekuence periodike. Rezultatet paraqiten në raport vjetor që kjo njësi përpunon.</p> <p>Evidenca: Ev_1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin</p>	<p>KUQ, publikon rezultatet e vlerësimeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. IAL-ja vepron mbi parimet e përcaktuara në rregulloren e NJSBC. Këto parime sigurojnë transparencë.</p> <p>Evidenca: Ev_1_8_Rregullore e Këshillit të Etikës.pdf Ev_1_5_1 Politikat e NjsBC.pdf Ev_1_10_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale.pdf</p>

për të dhënat personale.	
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Rezultatet e vlerësimit adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Në fund të çdo viti, rezultatet e vlerësimit hartohen në formën e Raportit Vjetor, ku nga analiza e këtyre të dhënave përcaktohen rekomandimet për përmirësimin e cilësisë dhe mësimdhënies. NJSBC udhëzon njësitë bazë dhe kryesore në lidhje me pikat e dobëta dhe pikat e forta.</p> <p>GVJ rekomandon: <i>Që të hartohet një relacion në lidhje me përmirësimin e pikave të dobëta, për programin e studimit bachelor "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi".</i></p> <p>Evidenca: Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC.pdf Ev. 2_4_1_Relacion për realizimin e Plan Veprimit.pdf</p>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>KUQ ka një strukturë të qëndrueshme dhe efektive bazuar në kërkesat institucionale, ligjore dhe standardet e cilësisë. Në lidhje me veprimtarinë e IAL-së, nga evidencat vërejmë që IAL organizon takime për rishikimin dhe përmirësimin e rregullores, kurrikulës etj. Sa i përket programit të studimit vërehet që çdo fillim viti, departamenti realizon mbledhje për azhornimin e syllabuseve. Ndryshime rrënjësore për programin e studimit, mund të bëhen vetëm nga një akreditim në tjetrin.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_4_Rregullore KUQ.pdf</p>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>NJSBC harton një plan periodik aktiviteteve, ku përfshihen takime, mbledhje, njoftime në lidhje me proceset e akreditimit, të cilat lidhen me cilësinë e programit që ata bëjnë pjesë. Këto aktivitete përfshijnë njësitë drejtuese, këshillin studentor etj.</p> <p>Evidenca: Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC.pdf Ev. 2_4_1_Relacion për realizimin e Plan Veprimit.pdf Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm.pdf</p>
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se. KUQ ka një strukturë të drejtuar ndaj përmirësimeve të vazhdueshme, bazuar në kërkesat institucionale, ligjore dhe standardet e cilësisë. KUQ publikon rezultatet e vlerësimeve, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i></p>

	GVJ rekomandon: <i>Që të hartohet një relacion në lidhje me përmirësimin e pikave të dobëta, për programin e studimit bachelor "Informatikë Ekonomike dhe Biznesi".</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatike Ekonomike dhe Biznes” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Qiriazi”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Në KUQ studentët janë të përfaqësuar (Standarti V, Kriteri 6 dhe Standarti VI, Kriteri 1)
2. Staf i PAE mbulon 70% të ngarkesës mësimore (Standarti V, Kriteri 1)
3. Ka staf të kualifikuar me tituj dhe grada (Standarti I.2, Kriteri 4, Standarti II.1, Kriteri 4, Standarti II.2, Kriteri 1)
4. Përputhshmëria me interesat kombëtare (Standardin I.1, Kriteri 1)
5. Struktura dhe organizimi i qartë (Standarti II.1, Kriteri 1, Standarti II.3, Kriteri 2, Standarti II.3, Kriteri 3)

Pika të dobëta

1. Mungesa e stafit PAE në fushën e Informatikës dhe Shkencave Kompjuterike. (Standarti IV.1, kriteri 1)
2. Mungesa e literaturës specifike për fushën e Informatikës në gjuhën shqipe në bibliotekën e universitetit, dhe azhurnimi i literaturës së sugjeruar për lëndë specifike është e vjetër dhe nuk është përditësuar. (Standarti II.3, kriteri 4, Standarti IV.3, kriteri 2)
3. Mungesa e një strategjie të qartë për përfshirjen e lëndëve që zhvillojnë mendimin kritik dhe metodat e kërkimit shkencor. (Standarti II.1, kriteri 2)
4. Nuk ka një sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave. (Standarti IV.4, kriteri 1,2)
5. Nuk ka bibliotekë online. (Standarti IV.3, kriteri 4)
6. Pajisjet dhe teknologjia në laboratorët e kompjuterave janë të vjetra dhe të pamjaftueshme. (Standarti I.1, kriteri 4, Standarti IV.2, kriteri 4)
7. Mungesa e një politike të qartë për rekrutimin dhe mbajtjen e stafit akademik të kualifikuar. (Standarti IV.1, kriteri 3)
8. Nuk ka një dokument të qartë që shpjegon procedurat për sekretimin e provimeve dhe për të dokumentuar për zbulimin e plagjiaturës. (Standarti III.3, kriteri 2, kriteri 5)
9. Mungesa e një strategjie të qartë për bashkëpunimin me kompani IT dhe përfitimet nga këto marrëveshje. (Standarti IV.1, kriteri 7)
10. Mungesa e dokumentacionit të plotë dhe të saktë për shumë prej rregulloreve dhe procedurave të brendshme. (Standarti V.4, kriteri 3)
11. Mungesa e një plani të qartë për zhvillimin e projekteve kërkimore dhe përfshirjen e studentëve në këto projekte. (Standarti VI.3, kriteri 1)

12. Mungesa e dokumentimit të konsultave dhe propozimeve nga institucionet partnere dhe aktorët e tregut të punës. **(Standarti VI.4, kriteri 5)**
13. Mungesa e një sistemi të qartë për dokumentimin dhe analizimin e performancës së stafit akademik. **(Standarti VI.1, kriteri 3, 5)**
14. Nuk ka një strukturë të qartë dhe të dokumentuar për përfshirjen e feedback-ut të studentëve në përmirësimin e programeve të studimit. **(Standarti VI.3, kriteri 3)**

Rekomandime

1. KUQ, duhet të përcaktojë qartazi vlerësimin e përkthyer në pikë, për ti ardhur në ndihmë renditjes së performancës dhe cilësisë së stafit.
2. Krijimin e strategjive për ngritjen e kapaciteteve akademike (staf PAE) në fushën e Informatikës dhe Shkencave Kompjuterike (Duke kërkuar kandidatë me tituj akademikë të avancuar si Prof. Dr. dhe Dr.)
3. Krijimi i një politike të qartë për rekrutimin dhe mbajtjen e stafit akademik të kualifikuar.
4. Hartimin e një udhëzimi për realizimin dhe vlerësimin e Praktikës Profesionale
5. Pasqyrimi i procesit të sekretimit të provimeve në rregulloret përkatëse.
6. Hartimin e një relacioni, se cilat janë marrëveshjet në dobi të programit të studimit, sa i përgjigjen ata nevojave të IAL-së dhe studentëve për zhvillimin e praktikave profesionale
7. Azhornimin e literaturës së sugjeruar, pasi për kurse specifike, i përket viteve 2006-2010.
8. Të nxiten studentët të marrin pjesë në mobilitet dhe kërkim shkencor
9. Implementimi i një sistemi të brendshëm të menaxhimit të të dhënave për të përmirësuar organizimin dhe aksesin në informacione
10. Mundësia për aksesimin e një biblioteke online për të siguruar qasje të lehtë dhe të shpejtë në literaturën akademike.
11. Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike duke investuar në laboratorë dhe pajisje kompjuterike të reja.
12. Dokumentimi i metodave të zbulimit të plagjiaturës dhe organizimi i trajnimeve për stafin akademik mbi këto metoda.
13. Zgjerimi i bashkëpunimeve me kompani IT dhe dokumentimi i përfitimeve nga këto marrëveshje.
14. Përmirësimi dhe rishikimi i dokumentacionit mbështetës duke i dorëzuar ato të plota dhe të sakta.
15. Dokumentimi i konsultimeve dhe propozimeve nga institucionet partnere dhe aktorët e tregut të punës.
16. Përmirësimi i analizës së brendshme që përfshijnë statistika dhe të identifikojnë arritjet dhe problematikat për të synuar përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.
17. Konsistenca në shpërndarjen e syllabus-eve dhe sigurimi që të gjitha dokumentet referuese të jenë të sakta dhe të plota.
18. Përfshirja e lëndëve që zhvillojnë mendimin kritik dhe kërkimin shkencor.

19. Rritja e frekuencës së eventeve akademike në shërbim të programit të studimit.
20. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm për të dhënë leksione të hapura dhe për të ndarë përvojat e tyre me studentët.
21. Trajnime dhe kualifikime të vazhdueshme për stafin akademik mbi metodat e reja të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë në klasë.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Informatike Ekonomike dhe Biznesi" provided by the Higher Education Institution "Kolegji Universitar Qiriazi"

Strengths and affirmations

1. At KUQ, students are represented.
2. PAE staff covers 70% of the teaching process.
3. There is qualified staff with academic titles.
4. The program complies with national interests.
5. It has a clear structure and organization.

Weaknesses

1. Lack of PAE staff in the field of Informatics and Computer Sciences.(Standard IV,Criterion 1)
2. Absence of specific literature related to Informatics in the Albanian language in the university library. (Standard II.3,Criterion 4 , Standard IV,Criterion 2)
3. There is not an internal data management system.(Standard IV.4 ,Criterion 1,2)
4. There is not an online library.(Standard IV.3 ,Criterion 4)
5. Suggested literature for specific subjects is outdated and not updated.(Standard II.3 ,Criterion 4)
6. Equipment and technology in computer labs are old and inadequate.(Standard I.1,Criterion 4, Standard IV.2,Criterion 4)
7. Lack of a clear policy for recruiting and retaining qualified academic staff.(Standard IV.1,Criterion 3)
8. There is not any specific document explaining the procedures for the anonymization of exams.(Standard I11.3,Criterion 2)
9. There is not a clear and documented procedure for detecting plagiarism.(Standard I11.3 ,Criterion 5)
10. Lack of a clear strategy for collaboration with IT companies and the benefits from these agreements. (Standard IV.1,Criterion 7)

11. Incomplete and inaccurate documentation for many internal regulations and procedures. **(Standard V.4, Criterion 3)**
12. Lack of a clear plan for the development of research projects and the involvement of students in these projects. **(Standard VI.3, Criterion 1)**
13. Lack of documentation of consultations and proposals coming from partner institutions and labor market actors. **.(Standard VI.4, Criterion 5)**
14. Lack of a clear system for documenting and analyzing the performance of academic staff. **.(Standard VI.1, Criterion 3,5)**
15. No clear and documented structure for incorporating student feedback in the improvement of study programs. **.(Standard VI.3, Criterion 3)**
16. Submitted documentation is often incomplete and inaccurate, including references and other designations.
17. Lack of a clear strategy for including courses that develop critical thinking and research methods. **.(Standard I1.1, Criterion 2)**

Recommendation

1. KUQ should clearly define the evaluation translated into points to assist in ranking the performance and quality of the staff.
2. Create strategies to enhance academic capacities (PAE staff) in the field of Informatics and Computer Sciences (by seeking candidates with advanced academic titles such as Prof. Dr. and Dr.).
3. Develop a clear policy for the recruitment and retention of qualified academic staff.
4. Draft a guideline for the implementation and evaluation of Professional Practice.
5. Reflect the blind grading process in the relevant regulations.
6. Draft a document that reflects the benefits the study program gains from the cooperation agreements and how well they meet the needs of the institution and students for the development of professional practices.
7. Update the recommended literature as, for specific courses, it dates back to 2006-2010.
8. Encourage students to participate in mobility and scientific research.
9. Implement an internal data management system to improve organization and access to information.
10. Provide access to an online library to ensure easy and quick access to academic literature.
11. Improve technological infrastructure by investing in new laboratories and computer equipment.
12. Document methods for detecting plagiarism and organize training for academic staff on these methods.



13. Expand collaborations with IT companies and document the benefits of these agreements.
14. Improve and review the supporting documentation by submitting them fully and accurately.
15. Document consultations and proposals coming from partner institutions and labor market actors.
16. Improve internal analysis by including statistics and identifying achievements and issues to aim for continuous improvement of the study program.
17. Ensure consistency in the distribution of syllabus and that all reference documents are accurate and complete.
18. Include courses that develop critical thinking and research methods.
19. Increase the frequency of academic events in service of the study program.
20. Provide continuous training and qualifications for academic staff on new teaching methods and the use of technology in the classroom.



CS

CS

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT		X		
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT		X		
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT		X		
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR		X		

